



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Qershor 2021/ Nr. 6



"Defender Europe 21"
Kryeministri Rama:
Ky është një moment
historik për të gjithë ne



Ambasadorja e SHBA-së
Yuri Kim: Roli i
Shqipërisë është më i
rëndësishëm se kurrë



Ministri i Mbrojtjes Peleshi
Kjo stërvitje është
një mesazh i qartë për
popujt e Ballkanit



4 MAJ 2021: TRE GJENERALË TË NATO-S NË STËRVITJEN "DEFENDER EUROPE 21"

**Gjenerali Tod Walters: Shqipëria-një komb
që luan rol të madh për paqen në rajon**

Përmbajtja

Numri 6

STËRVITJA NDËRKOMBËTARE

- 6** Kryeministri Rama:
Ky është një moment
historik për të gjithë ne

GJENERALMAJOR BEGAJ

- 10** I siguroj gjeneralët
amerikanë se nuk gjejnë
zhgënjim te ne

INTERVISTË E MINISTRI TË MBROJTJES

- 21** Kapacitetet tona ushtarake
vlejnë për ne, por edhe
për aleatët në NATO

KRENARI, EMOCION DHE FANTAZI

- 32** "Defender Europë 21":
Dita e Hapur "zbret"
në sheshe

BCU

- 36** Ne ishim pjesë integrale e Civil
Affairs të ushtrisë amerikane
dhe Qendrës Shumëkombëshe
të CIMIC (MNCC)

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



4 "DEFENDER EUROPE 21"

Gjenerali Tod Walters:
Shqipëria-një komb që luan rol
të madh për paqen në rajon

Gjenerali amerikan dhe Komandant i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters ka mbajtur fjalën tij ditën e martë, më 4 maj 2021, nga Durrësi me rastin e nisjes së stërvitjes...



7 AMBASADORJA E SHBA-ve

Roli i Shqipërisë
është më i
rëndësishëm se kurrë

Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, ka dhënë mesazhin e saj në nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Teksa e ka cilësuar...



9 MINISTRI NIKO PELESHI

Kjo stërvitje është një
mesazh i qartë për
popujt e Ballkanit

Me pjesëmarrjen e veçantë të tre gjeneralëve më të lartë të Aleancës së NATO-s, por edhe të mjaft autoriteteve të larta nisi ditën e martë, më 4 Maj 2021, nga Durrësi stërvitja...



47 ANALIZË

Ballkani Perëndimor
zonë e përgjegjësisë
Euro-Atlantike

Të e martën e kësaj jave, më 18 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Presidentin e Malit...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 6/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





**4 maj 2021: Fillon stërvitja “Defender Europe 21”,
marrin pjesë tre gjeneralë të NATO-s**

Gjenerali Tod Walters: Shqipëria-një komb që luan rol të madh për paqen në rajon

Gjenerali amerikan dhe Komandant i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters ka mbajtur fjalëne tij ditën e martë, më 4 maj

2021, nga Durrësi me rastin e nisjes së stërvitjes së NATO “Defender Europe 21” në Shqipëri. Walters vlerëson Shqipërinë si një komb që ka luajtur rol të madh në

paqen në rajon, teksa ka kërkuar që pandemia mos materializohet në krizë sigurie.

Ai thotë se me anë të stërvitjes “Defender Europe 21”, vendet



Komandanti
i Komandës
Europiane të
SHBA-së,
Tod Walters:
"Shqipëria është
eksportuese e
sigurisë! Do të
përmirësojmë
"muskujt" dhe
gatishmërinë
në të gjitha
aspektet"



aleate të NATO-s përfshirë Shqipërinë do të forcojnë 'muskujt' dhe do të përmirësojnë gatishmërinë në të gjitha aspektet. "Është nder të jem këtu sot në Shqipëri, të jem

kaq i lumtur në një komb që i trajton të gjithë miqtë e tij si motra e vëllezër, bij dhe bija. Dua t'ju falënderoj ju, një komb kaq i bekuar për atë që ka bërë dhe vijon të bëjë për

paqen në rajon. Më lejoni të shpreh ngushëllimet e mia për ata që kanë humbur personat e dashur prej COVID-19. Por edhe për vigjilencën që kjo pandemi mos materializohet në krizë sigurie. Kemi rrugë shumë të gjatë përpara, por nëse keni të dëshmuar, përballë kësaj pandemie do jemi të suksesshëm, sepse kjo pandemi nuk do na çojë në krizë sigurie. Dua të falënderoj autoritetet ushtarake për këtë stërvitje. Sot kemi provën e asaj që duhet të bëjmë, duhet të përmirësojmë transparencën strategjike që nuk është bërë që në 1940.

Teksa qëndrojmë sot në këtë mjedis dhe shohim bregdetin, duhet të kujtojmë çfarëndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pushtimi i Normandisë, zbarkimet në Sicili, D-Day, gjithë logjistikat në tokë e det, ne do të ulemi sot e do kuptojmë çfarë prove e vështirë është kjo", -tha gjenerali amerikan dhe Komandant i Komandës Europiane të SHBA-së, Tod Walters.

Ai tha se: "E gjithë logjistika e anijeve është e përbashkët, jemi këtu sot, është shumë e komplikuar dhe e bëjmë këtë në mënyrën tipike të NATO-s, me forca të armatosura të shëndosha; marinsat, forca tokësore, detare, për të provuar e dëshmuar se nga kjo stërvitje do të jemi më shumë përgjegjës, do të reagojmë më mirë. "Defender Europe 21", ku marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere, dhe qëllimi është të demonstrojmë aftësitë tona kolektive. Dhe nëpërmjet kësaj do të bëjmë stërvitje të përbashkët nga shumë agjenci, forca shumëkombëshe, nga të gjitha degët kundër një rivali të stimuluar. Do të përmirësojmë muskujt tonë, dhe të përmirësojmë gatishmërinë tonë në të gjitha aspektet. Falënderoj këtë komb, është eksportues i sigurisë. Mënyra si e kuptojmë këtë, momenti kur ju e keni treguar këtë nga pranimi në NATO në vitin 2009 deri më sot, na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, pjesë perëndimore më të sigurt, një Mesdhe dhe Europë më të sigurt. Ndihe miq të sigurt, jemi më të fortë së bashku." - tha gjenerali Tod Walters.

Kryeministri Rama: Ky është një moment historik për të gjithë ne

“Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krah për krah jush, gjithmonë të denjë brenda kësaj aleance”

Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krah për krah jush si një vend që ndoshta nga pikëpamja numerike nuk i ofrojmë shumë kësaj aleance, por nga pikëpamja e vlerave që e bëjnë këtë aleancë unike për botën tonë, ne dëshirojmë të jemi gjithmonë më të denjë e të vyer brenda kësaj aleance”. Kështu u shpreh Kryeministri Edi Rama në ceremoninë e organizuar në Portin e Durrësit, në Ditën e Vizitorëve të Shquar për Nder të Stërvitjes Defender 21, ku nisi stërvitja e madhe, me dislokimin që ndodh për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore, në Europë, ku do të demonstrohen aftësitë ndërvepruese të Shteteve të Bashkuara me ushtritë partnere të NATO-s, për sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi.

Rama tha se: “është realisht një kënaqësi dhe nder për ne të kemi kaq shumë yje të mbledhura këtu në këtë vend të vogël”. Kryeministri shprehu bindjen se kjo stërvitje është shumë, shumë më tepër se sa një moment i rëndësishëm i të gjithë punës së përbashkët në funksion të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve tona, sepse siç tha ai, “besoj se kjo stërvitje është edhe një tjetër pikë e rëndësishme në ngjitjen e mëtejshme të marrëdhënieve tona në pikën më të lartë”. “Ne, vijoi ai, vazhdimisht i vlerësojmë këto marrëdhënie si të shkëlqyera, por ato mund të jenë gjithmonë e më të shkëlqyera falë një besimi të madh dhe një ndërveprimi reciprok të vazhdueshëm. Ky është një moment historik për të gjithë ne”.

“Gjenerata jonë lindi dhe u rrit me idenë se ju nuk duheshit lënë kurrë të shkëlqenit në këtë vend. Ne të gjithë u brumosëm nga propaganda e regjimit të shkuar me bindjen se ju jeni e keqja më e madhe që mund t’i ndodhëjo vetëm Shqipërisë, por mbarë botës. Realisht për gjeneratën tonë është vërtetë një mrekulli e madhe që e ka ndarë jetën mes dy botëve, asaj të izoluar dhe të er-



rët dhe kësaj bote sot. Dua shumë të besoj që pas zbarkimit tuaj në Shqipëri edhe juve do t’ju ndodhë ajo që ju ndodh të gjithëve kur vijnë në Shqipëri që do të doni të riktheheni përsëri. Kush vjen në Shqipëri dëshiron të kthehet përsëri. Kam shumë dëshirë edhe besim që kjo do të ndodhë edhe me ju”, -tha ai.

Kryeministri tha se: “ajo që ne të gjithë së bashku duhet të mbajmë parasysh është detyrimi për t’i përcjellë gjeneratave të tjera këtë amanet kaq të rëndësishëm për të ardhmen e vendit tonë, por edhe të botës së madhe që kemi zgjedhur, amanetin e kësaj marrëdhënie strategjike për lirinë dhe demokracinë jo vetëm të Shqipërisë, por të mbarë botës duke investuar së bashku të bëjmë më shumë për brezin e ri në të gjitha aspektet.

“Duhet t’i japim brezit të ri mundësinë që të edukohet që në krye të herës me vlerat, parimet, standardet shumë të larta të Forcave të Armatosura të NATO-s”, -tha Rama. Kryeministri vlerësoi se: “ky është një moment historik për ne të gjithë që na mbush me krenari por edhe me përgjegjësi. Suksese për këtë stërvitje unike në gjithë historinë e marrëdhënieve tona që shpresoj se do të pasohet nga të tjera për t’i dhënë gjithë rajonit një mesazh shumë të qartë, por edhe përtej rajonit, kujtdo që ka nevojë për përgjigje të drejtpërdrejta lidhur me qëndrimin tonë të vendosur brenda kësaj aleance, në krah të SHBA-së dhe së bashku me të gjitha vendet e tjera që kanë vendosur që për lirinë dhe demokracinë të paguajnë çdo çmim”.

Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim

Roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë

Shqipëria
është një
vend i
veçantë
dhe një
vend-
ndodhje
strategjike

Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, ka dhënë mesazhin e saj në nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Teksa e ka cilësuar këtë stërvitje si historike, ambasadorja Kim është shprehur se nuk është rastësi që ajo po zhvillohet në Shqipëri. Sipas kryediplomates amerikane, roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë, pasi shqiptarët kanë ndihmuar SHBA-në në stërvitje rreth e përqark globit. "Çfarë dite të lavdishme kemi përpara nesh. Ditë historike, ju falënderoj që më ftuat të flas. Dua të përgëzoj FA, ministrin, për organizimin. Dua të them se ushtarët dhe marinarët tanë duken të jashtëzakonshëm. Dua t'i uroj mirëseardhjen veçanërisht Gjeneralëve Wolters, Harrigian, dhe Cavoli në Shqipëri. Është një rast vërtet i rrallë kur tre gjeneralë amerikanë me katër yje janë në të njëjtën kohë në të njëjtin vend. Jemi të nderuar që bashkoheni me ju në këtë aktivitet për nisjen e stërvitjes "Defender Europe 21". Roli i Shqipërisë në aleancë vetëm rritet. Po të shohësh aktivitetet, vihet re se Shqipëria është pjesëmarrëse më shumë se çdo vend në rajon. Mendoni se është rastësore,

por nuk është. Roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë. Shqiptarët kanë ndihmuar rreth e qark globit. Kurrë nuk do t'i harrojmë sakrificat tuaja. Shqipëria gjithmonë është krah nesh. E njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t'ju quajmë aleatët tanë. Shqipëria është një vend i veçantë dhe një vendndodhje strategjike. Si anëtare e Aleancës, Shqipëria ofron një bazë të rëndësishme që i jep mundësinë NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara për t'iu përgjigjur emergjencave dhe krizave rajonale shpejt dhe efektshëm. Stërvitja "Defender Europe 21" përgatit për këtë koncept, demonstroi aftësinë për të hyrë në Europën juglindore përmes Shqipërisë, si dhe vërtetoi aftësinë e Shqipërisë për të prituri forca shumëkombëshe. Përgëzojmë vullnetin e Shqipërisë për të marrë përgjegjësi. Keni qenë të zëshëm, nuk keni hezituari kurrë të dërgoni trupat tuaja, apo të prisni aleatët në vendin tuaj. Jam kaq mirënjohës për mikpritjen, partneritetin e kurajon tuaj. Kjo stërvitje në Shqipëri është historike. Do të stërvitemi së bashku më shpesh, do të punojmë së bashku më gjerë. Mbetemi me ju, krah për krah, sot, nesër e gjithmonë", -ka deklaruar ambasadorja Kim.



Kjo stërvitje është një mesazh i qartë për popujt e Ballkanit

Me pjesëmarrjen e veçantë të tre gjeneralëve më të lartë të Aleancës së NATO-s, por edhe të mjaft autoriteteve të larta nisi ditën e martë, më 4 Maj 2021, nga Durrësi stërvitja më e madhe ushtarake në rajonin e Ballkanit Perëndimor, "Defender Europe 21".

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi teksa shprehu mirënjohjen që u zgjodh Shqipëria si një ndër 12 vendet host për këtë stërvitje, siguroi drejtuesit e lartë të Aleancës se vullneti për të qëndruar në krah të NATO-s në çdo rrethanë, sfidë dhe përpjekje është i palëkundur.

"Defender Europe 21" dëshmon për vëmendjen dhe përkushtimin që Aleanca dhe në mënyrë të veçantë Shtetet e Bashkuara kanë për rajonin tonë. Kjo stërvitje është një mesazh i qartë për popujt e Ballkanit. E ardhmja e tyre e vetme është integrimi i plotë në strukturat euroatlantike. Çdo hezitim, devijim, ndikim përtej kësaj rruge është thjesht humbje kohe. Por, kjo është dhe një mesazh për ato vende dhe forca "dashakeqëse" dhe rivale të vlerave tona të përbashkëta. Falënderoj Shtetet e Bashkuara që zgjodhën Shqipërinë si përçuese të këtyre mesazheve të shumëfishta strategjike", -u shpreh ministri Niko Peleshi në ceremoninë e nisjes së stërvitjes.

Kryeministri Edi Rama, i cili përshëndeti këtë ceremoni e cilësoi një moment historik dhe një stërvitje unike "Defender Europe 21". "Shqipëria do të vazhdojë të qëndrojë besnikërisht krah për krah jush si një vend që ndoshta nga pikëpamja numerike nuk i ofrojmë shumë kësaj Aleance, por nga



"Defender Europe 21" dëshmon për vëmendjen dhe përkushtimin që Aleanca dhe në mënyrë të veçantë Shtetet e Bashkuara kanë për rajonin tonë



pikëpamja e vlerave që e bëjnë këtë Aleancë unike për botën tonë, ne dëshirojmë të jemi gjithmonë më të denjë e të vyer brenda kësaj Aleance", -u shpreh kreu i qeverisë shqiptare.

Gjenerali amerikan dhe Komandanti i Komandës Europiane të SHBA, Tod D. Wolters në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e nisjes

së stërvitjes së NATO-s "Defender Europe 21" në Shqipëri vlerëson vendin tonë si një komb që ka luajtur rol të madh për paqen në rajon. "E gjithë logjistika e anijeve është e përbashkët. E bëjmë në mënyrën tipike të NATO-s, me forca të armatosura të shëndosha: marinsa, forca tokësore, forca ajrore, forca detare, për të provuar e dëshmuar



se nga kjo stërvitje do jemi më shumë përgjegjës, do të reagojmë më mirë. Falënderoj këtë komb, që është eksportues i sigurisë. Mënyra si e kuptojmë këtë, është momenti kur ju e keni treguar këtë nga pranimi në NATO, na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, pjesë perëndimore më të sigurt, një Mesdhe dhe Europë më të sigurt. Ndihe mi më të sigurt, jemi më të fortë së bashku"- tha gjeneral Tod D. Wolters.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri Yuri Kim, në fjalën përshëndetëse përgëzoi Forcat e Armatosura shqiptare dhe Ministrinë e Mbrojtjes për organizimin e ceremonisë së jashtëzakonshme. Diplomati amerikane tha se Shqipëria është pritësja e më shumë aktiviteteve se çdo vend tjetër në rajon dhe kjo për një arsye. "Së pari roli i Shqipërisë në Aleancë është më i rëndësishëm se kurrë. Shqiptarët kanë luftuar pranë nesh krah për krah në konflikte të shumta përrreth globit. Kurrë nuk do të harrojmë sakrificat tuaja, e gjithmonë do t'ju jemi mirënjohës që kur Amerika ka nevojë për ju, kur aleatët kanë nevojë për ju, NATO është aty dhe Shqipëria gjithmonë është krah nesh. E njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t'ju quajmë aleatët tanë", u shpreh ambasadorja Kim.

GJENERAL TOD D. WOLTERS

"E gjithë logjistika e anijeve është e përbashkët. E bëjmë në mënyrën tipike të NATO-s, me forca të armatosura të shëndosha: marinsa, forca tokësore, forca ajrore, forca detare, për të provuar e dëshmuar se nga kjo stërvitje do jemi më shumë përgjegjës, do të reagojmë më mirë. Falënderoj këtë komb, që është eksportues i sigurisë. Mënyra si e kuptojmë këtë, është momenti kur ju e keni treguar këtë nga pranimi në NATO, na ka dhënë një Shqipëri më të sigurt, pjesë perëndimore më të sigurt, një Mesdhe dhe Europë më të sigurt. Ndihe mi më të sigurt, jemi më të fortë së bashku"- tha gjeneral Tod D. Wolters.

Nisja e stërvitjes "Defender Europe 21" u përshëndet edhe nga presidenti Ilir Meta, i cili tha se kjo stërvitje është një garanci e fortë që Shqipëria është e gatshme të mbrojë vlerat e demokracisë në Europë dhe në të gjithë hapësirën euroatlantike.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, në fjalën e tij tha se zhvillimi i kësaj stërvitjeje të trupave të NATO-s në Shqipëri është e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet e sigurisë që përcjell. Sipas tij, prania e gjeneralëve të nderuar amerikanë është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Forcat tona të Armatosura dhe Shqipërinë. "Shqipëria godet më fort, se sa

pesha e saj". I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk do të gjejnë zhgënjim te ne", tha gjeneralmajor Begaj. Stërvitja ushtarake, e organizuar nga Ushtria Amerikane në Europë dhe Afrikë, ku marrin pjesë rreth 28 mijë trupa nga 26 vende aleate dhe partnere, do të zhvillohet në 7 baza të ndryshme në vendin tonë. "Defender Europe 21" do të zgjasë deri më 9 qershor. Shqipëria është një nga 16 vendet mirëpritëse në zhvillimin e kësaj stërvitjeje ushtarake. Forcat tona të Armatosura, do të përfaqësohen me rreth 1.000 trupa. Ndërkohë 28.000 trupa shumëkombëshe do të kryejnë aktivitete pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë se 30 zona trajnimit, të shtrira në 12 vende.

Gjeneralmajor Bajram Begaj

I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk gjejnë zhgënjim te ne

Përzgjedhja e Shqipërisë për të zhvilluar këtë stërvitje vë në dukje strategjinë e saj, por edhe mundësinë për të testuar të gjitha kapacitetet

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralmajor Bajram Begaj, mbajti fjalën e tij në nisje të stërvitjes më të madhe ushtarake të NATO-s "Defender Europe 21", në Portin e Durrësit. Gjeneralmajor Begaj vlerësoi zhvillimin e kësaj stërvitjeje të trupave të NATO-s në Shqipëri, ku tha se është e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet që përcjell. Mes të tjerash, Begaj theksoi se përzgjedhja e Shqipërisë për të zhvilluar këtë stërvitje vë në dukje strategjinë e saj, por edhe mundësinë për të testuar të gjitha kapacitetet. "Ju uroj mirëseardhjen, dhe ju uroj për praninë tuaj. Ndihe mi të lumtur dhe krenarë që sot jemi këtu për të shënuar një nga ngjarjet më të rëndësishme të forcave tona. Është e një rëndësie të lartë kjo stërvitje, jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet që përcjell. Rreth 28 mijë trupa do zhvillojnë njëherazi manovra. Kështu synohet rritja e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë së aleatëve

të NATO-s dhe vendeve partnere, edhe në kohë të pasigurta, sikundër është pandemia. Kjo stërvitje përbën thelbin e mbrojtjes kolektive. Shqipëria dhe FA-të kanë nderin dhe përgjegjësinë të ofrojnë mikpritjen për këtë stërvitje. Përzgjedhja e Shqipërisë vë në dukje strategjinë e saj, për të testuar të gjitha kapacitetet tona. Do të kemi pamje më të qartë për kryerjen e investimeve strategjike në të ardhmen, për zhvillimin e forcave tona. Ky angazhim i yni është shprehje e besimit të SHBA-së për Shqipërinë dhe NATO-n. Ajo provon se ne jemi të përgatitur për t'u mbrojtur e krijuar stabilitet. Prezenca e gjeneralëve të nderuar amerikanë është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Forcat tona të Armatosura dhe Shqipërinë. "Shqipëria godet më fort, se sa pesha e saj". I siguroj gjeneralët amerikanë se nuk do të gjejnë zhgënjim te ne. Jam mirënjohës ndaj autoriteteve shtetërore për mbështetjen. Besoj se me profesionalizimin dhe përkushtimin tonë do t'i hapim rrugë zhvillimit të aktiviteteve të tjera me këtë përmasë", -tha gjeneral Begaj.





Tre gjeneralë amerikanë me 4 yje mbërrijnë në Tiranë

Tre gjeneralë të lartë të ushtrisë amerikane, marrin pjesë në stërvitjen "Defender Europe 21", të cilët janë përshëndetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë. "Ne i urojmë mirëseardhjen Gjeneralit Tod Wolters, Komandant i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve European të NATO-s; Gjeneralit Jeffrey Harrigian, Komandant i Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europë-Forcave Ajrore Afrikë, si dhe Komandës Ajrore Aleate; dhe Gjeneralit Christopher Cavoli, Komandant i Ushtrisë së SHBA në Europë dhe Afrikë. Tri Gjeneralët me katër yje mbërritën sot në Shqipëri

për të asistuar në nisjen e "DefenderEurope21", stërvitjes më të madhe ushtarake në Ballkanin

Perëndimor", -poston ambasada amerikane në faqen e saj në facebook.



Peleshi-Mehaj: Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes

Shqipëria dhe Kosova intensifikojnë më tej bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes. Në Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës, me nderimet më të larta ushtarake, ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z. Niko Peleshi u prit në vizitën e tij zyrtare nga homologu kosovar, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Armend Mehaj. Pas takimit tetë-a-tetë dhe atij në nivel të dy delegacioneve, dy ministrat nënshkruan më 18 maj 2021, në Prishtinë marrëveshjen e bashkëpunimit bilateral mes dy ministrave në fushën e mbrojtjes.

Gjatë takimit të përbashkët, ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë Niko Peleshi e garantoi ministrin e Mbrojtjes së Kosovës për mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë si në rrafshin politik edhe në atë teknik. “E gjithë eksperiencia që Shqipëria ka në rrugën e integritit të plotë në NATO do të vijojë të përcillet e plotë tek vëllezërit tanë kosovarë.” – tha pas takimit, ministri Niko Peleshi.

Ministri Peleshi përgëzoi Forcat e Sigurisë së Kosovës për angazhimin në misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit, krahas kolegëve amerikanë në Kuvajt. Teksa foli për stërvitjen më të rëndësishme “Defender Europe 2021”, ministri Peleshi u shpreh se është një lajm shumë i mirë për të dy vendet, që SHBA dhe partnerët e NATO-s u dhanë me përzgjedhjen për zhvillimin e kësaj stërvitjeje.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se anëtarësimi i plotë i vendeve të rajonit në Aleancën e NATO-s do të thotë më shumë siguri.

“Shpresojmë fort se ka ardhur koha që, Republika e Kosovës me ndihmën e vendeve aleate, partnere dhe mike të mundë të gjitha barrierat, që e pengojnë atë të ecë



Ministri Peleshi: “E gjithë eksperiencia që Shqipëria ka në rrugën e integritit të plotë në NATO do të vijojë të përcillet e plotë tek vëllezërit tanë kosovarë”



përpara në rrugëtimin e pandalshëm euroatlantik. Integrimi i plotë i Ballkanit në NATO do të thotë më shumë siguri, stabilitet dhe demokraci jo vetëm për këto vende, por edhe për Aleancën. Për më tepër integrimi është një ëndërr e përbashkët e popujve të Ballkanit, të cilët meritojnë të shpërblehen për sakrificat e tyre”, -u shpreh ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë Niko Peleshi.

Në përfundim të takimit ministri Peleshi e ftoi homologun e tij për një vizitë në Tiranë, ndërsa i shprehu angazhimin personal për hapjen e një kapitulli të ri dhe shumë in-

tensiv të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, që do të vijojë me implementimin e aktiviteteve të përbashkëta të planifikuara më parë. Pas vizitës zyrtare, ministri Peleshi, ka ndaluar në ICK (Qendra e Inovacionit Kosovë). “Uraniku bën një punë fantastike aty, për nxitjen e sipërmarrjeve të reja në fushën e teknologjive të informacionit dhe aftësimin e të rinjve për ekonominë dixhitale. Një qendër e ngjashme me qendrën e sapohapur të inovacionit në Korçë. Do të bëjmë punë të mira së bashku”, -thotë Peleshi.

Në prani të ministrit Peleshi, duke iu adresuar medias, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z. Armend Mehaj, shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen vël-lazërore të ofruar në të gjitha periudhat e ndërtimit, zhvillimit si dhe në të gjitha të arriturat e deritanishme të Kosovës, si edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në vazhdim, ministri Mehaj shprehu mirënjohjen e lartë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit shqiptar, si vend anëtar i NATO-s, në sigurinë e përgjithshme të rajonit dhe më gjerë me pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. Ai theksoi edhe rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura të saj, duke pasur parasysh përvojën e madhe në procesin e integritimeve euroatlantike dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në ngritjen dhe zhvillimin e operacjonalitetit ushtarak në përgjithësi. Në vazhdim, ministri Mehaj ka informuar për përbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral dhe fushat kryesore të saj. "Kam kënaqësinë të prezantoj arritjen e marrëveshjes

Eshtë i rëndësishëm bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë



midis Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, një bashkëpunim në fushën e mbrojtjes. Njëra prej marrëveshjeve, që e kemi diskutuar e arritur së bashku është realizimi i aktiviteteve të përbashkëta në nivel profesional, pra akademinë mes dy ministrive, është koordinimi i këshillimit nga ana e ekspertizës nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, rendimin e duhur në çështje politike, ushtarake, ligjore për integrimin e

Republikës së Kosovës në drejtim të NATO-s dhe iniciativat rajonale. Një pikë tjetër e rëndësishme së madhe është ngritja e stërvitjeve të përbashkëta ushtarake dhe angazhimeve dhe pjesëmarrjeve në operacione ndërkombëtare në të ardhmen", -tha Mehaj. Në konferencën e dy ministrave u tha se marrëveshja e re e nënshkruar është mbi bazën e disa marrëveshjeve ekzistuese, por përmes saj, synohet bashkëpunimi Shqiptari-Kosovë në nivel më të lartë.

Kapiteni i rangut të I-rë James Hilton, përfundoi detyrën në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti më 11 maj, në një takim kortezie atasheun ushtarak të SHBA-së në Tiranë, kapiten i rangut të I-rë James Hilton, i cili këto ditë përfundon mandatin e tij dhe largohet nga vendi ynë.

Në ceremoninë e organizuar për nder të kapitenit të rangut të I-rë Hilton, ministri i Mbrojtjes Peleshi i dorëzoi ushtarakut të lartë amerikan "Medaljen e Mirënjohjes" me motivacionin: "Për kontributin e veçantë të dhënë nëpërmjet punës së tij si atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mbështetjen dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Duke vlerësuar punën dhe kontributin e atasheut ushtarak të SHBA-së në Tiranë, ministri Peleshi u shpreh se: "Kapiten Hilton do të mbahet mend si një ushtarak i

Ministri Peleshi vlerëson me "Medaljen e Mirënjohjes" atasheun ushtarak amerikan

Motivacioni: "Për kontributin e veçantë të dhënë nëpërmjet punës së tij si atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mbështetjen dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"

devotshëm, i cili e kreu detyrën e tij me profesionalizëm të lartë, por mbi të gjitha do të mbahet mend si një mik i vyer i Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura dhe vendit tonë." Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes i uroi mirëseardhjen në vendin tonë edhe kapitenit të rangut të II-të, David Millner, i cili ka marrë detyrën e atasheut të ri ushtarak të SHBA-së në Shqipëri. Ministri Peleshi siguroi atasheun e ri të SHBA-së se bashkëpunimi në

fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, me të dhe vendin të cilin ai përfaqëson, është një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Më pas, dy ushtarakët e lartë amerikanë u pritën edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, i cili falënderoi kapitenin e rangut të I-rë Hilton, të cilit i dorëzoi certifikatën e mirënjohjes për kontributin e tij në forcimin e bashkëpunimit mes FA shqiptare dhe atyre amerikane.

Pas turit në disa qytete, si Durrës dhe Vlorë, Dita e Hapur e stërvitjes "Defender Europe 21" është ndaluar ditën e dielë, më 23 maj 2021, në Tiranë.

Qytetarët patën mundësi të shohin nga afër, në sheshin "Nënë Tereza" helikopterët Black Hawk, mjetet e blinduara dhe demonstrime të ndryshme të efektivëve amerikanë e shqiptarë.

Pas ekzekutimit të dy himneve, atij shqiptar dhe amerikan, fjalën e hapjes e mori shefi i Përgjithshëm i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj. Ai shprehu angazhimin e ushtarakëve shqiptarë për t'u gjendur pranë qytetarëve në çdo situatë. Ai siguroi dhe aleatët e NATO-s se Forcat e Armatosura janë të gatshme të qëndrojnë krah për krah me aleatët në çdo angazhim. "Mirënjohje për aleatin tonë strategjik SHBA, i garantoj ata dhe të gjithë aleatët e NATO-s se ushtarakët shqiptarë do të jenë të gatshëm për çdo angazhim dhe çdo mision sa herë të kërkohet nga aleatët dhe Aleanca dhe të autorizohet nga autoritetet e vendit. Ne do të jemi garantë me besën dhe besnikërinë e shqiptarit, me vullnetin dhe profesionalizmin ushtarak për të qëndruar krah për krah me kolegët tanë amerikanë dhe të Aleancës dhe në situata më të vështira", - deklaroi gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u bëri thirrje të rinjve që të shohin Forcat e Armatosura si një "mundësi të artë" për karrierë. Ministri Peleshi tha se "Defender 21" ka qenë mundësia më e madhe edhe për të testuar kapacitetet ushtarake të vendit tonë.

"Sot është një ditë e hapur e stërvitjes Defender 21, më e madhe e zhvilluar në dekadën e fundit në Ballkanin Perëndimor. Sot e kemi sjellë këtë stërvitje në zemër të Shqipërisë në zemër të Tiranës, për ta sjellë atë para qytetarëve e për të treguar përmasën civile që e gjithë përpjekja jonë ushtarake ka, si Shqipëri, si aleate e NATO dhe përkrah SHBA. Kjo përpjekje ka për



"Defender Europe 2021"-Dita e Hapur në Tiranë

Ambasadorja Yuri Kim: Kjo është pikë referimi për bashkëpunimin SHBA-Shqipëri



"Defender Europe 21" hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik

qëllim të mbajë paqen, të forcojë demokracinë, të na bëjë të flemë të qetë e të jemi më të sigurt për të ardhmen. U kemi dhënë sot mundësi qytetarëve që ta prekin me dorë se çfarë do të thotë të jesh krenar që je shqiptar. Pas 12 vitesh anëtarësi në NATO, sot ka qenë mundësia më e madhe e historisë tonë për të testuar veten dhe kapacitetin tonë. U bëj ftesë të rinjve ta shohin në

karrierën e tyre si një mundësi të artë pjesëmarrjen pranë Forcave të Armatosura", - tha z. Peleshi.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim nënvizoi se marrëdhënia e Shqipërisë me SHBA-në do të jetë mbi çdo gjë. "Si miq dhe aleatë, ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë në krah të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë. Dhe e dimë

nga ato përvoja që Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria.

“Defender 21” hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik. Kjo rrugë do të mundësojë që ushtarët amerikanë të kthehen në Shqipëri për t’u stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se suksesi i “Defender 21” pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.” -u shpreh diplomatja Yuri Kim.

Teksa vlerësoi ushtarakët dhe përgëzoi ambasadorën e SHBA-së për kontributin dhe përkushtimin në forcimin e kapaciteteve në mbrojtje dhe në drejtësi, kryeministri Edi Rama deklaroi se misioni tjetër i përbashkët mes Shqipërisë dhe SHBA-së do të jetë rritja e kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura.

“Besimi që SHBA-të kanë treguar në vijim tek ky partneritet dhe tek kjo aleancë e madhe strategjike me Shqipërinë e vogël kulmon me këtë stërvitje ushtarake, “Defender Europe 21”, e cila jo rastësisht është stërvitja më e madhe, me përfshirjen më domethënëse që ka ndodhur ndonjëherë në historinë e rajonit tonë. Kam shumë besim, dhe bazuar në bisedat me gjeneralët, që na nderuan me praninë e tyre me hapjen e kësaj stërvitjeje, por dhe me bashkëbisedimin e

vazhdueshëm me ambasadorën e Shteteve të Bashkuara, se ne do të mund të hedhim hapa të tjerë kuptimplotë në rritjen e cilësisë së burimeve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, duke krijuar kështu një hapësirë shumë më tërheqëse edhe për ta materializuar atë thirrje që bëri ministri i Mbrojtjes për të rinjtë, të cilët gjithnjë e më shumë do ta shohin adresën e forcave të Armatosura si një mundësi të artë për formimin dhe për jetën e tyre pas shkollimit”, - deklaroi kryeministri. Z. Rama theksoi se krijimi në Shqipëri i një kapaciteti të ri akademik në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, në partneritet me SHBA-të, është objektiv dhe misioni i përbashkët i qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësisë së Shteteve të Bashkuara këtu në vendin tonë. Presidenti Ilir Meta tha se operacionet e trupave shqiptare me ato amerikane kanë qenë të suksesshme dhe janë realizuar të gjithë objektivat.

“Mbështetja dhe shkëmbimi i eksperiencave mes forcave tona dhe forcave të Amerikës do t’i shërbejë rritjes së kapaciteteve tona mbrojtëse në të ardhmen. Shpreh falënderimet më të përzemërta për kontributin dhe mbështetjen e SHBA-së dhe vendeve të tjera që zgjedhën vendin tonë si vend pritës për organizimin e kësaj stërvitje të rëndësishme. Si një vend anëtar i NATO-s ne jemi një vend mjaft i vlerësuar për këtë fakt. NATO është aleanca më e madhe e lirisë dhe besimi i popullit shqiptar dhe mbështetja ndaj saj është unanime ashtu sikundër edhe vokacioni ynë evropian”, - nënvizoi z. Meta.

“Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Rreth 28 mijë mijë trupa nga SHBA-të, por edhe nga vendet e tjera, aleate të NATO-s, po demonstrojnë një rritje të aftësive ushtarake për të bashkëpunuar si aleatë ushtarakë.

DIPLOMATJA

“Defender 21” hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik. Kjo rrugë do të mundësojë që ushtarët amerikanë të kthehen në Shqipëri për t’u stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se suksesi i “Defender 21” pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.” -u shpreh diplomatja Yuri Kim.



Ambasadorja Yuri Kim: “Kur aleatët e NATO-s bashkëpunojnë ata janë dominues në ajër, tokë apo det”

Trupat amerikane dhe shqiptare, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 2021” kanë ekspozuar pajisjet dhe forcën para qytetarëve të Vlorës në “Lungomare”, ditën e premte, më 21 maj 2021. Aktiviteti, “Dita e Hapur”, u ndoq edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, Ambasadori Britanik Duncan, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera aleate të NATO.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi në përgjigje të interesimit të medias së pranishme sqaroi se: “Kjo ditë e hapur kishte për mision jo vetëm të sillte pranë publikut Stërvitjen “Defender 21”, por edhe të sillte pranë jetës civile, jetën ushtarake, sepse në fund të fundit misioni i FA-së është të sigurojë paqe, stabilitet për qytetarët, të sigurojë gjithashtu mbrojtjen civile.

“Sot i kemi parë pajisjet, kemi parë forcat e ndryshme, kontingjentin tonë, efektivet tanë që po punojnë përkrah forcave amerikane, po shkëmbejnë eksperiencë po marrin eksperiencë dhe për këtë jemi shumë të lumtur dhe shumë krenarë. Përshëndes gjithashtu qytetarët e Vlorës, të gjithë ish - ushtarakët që na kanë shoqëruar, shoqatën e tyre. Nuk është një ditë për ambasadorët apo personalitetet, por është një ditë për qytetarët, të cilët kanë mundësi të shohin nga afër se kush është ushtria shqiptare, se çfarë synon stërvitja “Defender 21”, cilat janë kapacitetet tona dhe në fund fare të marrë një shije të mirë dhe të jetë krenar që është shqiptar”, - u shpreh ministri Peleshi.

Nga ana e saj, ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se prioritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbeten demokracia, mbrojtja dhe biznesi. “Tani jemi duke

“Defender 21” është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore



hyrë në një periudhë domethënëse të gjithë këtyre zhvillimeve. “Defender 21” është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore. Do të thotë që me mijëra trupa nga SHBA, por edhe aleatë të tjerë të NATO-s, disa prej të cilëve janë të përfaqësuar edhe këtu sot, po tregojnë një rritje të aftësive tona për të bashkëpunuar së bashku si aleatë ushtarakë”, u shpreh ambasadorja Yuri Kim.

Teksa përmendi bazat që ajo bashkë me ministrin Peleshi kanë vizituar në kuadër të kësaj stërvitjeje, diplomatja Yuri Kim theksoi se: “Kur aleatët e NATO-s bashkëpunojnë me njëri - tjetrin ata janë dominues qoftë në ajër, në tokë apo në det. Së bashku me këtë zhvillim historik në Mbrojtje kemi parë që ka zhvillime të mëdha të biznesit në një

front tjetër, që do të thotë zhvillime të mëdha nga ana e biznesit amerikan në fushën e energjisë”.

Ndërkohë Ambasadorja Amerikane Kim, Ambasadori Britanik Duncan, Ministri Shqiptar i Mbrojtjes Peleshi, Gjenerali Shqiptar Begaj dhe Kryetari i Bashkisë Leli, vizituan Qendrën e Bashkëpunimit Ushtarak Civil në Vlorë. Në Pashaliman, ata u informuan mbi planet e stërvitjes “Defender Europe 21” të cilat përfshijnë bazën detare. Ata gjithashtu ndoqën ushtarët shqiptarë dhe amerikanë gjatë trajnimeve stërvitore për operacionet e përbashkëta logjistike nga deti në breg. “Defender Europe 21” është krijuar për t’u siguruar që forcat amerikane dhe forcat pjesëmarrëse të NATO-s të jenë trajnuar, të aftë për të vepruar së bashku dhe të gatshëm për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi nga çdo drejtim.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar edhe nga ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim kanë marrë pjesë më 20 maj 2021, në një nga stërvitjet e trupave ushtarake amerikane dhe shqiptare në Bizë ku ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Jim Eifert (Garda Kombëtare e Floridës) dhe Brigadier Jo Chestnutt (Mbretëria e Bashkuar).

Trupat e Security Force Assistance Brigades (SFAB) dhe ato të Batalionit të Dytë të Këmbësisë kryen një sërë demonstrimesh, në kuadër të stërvitjes së "Defender Europe 2021", e cila u ndoq nga të pranishmit. Qitje me mortaja, snajper, veprimet e skuadrës në sulm, goditje objekti dhe rënia në pritë, ishin disa nga demonstrimet e efektivëve. Në përfundim të stërvitjes Ministri i Mbrojtjes u shpreh efektivëve shqiptarë të angazhuar në Bizë përgëzimet e tij, të kryeministrit Edi Rama, por edhe të popullit shqiptar për përfaqësimin dinjitoz të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në këtë stërvitje të rëndësishme.

"Jemi shumë krenarë për punën

Aty ku stërviten trupat ushtarake amerikane dhe shqiptare

Trupat e Security Force Assistance Brigades (SFAB) dhe ato të Batalionit të Dytë të Këmbësisë: qitje me mortaja, snajper, veprimet e skuadrës në sulm, goditje objekti dhe rënia në pritë



që bëni këtu. Ju jeni me fat që në këtë kohë po zhvillojmë një nga stërvitjet më të mëdha të rajonit, jo vetëm të Shqipërisë. Jemi duke bërë një integrim shumë dinjitoz me kolegët amerikanë dhe kjo na bën që të krijojmë më shumë besim në vete, të testojmë kapacitetet

tona. Po e tregoni çdo ditë që ne e justifikojmë të qenit një vend anëtar i NATO-s edhe me standardet", - u shpreh ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. "Defender Europe 2021" po zhvillohet në 7 baza të ndryshme të Shqipërisë dhe do të vijojë deri në mesin e muajit qershor.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim vizitoi më 21 maj, Bazën Ajrore në Kuçovë, ku u takua me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Begaj dhe Gjeneral Brigade të Amerikës, Wanda Williams (Gjenerale Komanduese, nga Komanda e 7-të e Misionit Mbështetës), të cilët mbajtën seanca informuese dhe ushtrime demonstruese. Më pas, Ambasadorja Kim ndoqi ushtrimin e sistemit për mbrojtjen ajrore me raketa nga Artileria e Mbrojtjes Ajrore dhe funksionimin e zonës së mbështetjes logjistike si pjesë e "Defender Europe 21". Ambasadorja u takua me ushtarë amerikanë dhe shqiptarë, si dhe civilë shqiptarë të punësuar për të mbështetur aktivitetet stërvitore dhe i la mbresa se sa mirë ata po punojnë së bashku për të forcuar aftësitë dhe ndërveprimin midis tyre.

Ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim në Bazën Ajrore Kuçovë

"Defender Europe 21" është krijuar për t'u siguruar që forcat amerikane dhe forcat pjesëmarrëse të NATO-s të jenë trajnuar, të aftë për të vepruar së bashku dhe të gatshëm për t'iu përgjigjur çdo kërcënimi. Kjo aftësi është thelbësore për të

shfaqur forcën në çdo moment dhe për të mbështetur aleancën. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bajram Begaj falënderoi ushtarakët amerikanë për praninë e tyre dhe bashkëpunimin me ushtarakët shqiptarë.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti ditën e hënë, me 3 maj, në një takim komandantin e ushtrisë amerikane në Europë dhe Afrikë, gjeneral Christopher Cavoli, në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21". Teksa i uroi mirëseardhjen në Shqipëri gjeneral Cavolit, ministri Peleshi e njohu atë me masat e marra nga vendi ynë për mbarrëvajtjen e kësaj stërvitjeje të rëndësishme. Ministri Peleshi u shpreh besimplotë se kjo stërvitje do të shërbejë si gur themeli për çuarjen përpara dhe intensifikimin e stërvitjeve dypalëshe, Shqipëri-SHBA. Gjithashtu, z. Peleshi konfirmoi gatishmërinë e palës shqiptare jo vetëm për të rritur prezencën në stërvitjet e tjera "Defender Europe 21" jashtë kufijve, por dhe për të mirëpritur serinë e Defender-it '23 dhe '25 në të ardhmen, po në Shqipëri. Ministri Peleshi falënderoi gjeneral Cavolin për mbështetjen e pakursyer që SHBA-të kanë dhënë dhe vijojnë të japin për modernizimin e Forcave të Armatosura të RSH-së, me qëllim rritjen e nivelit të tyre të gatishmërisë, operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë, për të qenë në lartësinë e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes të kohës në të cilën jetojmë. Nga ana e tij,

Ministri Peleshi priti gjeneralin amerikan Christopher Cavoli

Gjeneral Christopher Cavoli mban postin e komandantit të ushtrisë amerikane në Europë dhe Afrikë



gjeneral Cavoli falënderoi vlerësoi maksimalisht masat e marra nga vendi ynë, si vend pritës, për zhvillimin dhe arritjen e objektivave të stërvitjes "Defender Europe 21". Ai nënvizoi rëndësinë që kanë stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta, të cilat rrisin nivelin e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve. Stërvitja "Defender Europe 21" është cilësuar si një mundësi e shkëlqyer që ushtarakët shqiptarë dhe ata

amerikanë, të stërviten së bashku në mënyrë që, ata do të jenë të aftë që në të ardhmen të përballojnë sfidat, po së bashku. Më tej, gjeneral Cavoli siguroi ministrin Peleshi se Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë, do të vijojë të planëzojë dhe zhvillojë stërvitje të përbashkëta me FA-në,

si dhe do të mbështesë në vijimësi procesin e modernizimit të tyre. Bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim mbi angazhimet e shkëlqyera të Shqipërisë në misionet dhe operacionet e Aleancës, por dhe mbi zhvillimet dhe sfidat e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku Shqipëria luan një rol qendror në reduktimin e influencave dhe përpjekjeve destabilizuese të aktorëve te huaj në rajon.

Stërvitja ushtarake shumëkombëshe "Defender Europe 21"

Porti i Durrësit ka mirëpritur një fluks të madh kontenerësh dhe kamionësh të mëdhenj, javën që kaloi në prag të stërvitjeve të NATO-s. Fjala është për një përqendrim mjetesh ushtarake që zyrtarët amerikanë thanë se nuk është parë në vendin buzë Adriatikut që nga Lufta e Dytë Botërore. Rreth 700 pajisje nga Skuadra Ushtarake e Brigadës së 53-të e Këmbësorisë së Gardës Kombëtare të Floridës po shkarkoheshin nga anija US HNS Bob Hope në Durrës. Ato do të përdoren për dy javë trajnim që përfshijnë deri në 6.000 forca amerikane në gjashtë baza ushtarake shqiptare. Kjo është pjesë e stërvitjeve ushtarake shumëkombëshe Defender-Europe 21 të drejtuara nga ushtria amerikane, të cilat janë përqëndruar në parandalimin e agresionit dhe ruajtjen e gatishmërisë operacionale me NATO-n dhe një numër më të madh aleatësh dhe partnerësh. Ato do të zhvillohen nga 17 maji deri më 2 qershor. "Shqipëria është një partner i vlefshëm. Ushtarakët tanë përfitojnë duke u trajnuar së

NATO shkarkon sasi të mëdha mjetesh ushtarake

bashku, duke rritur ndërveprimin, duke ndërtuar gatishmërinë operacionale dhe duke forcuar marrëdhëniet - të gjitha këto mundësojnë aftësinë tonë për t'iu përgjigjur çdo krize, në çdo kohë, së bashku me aleatët dhe partnerët tanë," -tha Tammy Muckenfuss e kontingjentit të ushtrisë amerikane për Europën dhe Afrikën, me qendër në Gjermani. Për majorin Randall Moran, "bashkimi i të gjitha këtyre grupeve është diçka shumë e veçantë". Zhytësit vazhdojnë të kontrollojnë thellësinë prej 7 metrash të portit. Por dy anijet mbështetëse logjistike që transportojnë automjetet mund të veprojnë në ujë të cekët dhe po punonin pa ndërprerje për të sjellë pajisjet ushtarake. Një anije ushtarake britanike do të mbërrijë gjithashtu në ditët e ardhshme. Manovrat Defender-Europe këtë

vit kanë përfshirë rreth 28.000 forca amerikane, aleate dhe partnere nga 26 vende për të kryer operacione të njëkohshme në më shumë se 30 zona trajnimi në më shumë se 12 shtete, nga Balltiku në Detin e Zi dhe Ballkan.

Përveç ofrimit të gjashtë bazave detare, tokësore dhe ajrore, Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, do të angazhojë 1000 trupa në atë që Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e quajti "një ngjarje historike sepse është stërvitja më e madhe në Shqipëri dhe në rajon". Zyrtarët ushtarakë amerikanë vlerësuan mikpritjen, ushqimin e mirë dhe bukurinë natyrore të Shqipërisë. Zonja Muckenfuss tha se: "Shqipëria ka qenë një mikpritëse mahnitëse dhe i ka mirëpritur të gjithë ushtarakët tanë me ngrohtësi."



267 ushtarë të Forcave Amerikane i janë bash-

kuar stërvitjes më të rëndësishme ushtarake në kuadër të NATO-s, "Defender Europe 21", që po zhvillohet në 7 baza të ndryshme ushtarake në Shqipëri. Ka mbërritur ditën e dielë, më 16 maj 2021, në Aeroportin e Rinasit, avioni me 267 ushtarë amerikanë, si pjesë e stërvitjes "Defender Europe 21", e cila që nga data 26 prill po zhvillohet në Shqipëri, ku pjesëmarrës janë një sërë shtetesh, anëtare të NATO-s. E pranishme në mbërritjen e trupave ushtarake të Brigadës 53 të Këmbësorisë, në Aeroportin e Rinasit, ka qenë Ambasadorja Amerikane në Shqipëri, Yuri Kim dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ambasadorja Yuri Kim ka theksuar ndër të tjera, se stërvitja sjell rritje ekonomike.

"Shtetet e Bashkuara kanë shpenzuar 35 milionë dollarë në Shqipëri, duke punësuar qytetarë shqiptarë si shoferë, punëtorë ndërtimi, kuzhinierë dhe në çdo profesion tjetër. Kështu që kjo është shumë e rëndësishme dhe shpresojmë vazhdimin e saj në javët e ardhshme. Ne do të kemi më shumë se 6000 trupa gjithsej këtu. Kjo nuk do të ndodhë njëherësh, por janë 6000 trupa të ndryshme, që do të kalojnë nëpër Shqipëri dhe besoj se në fund të kësaj, të gjithë do të kenë provuar mikpritjen shumë të rrallë dhe të mrekullueshme të Shqipërisë, kurse udhëheqësit ushtarakë do të mund të shikojnë

Ambasadorja Yuri Kim: Trupat e SHBA-së po vijnë në Shqipëri

"Defender Europe 21"-Mbërrin në Rinas avioni me 267 ushtarë amerikanë



Gjenerali Blake Glass: Në javët në vazhdim do të kemi këtu mbi 2000 ushtarë amerikanë që do të marrin pjesë në "Defender Europe 21"

vlerën strategjike të bashkëpunimit dhe aleancës sonë shumë të fortë me Shqipërinë.", - tha ambasadorja Kim.

Komandanti i Brigadës 53 të Këmbësorisë së ushtrisë amerikane, gjenerali Blake Glass, sapo mbërriti në Rinas, tha se kjo stërvitje është një mundësi shumë e mirë për të gjithë, si dhe falenderoi vendin tonë për mikpritjen e treguar. Kolonel Blake Glass, komandant i Skuadrës së 53-të Luftarake të Brigadës së Këmbësorisë e konsideroi një rast shumë të mirë bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21".

"Dua t'i falënderoj të gjithë për mikpritjen. Jemi shumë të entuziazmuar që jemi këtu në Shqipëri për stërvitjen "Defender 21". Në javët në vazhdim do të kemi mbi 2000 ushtarë amerikanë që do të marrin pjesë. Është një mundësi shumë e madhe për të mësuar të gjithë nga

kjo stërvitje dhe jemi këtu për të punuar me aleatët tanë të NATO-s", -tha gjenerali duke folur për mediat. Gjeneralmajor Bajram Begaj tha se "Kjo është një stërvitje historike që për herë të parë zhvillohet në Shqipëri. Ne si vend pritës, sot pritëm 267 trupa amerikane të cilat janë pjesë e kësaj stërvitjeje e cila ka tre komponente: stërvitje që prek fushën ajrore, tokësore dhe detare. Trupat amerikane që erdhën sot janë pjesë e stërvitjes tokësore që do të zhvillohet në Bizë".

Ardhja e trupave amerikane në Tiranë është përshëndetur nga ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi i cili u shpreh në facebook se: "Në vijim të stërvitjes Defender Europe 21, kane mbërritur në Rinas edhe 267 trupa të tjerë të ushtrisë amerikane për tu bashkuar në stërvitjen e përbashkët me Forcat tona të Armatosura në 7 baza të ndryshme ushtarake. Stërvitimi së bashku, mbrojmë së bashku!".

Ambasadorja Amerikane në Shqipëri, Yuri Kim është prononcuar përsëri lidhur me rëndësinë e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare "Defender Europe 21". Ajo tha në intervistën për emisionin "Opinion", se nuk është rastësi që është përzgjedhur Shqipëria, Kim tha se, "Siç e dini, kemi tri prioritete këtu: demokracia, mbrojtja, biznesi dhe duam të bëjmë përparim në të trija këto sepse janë të ndërlidhura. Nuk është vetëm reforma në drejtësi për hir të reformës në drejtësi. Nuk është thjesht biznesi për hir të biznesit. Nuk janë thjesht ushtarë. Më lejoni t'ju jap disa shifra për Defender 21. Janë deri në 6,000 ushtarë amerikanë që do të jenë në Shqipëri, jo të gjithë njëherësh, por gjatë shtrirjes së stërvitjes".

Zyrtarisht u hap më 1 maj dhe më 4 maj erdhën tri gjeneralë me katër yje, gjeneralë amerikanë... Është historike, apo jo? Kështu, stërvitja do të vazhdojë deri në fund të qershorit, dhe është pjesë e një stërvitjeje më të gjerë që përfshin 28,000 trupa shumëkombëshe që vijnë nga 26 vende dhe po zhvillojnë aktivitete thuajse në të njëjtën kohë në 16 vende. Shqipëria ndodh të jetë një prej mikpritëseve më të mëdha. Shqipëria po mirëpret shumicën e aktiviteteve nga ato 16 vende dhe them që nuk është rastësi. Tregon që ne jemi seriozë për rëndësinë e Shqipërisë si aleate në NATO dhe mendoj që tregon edhe se Shqipëria është serioze lidhur me rolin e saj si aleate e NATO-s. Ajo që do të ndodhë përmes këtyre stërvitjeve është që do të kemi këta mijëra trupa që kryejnë të gjitha këto ushtrime në tokë, det dhe ajër. Në tokë, do të thotë stërvitje për të çuar trupa sa më shpejt që mundet nga një pikë në një tjetër; në det, do të thotë që stërvitemi t'i çojmë këto pajisje nga një pikë fundore tek tjetra, t'i transportojmë këtu dhe t'i kalojmë në tokë. Tani, tingëllon e thjeshtë, por kur flet për mijëra automjete dhe kur flet për karburant, është jashtë mase i vështirë si operacion logjistik. Në ajër nënkupton mbrojtjen ajrore dhe mbrojtjen raketore. Pra, do të testojmë aftësinë tonë për të punuar së bashku si aleatë, për të mbrojtur hapësirën ajrore të miqve

Yuri Kim: Shqipëria është një aleate absolutisht besnike dhe e aftë

Janë deri në 6,000 ushtarë amerikanë që do të jenë në Shqipëri, jo të gjithë njëherësh, por gjatë shtrirjes së stërvitjes "Defender Europe 21"



dhe aleatëve tanë në Europë", tha Kim. "Shqipëria është një aleate absolutisht besnike dhe e aftë dhe, ajo që duam është të ndërtojmë mbi këtë. E para që duhet të bëjmë është, si çdo aleat tjetër, Shqipëria duhet t'i kushtojë 2% të PBB të saj mbrojtjes deri në vitin 2024. Kjo është një marrëveshje që e bënë

të gjithë aleatët në vitin 2014 në Uells. Shqipëria është në rrugë të mbarë për këtë. E dyta është që do të rrisim stërvitjet dhe trajnimet tona dypalëshe dhe shumëpalëshe me forcat shqiptare në mënyrë që të rrisni aftësitë. Mendoj se e gjitha është në një trajektore pozitive", -tha Kim.

Stërvitja "Defender Europe 21"

Rinas: Trupat amerikane displokohn në Qendrën e Kontroll-Raportimit

Në Forcën Ajrore në garnizonin Rinas, në kuadër të Stërvitjes "Defender Europe 21", u dislokuan trupat amerikane në Sallën Operacionale të Qendrës së Kontroll - Raportimit, për fillimin e stërvitjes "Astral Knight 21". Kjo stërvitje do të fillojë në gjysmën e dytë të muajit maj 2021 dhe ka për qëllim integrimin dhe ndërveprimin e komunikimit midis Sallës Operacionale të Qendrës së Kontroll-Raportimit në Shqipëri me Qendrën Operacionale të Ushtrisë Amerikane në Europë si dhe shkëmbimin e ekspertizës profesionale të ekipeve respektive. Ekipet ushtarake të Sallës Operacionale në Qendrën e Kontroll - Raportimit të Forcave të Armatosura Shqiptare gjatë kësaj stërvitjeje do të familjarizohen gjithashtu dhe aftësohen të komunikojnë e ndërveprojnë së bashku me kolegët ushtarakë amerikanë sipas standardeve të NATO-s.

Intervistë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi

Kapacitetet tona ushtarake vlejné për ne, por edhe për aleatët në NATO

“Stërvitjet ushtarake zhvillohen në një botë e cila nuk është ashtu siç do të donim të gjithë të ishte, pra nuk është e gjitha e qetë duke parë zhvillimet gjeopolitike. Ka forca të ndryshme, kemi forca rivale. Rajoni i ballkanit, ballkani perëndimor, është një terren ku ndeshen edhe forcat rivale ndaj vlerave tona, ku ndeshen interesa të ndryshme”.

Zoti ministër, në stërvitjen e madhe ushtarake “Defender Europe 21” marrin pjesë 28 mijë trupa nga 26 vende anëtare dhe partnere të NATO-s, po çfarë do të thotë kjo për Shqipërinë?

Kjo stërvitje është më e madhja e zhvilluar në vendin tonë ndonjëherë, në historinë tonë, madje edhe në rajonin tonë, të paktën në dekadën e fundit nuk ka patur një stërvitje më të madhe se kjo. Shqipëria ka fatin e madh, por nuk është çështje fati, besoj, jam i bindur, është edhe e zgjedhur si e tillë, që të jetë vendi pritës. Porti i Durrësit është porti kryesor i zbarkimeve të trupave, krahas shumë porteve të tjera, të cilat janë rreth 5 porte dhe 12 aeroporte që marrin pjesë në të gjitha vendet europiane, të angazhuara në këtë stërvitje. Porti i Durrësit po testohet si i tillë. Duhet thënë se fillojnë

një seri stërvitjesh “Defender” nga ky vit, ku çdo vit, në vitet tek, stërvitjet do të zhvillohen në Europën Jugore, kurse në vitet çift, stërvitja do të zhvillohet në Europën Veriore, në vendet Balltike. Ne shpresojmë dhe janë të gjitha gjasat që Shqipëria nuk do të jetë viti pritës vetëm për “Defender Europe 21”, por edhe “Defender Europe 23”, “Defender Europe 25” e në vazhdim, pra në çdo vit tek, kur stërvitja do të zhvillohet në jug.

Rëndësia e stërvitjes ndërkombëtare ushtarake “Defender Europe 21”, duket edhe nga fakti që në ceremoninë e zhvilluar në portin e Durrësit më 4 maj 2021, ishin të pranishëm Kryeministri Rama, Presidenti Meta, tre gjenerale të NATO-s, midis tyre Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europianë të NATO-s, Tod Walters, Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, trupi diplomatik, atashe ushtarakë, etj. Po për njeriun e thjeshtë, për çfarë duhen këto stërvitje kaq të mëdha, kaq të rëndësishme?

Këto stërvitje janë stërvitje ushtarake në shërbim të paqes dhe NATO është aleanca më e madhe botërore politike dhe ushtarake, ne jemi pjesë e saj, një nga zhvillimet më të rëndësishme pas viteve 90 për vendin tonë, në pozicionimin më strategjik dhe më të fortë, atë të Shqipërisë në krah të perëndimit, një prirje natyrale dhe historike e Shqipërisë. Stërvitjet ushtarake zhvillohen në një botë e cila nuk është ashtu siç do të donim të gjithë të ishte, pra nuk është e gjitha e qetë duke parë zhvillimet gjeopolitike. Ka forca të ndryshme, kemi forca rivale. Rajoni i ballkanit, ballkani perëndimor, është



një terren ku ndeshen edhe forcat rivale ndaj vlerave tona, ku ndeshen interesa të ndryshme. Prandaj kjo stërvitje ka interes strategjik të cilin e kemi përmendur shpesh. Ne na çimenton si vend strategjik për aleancën euroatlantike, por edhe për vendet e ballkanit perëndimor, ku shqipëria ka një rol të rëndësishëm për të luajtur. Jetojnë shqiptarë në pesë shtete të Ballkanit, ne jemi një vend që nuk ka përplasje etnike, nuk kemi asnjë forcë politike që të ketë axhendë tjetër, përveç axhendës integruese euroatlantike. Ne jemi vendi pritës i kësaj stërvitjeje, nga këtu hyjnë dhe zbarkojnë të gjitha trupat, ku porti i Durrësit është porti kryesor i kësaj stërvitjeje. Jo vetëm pozicioni ynë strategjik, por edhe qasja jonë perëndimore dhe proamerikanizmi ynë ka rol të veçantë.

Në ditën e hapjes të "Defender Europe 21", apo Ditën e Vizitorëve të Shquar, Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, në fjalën e saj tha se "nuk u zgjodh rastësisht Shqipëria dhe se roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë", si duhet ta kuptojmë këtë deklaratë të diplomates amerikane?

Së pari: pozicioni i jashtëzakonshëm strategjik; së dyti: roli i madh që ne luajmë dhe mund të luajmë në Ballkanin Perëndimor për ta mbajtur orientimin e këtij rajoni të rëndësishëm nga perëndimi; së treti: miqësia apo lidhja shumë e fortë që ne kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimin dhe së katërti: zgjedhja jonë për të patur si partner strategjik Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duhet thënë se stërvitja "Defender Europe 21", organizohet nga Komanda Europiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në kuadrin dhe standartet e NATO-s

Zoti ministër, flitet se në të kaluarën ushtria jonë ka qënë e fuqishme me avionë reaktivë, avionë luftarakë, kundërajrorë, etj.. Çfarë mund të themi për ushtrinë shqiptare sot, potencialin e saj dhe a janë ushtarakët tanë në nivelin e homologëve të Aleatëve, në aspektin profesional?

Padyshim që në përmasa, nuk mund të krahasohemi me çmendurinë e sistemit të kaluar ku "gjithë populli ishin ushtarë" dhe ku kishte tjetër qasje. Sot lajm i mirë është se ne jemi pjesë e një aleance të madhe me të cilën ndajmë role, qasemi në

Europianë të NATO-s; Gjeneral Jeffrey Harrigian, Komandant i Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europë-Forcave Ajrore Afrikë, si dhe Komandës Ajrore Aleate; dhe Gjeneral Christopher Cavoli, Komandant i Ushtrisë së SHBA në Europë dhe Afrikë. Pra një prezencë e jashtëzakonshme, domethënëse.

Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europianë të NATO-s, Tod Walters, në fjalën e tij në Durrës e cilësoi Shqipërinë "eksportues të sigurisë" dhe ka përshëndetur dhe



të njëjtat standarte, marim përsipër atë që na takon. Duhet thënë se ne jemi një vend i vogël, në Aleancën e madhe të NATO-s, por kontributi ynë nuk është në proporcion me madhësinë e këtij vendi. Kontributi ynë është shumë herë më i madh, siç është pjesëmarrja jonë në misionet e NATO-s, apo operacionet e NATO-s si në Afganistan, Irak, Kosovë, Letoni, Sudanin e Jugut. Ushtarakët tanë kanë dhënë jetën në misionet ndërkombëtare si në Afganistan apo Letoni.

Në ditën e hapjes të "Defender Europe 21", apo Ditën e Vizitorëve të Shquar, morën pjesë tre gjeneralë amerikanë me katër yje. Gjeneral Tod Walters, Komandant i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve

vlerësuar rolin e madh që ne luajmë në NATO. Po të shohim matricën e trupave ushtarake në Afganistan, ku po tërhiqemi sipas vendimit të përbashkët të Aleancës, ne kemi kontribut të rëndësishëm. Ne perpiqemi të tregojmë se nuk jemi thjeshtë një vend prezent, por jemi një vend me kontribute të çmuara atje, e tregojmë nga pjesëmarrja në misione, por e tregojmë edhe nëpërmjet faktoreve që i vlejnë NATO-s. Unë mendoj se një vend i vogël dhe në zhvillim si Shqipëria nuk ka nevojë të komplikohet se është i fundit në të gjitha standartet. Ne nuk mund të ndërtojmë dot batalione të mëdha, por ne kemi aftësinë për të zhvilluar kapacitete që iu vlejnë jo vetëm Shqipërisë, por edhe aleatëve në NATO.

Shqipëria do të marrë helikopterë Black Hawk brenda vitit 2023

Aktualisht NATO nuk ka plane konkrete për të ndërtuar një tjetër bazë ushtarake në Shqipëri përveç bazës ajrore të Kuçovës, ndërkohë që qeveria shqiptare pritët të marrë brenda vitit 2023 helikopterë "Black Hawk" si pjesë e shtimit të kapaciteteve ushtarake.

Këtë e tha kreu i Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen në Ambasadën e SHBA-së, Erol Munir. Duke komentuar stërvitjen "Defender Europe 2021", të cilën Munir e cilësoi si "jashtëzakonisht të suksesshme", ai tha se vitet e fundit Shqipërinë e kanë vizituar disa gjeneralë të rëndësishëm të NATO-s për të shqyrtuar mundësinë për investime.

"Aktualisht nuk kemi asnjë plan për të ndërtuar baza të NATO-s në Shqipëri, por së fundmi kemi pasur vizitën e tre gjeneralëve të rëndësishëm në Shqipëri, një prej të cilëve Gjenerali Tod D. Wolters, komandanti i forcave amerikane të vendosura në Europë, gjithashtu gjeneralët e tjerë të cilët bënë një vlerësim të infrastrukturës së Shqipërisë. Do të shikojmë bazat që janë të vendosura në Shqipëri për të pasur në vëmendje nëse mund të kemi investim në të ardhmen, por aktualisht nuk kemi ndonjë plan konkret përveç bazës që kemi në Kuçovë, e cila do të fillojë punimet së shpejti këtë vit," - u shpreh Munir.

Zyrtari amerikan tha se në bazën e Kuçovës tashmë janë vendosur raketahedhëset "Patriot", të cilat janë fjala e fundit e teknologjisë së sigurisë ushtarake.

Munir tregoi se në stërvitjen "Defender 21" morën pjesë forca nga 26 vende të ndryshme të botës, të cilat erdhën në Shqipëri me armatime të ndryshme detare, tokësore dhe ajrore. Ai tha se 12 helikopterë "Black Hawk" ishin pjesë e stërvitjes dhe më tej njoftoi se së shpejti helikopterë të tillë do të ketë edhe Shqipëria. "Shqipëria



do të marrë dy helikopterë Black Hawk në vitin 2023," - tha Munir.

"Do të vazhdojmë të ndihmojmë forcat e armatosura shqiptare për të shtuar kapacitetet e tyre dhe kjo nuk do të ndalojë për kohën që do të vijojë," - shtoi zyrtari amerikan. Kreu i Zyrës së Bashkëpunimit për Mbrojtjen në Ambasadën e SHBA-së tha se Shqipëria u zgjodh për stërvitjen ushtarake të NATO-s prej gjeografisë, pozicionit gjeostrategjik, prej faktit se është "pro-amerikan" dhe ka kapacitetin për pritjen e forcave. Munir tha

se plani i forcave të Aleancës së Atlantikut të Veriut është që të jetë gati për ato që mund të ndodhin në situata, apo kriza të caktuara të Europës. Pjesëmarrës në stërvitje ishin edhe një grup prej Forcave të Sigurisë së Kosovës, për të cilët Munir tha se ishte i lumtur për bashkëpunimin e tyre. Zyrtari amerikan tha se stërvitja "Defender Europe 2021" është vetëm fillimi dhe se pritët që në vazhdim ushtarë nga SHBA do të vijnë në Shqipëri për t'u stërvitur.

Dy pilote ushtarake që bashkojnë SHBA dhe Shqipërinë në "Defender 2021"

Ato janë pilote Valdete Mehanja e cila ka lindur në Kosovë dhe tani sherben në Regjimentin e Aviacionit 1-131, në Gardën Kombëtare të Alabamës dhe Armela Murati nga Shqipëria që po ndjek kursit e pilotes për helikopterët ushtarakë në Farkë

Ambasada e SHBA-së në Tiranë ka zgjedhur si foto të ditës, Togeren Valdeta Mehanja nga Garda Kombëtare e Alabamës e lindur në Kosovë dhe Togeren e 2-të Armela Murati, në aerodromin e Farkës në Shqipëri. "Njihuni me të "parat" të cilat po bëjnë hapa përpara drejt barazisë. Togerja e 2-të Valdeta Mehanja (majtas), pilote helikopteri me Regjimentin e Aviacionit 1-131 nga Garda Kombëtare e Alabamës dhe shqiptare e lindur në Kosovë, bisedoi mbi ngjashmëritë midis tyre me piloten e helikopterit të parë shqiptare femër, Togeren e 2-të Armela Murati, në aerodromin e Farkës në Shqipëri, ndërsa marrin pjesë së bashku në "Defender Europe 21", shprehet ambasada, duke sqaruar rolin e "Defender-Europe 21". shprehet ambasada amerikane në Tiranë.

"Defender-Europe 21" është një ushtrim i përbashkët vjetor, shumëkombësh, i udhëhequr nga ushtria amerikane në shkallë të gjerë, i krijuar për të krijuar gatishmërinë dhe ndërveprimin midis ushtrive të SHBA, NATO dhe partnerëve.

Ky takim emocionues, më pas ka gjetur vend më 25 maj edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes. Në të thuhet se: "Valdete Mehanja dhe Armela Murati janë dy pilotet që duket i kanë dhënë kuptimin e vërtetë qëllimit të stërvitjes më të rëndësishme që zhvillohet në Evropë, "Defender 2021", ndërveprimi mes aleatëve të NATO-s. Nëntoger Valdete Mehanja ka lindur në Kosovë, por prej vitesh ajo është pilote helikopteri me Regjimentin e Aviacionit 1-131, në Gardën Kombëtare të Alabamës. Ajo ka ardhur në Shqipëri si pjesë e trupave amerikane që po marrin pjesë në stërvitjen "Defender '21". Në Bazën Ajrore të Farkës ajo është takuar me të vetmen vajzë të kursit të pilotit për helikopterët ushtarakë, nëntoger Armela Muratin. Armela i është bashkuar prej një viti Forcave të Armatosura shqiptare dhe thotë se ka zgjedhur rastësisht këtë kurs,



pasi u emërua në Forcën Ajrore.

Të dyja vajzat kanë ndarë mes tyre sekretet e profesionit, por edhe kanë bashkuar ambicien për të qenë të barabarta mes burrash në këtë profesion.

Nëntoger Mehanja thotë se për të ishte befasi të vinte në Shqipëri si ushtarë amerikane, pasi nuk kishte qenë asnjëherë më parë. E pyetur përse kishte zgjedhur t'i bashkohej ushtrisë amerikane, ajo ka një arsye të fortë: "I jam bashkuar ushtrisë amerikane, sepse kjo ushtri, veçanërisht Amerika e ka ndihmuar shumë popullin shqiptar, sidomos Kosovën. Dhe e ndiej veten si në borxh". Nëntoger Mehanja thotë se më herët ka qenë pilote civile.

Ndërsa nëntoger Armela Murati,

teksta dëgjon nga kolegja amerikane këshillat në gjuhën shqipe, thotë se ka marrë mbështetje dhe kurajë në një mjedis ku mbizotërojnë burrat. "Nuk kisha synim të bëhesha pilote. Thjesht doja t'i shërbeja vendit tim, fati deshi që unë t'i bashkohem Forcës Ajrore dhe tashmë jam edhe kursante. Presioni është goxha i madh, por unë kam ardhur me synime të qarta dhe dua që këtë hap që kam hedhur ta çoj deri në fund", shprehet nëntoger Murati. E këtë ambicie të vajzës së re nga Shqipëria e inkurajon nëntoger Valdete Mehanja, e cila ka kaluar 11 vjet për të arritur deri këtu. "Mos u dorëzo, se gjithçka ia vlen!", shprehet shqiptarja nga Kosova që përfaqëson SHBA në "Defender 2021".

Mblidhet Komiteti ushtarak i NATO-s në Bruksel, Belgjikë

Gjeneralmajor Begaj në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Komiteti Ushtarak i NATO në nivel shefash shtabi mbledhet tre herë në vit për të diskutuar mbi misionet dhe operacionet e NATO

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj i shoqëruar nga përfaqësuesi ushtarak i RSH në NATO gjeneralmajor Nazmi Cahani, mori pjesë me 18 maj 2021, në takimin e radhës së Komitetit Ushtarak të NATO-s, të zhvilluar në Komandën e Aleancës Bruksel, Belgjikë.

Në këtë takim të drejtuar nga kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO, marshall sir Stuart Peach morën pjesë shefat e shtabeve të vendeve të Aleancës, të cilët diskutuan misionet dhe operacionet e Aleancës, konceptet strategjike të Mbrojtjes së hapësirës euroatlantike, si dhe sfidat në përballjen me rreziqet e kërcënimit në 20 vitet e ardhshme. Fokusi kryesor u përqendrua në modernizimin e Aleancës, planifikimin ushtarak, operacionet e NATO-s si dhe në marrëdhëniet me Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar Komitetit Ushtarak, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u shpreh se Samiti i NATO-s në qershor, do të jetë një mundësi unike për të provuar në të ardhmen Aleancën tonë, për të gjallëruar lidhjen transatlantike dhe për të demonstruar angazhimin tonë për

solidaritetin transatlantik, jo vetëm me fjalë por edhe me vepra.

Në sesionin I të takimit, shefat e shtabeve u informuan mbi situatën më të fundit të angazhimeve të NATO-s dhe diskutuan për të tashmen dhe të ardhmen e tyre. Me tërheqjen e trupave ushtarake nga Afganistani, shefat e Shtabeve të Aleancës shkëmbyen mendime mbi progresin dhe marrëdhëniet e ardhshme NATO-Afganistan. Duke ripërsëritur kohezionin në qëndrimin e tyre të gjithë shefat e shtabeve që morën fjalën konfirmuan mbështetjen për misionet dhe operacionet dhe qasjen e pandryshueshme në lidhje me vendimmarrjen e ardhshme të përbashkët.

Lidershipi ushtarak i vendeve të Aleancës konfirmoi se prova e parë e madhe e Aleancës dhe Strukturës së Komandës së saj të adaptuar, është stërvitja madhore "Steadfast Defender 21", me pjesëmarrjen e më shumë se 20 aleatëve nga Amerika e Veriut dhe Evropa. Kjo stërvitje do të ndihmojë në përmirësimin e gatishmërisë dhe ndërveprimit të forcave aleate dhe praktikimin e lëvizshmërisë ushtarake në të gjithë Evropën. Në sesionin II të takimit u diskutuan propozimet mbi mbështetjen ushtarake të NATO deri në vitin 2030, si dhe konceptet strategjike ushtarake nën zhvillim që lidhen me shkurajimin dhe mbrojtjen e zonës euroatlantike dhe kapacitetet luftarake të Aleancës. Gjithashtu, shefat e Shtabeve të Aleancës shprehën vlerësimin e tyre për kontributin e Ukrainës dhe Gjeorgjisë në misionet e NATO-s si dhe rolin e tyre në sigurinë në rajonin e Detit të Zi. Komiteti Ushtarak i NATO në nivel shefash shtabi mbledhet tre herë në vit për të diskutuar mbi misionet dhe operacionet e NATO, si dhe për t'i ofruar Këshillit të Atlantikut të Veriut, këshillën ushtarake mbi një sërë sfidash që kërcënojnë sigurinë globale. Gjatë këtij aktiviteti shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Begaj zhvilloi takime edhe me personelin e Përfaqësuesisë.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi më 11 maj, një takim me atashen ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kapiten i Rangut të I-rë James Hilton, në kuadër të përfundimit të mandatit të atashut ushtarak rezident në Tiranë. Gjeneralmajor Begaj, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, bashkëpunim i konkretizuar së fundmi edhe me stërvitjen "Defender Europe 21", ku Shqipëria është bërë vend mikpritës. Gjatë takimit u prezantua atashu i ri ushtarak i SHBA-së, Kapiten i Rangut të II-të David H. Millner. Gjeneralmajor Begaj i uroi mirëseardhjen atashut të ri dhe e siguroi për mikpritjen shqiptare dhe mbështetjen për vijimin e projekteve të bashkëpunimit ushtarak midis ushtrive të të dy vendeve. Kapiten i Rangut të II-të David H. Millner është diplomuar si Oficer i Inteligjencës Detare në vitin 2002 dhe ka shërbyer edhe jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si në: Afganistan, Japoni,

David H. Millner do të jetë atashu i ri ushtarak i SHBA-së

Kapiten i Rangut të II-të David H. Millner është diplomuar si Oficer i Inteligjencës Detare në vitin 2002. Ai gjithashtu është një njohës i mirë i gjuhës shqipe



Itali dhe Kili. Ai gjithashtu është një njohës i mirë i gjuhës shqipe. Në përfundim të takimit, u zhvillua një ceremoni e shkurtër me prezencën e titullarëve më të lartë ushtarakë të FARSH-it. Gjatë kësaj ceremonie Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Be-

gaj, i akordoi Kapitenit të Rangut të I-rë James Hilton, "Certifikatë Vlerësimi", me motivacionin: "Për kontribut të shquar në rritjen e nivelit të bashkëpunimit ushtarak midis Forcave të Armatosura të SHBA-së dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega, priti më 12 maj, në një takim kortezie atashen ushtarak të SHBA në Tiranë, kapiten i rangut I James Hilton, i cili shoqërohej nga zëvendësuesi i tij në këtë detyrë, atashu i ri ushtarak i SHBA-së kapiten i rangut II, David Millner. Kolonel Gega duke ju shprehur mirëseardhjen në Komandën Mbështetëse, ju uroi atyre njëkohësisht suksese në detyrat e radhës. Gjatë takimit ushtarakët e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcat e Armatosura të SHBA, nga arsimimi dhe trajnimi i ushtarakëve shqiptarë në fushën e logjistikës, mbështetjen konkrete me materiale didaktike, teknike dhe gjithashtu stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve të zhvilluara ndërvite. Zëvendëskomandanti i Ko-

Kapitenët James Hilton dhe David Millner në Komandën Mbështetëse

mandës Mbështetëse vlerësoi kontributin e çmuar të kapiten të rangut I Hilton, gjatë qëndrimit të tij në detyrën e atashut ushtarak amerikan në Shqipëri, për mbështetjen që ka dhënë në përgjithësi për Forcat tona të Armatosura dhe veçanërisht për Komandën Mbështetëse "Kapiten rangut I Hilton do të mbetet një mik i veçantë për ne, për kontributin e shkëlqyer që ai ka dhënë në forcimin e partneritetit strategjik e sidomos në fushën logjistike midis SHBA dhe Shqipërisë" - theksoi zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gega. Nga ana e tij, kapiten rangut I Hilton vlerësoi arritjet e Komandës Mbështetëse bërë gjatë kësaj periudhe, ai vlerësoi bashkëpunimin me

këtë komandë dhe theksoi se ndihej krenar që shërbeu në një vend me një histori të madhe dhe të çmuar sikurse Shqipëria. Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe shpresoj që kapiten i rangut II Millner të bëjë më shumë për forcimin e këtij bashkëpunimit. Më tej, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gega uroi atashen e ri ushtarak të SHBA në Shqipëri, kapiten rangut II Millner për marrjen e detyrës së re dhe garantoi bashkëpunim të vazhdueshëm në fushën e logjistikës. Në fund të vizitës kolonel Gega i dhuroj kapiten rangut I Hilton stemën e Komandës Mbështetëse dhe sëbashku panë nga afër depon e materialeve të dhuruara nga pala amerikane.

Gjeneralbrigade Kingji takohet me atasheun ushtarak të SHBA-së

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilloi një takim me atasheun ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapiten i rangut të I-rë James Hilton, në kuadër të përfundimit të mandatit të atasheut ushtarak rezident në Tiranë.

Gjeneral brigade Arben Kingji, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, bashkëpunim i konkretizuar së fundmi edhe me stërvitjen "Defender Europe 21".

Gjatë takimit u prezantua atasheu i ri ushtarak i SHBA-së, kapiten i rangut të II-të David H. Millner, Komandanti i Forcës Tokësore i uroi mirëseardhjen atasheut të ri dhe e siguroi për mikpritjen shqiptare dhe mbështetjen për vijimin e projekteve të bashkëpunimit ushtarak midis ushtrive të të dy vendeve kryesisht të Forcave Tokësore.

Kapiten i rangut të II-të David H. Millner është diplomuar si Oficer i Inteligjencës Detare në vitin 2002 dhe ka shërbyer edhe jashtë Shteteve të Bashkuara të



Do të vazhdojë mbështetja për vijimin e projekteve të bashkëpunimit ushtarak midis ushtrive të të dy vendeve kryesisht të Forcave Tokësore



Amerikës, si: Afganistan, Japoni, Itali dhe Kili. Ai gjithashtu është një njohës i mirë i gjuhës shqipe. Në përfundim të takimit gjeneral brigade Kingji shkëmbeu një

dhuratë simbolike me atasheun ushtarak, kapiten i rangut të I-rë James Hilton, në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në detyrën e tij.

Stërvitja "Defender Europe 21"

Më 6 maj, paradite në Bazën Ajrore Kuçovë zhvilloi një vizitë komandanti i Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan, për të parë nga afër dhe inspektuar bazën dhe trupat amerikane të dislokuara në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21". Gjeneralmajor Mohan u prit nga shefi i Shtabit i Forcës Ajrore kolonel Arben Cenolli. Gjeneralmajori Mohan shprehu falënderimet për bashkëpunimin dhe mbështetjen e trupave amerikane dhe të forcave të tjera pjesëmarrëse në këtë stërvitje. Më pas ata inspektuan dhe u njohën me Bazën Ajrore Kuçovë. Në fund të vizitës gjeneralmajor Mohan pati një takim të veçantë me komandantin e Bazës Ajrore Kuçovë.

Gjeneralmajor Christopher O. Mohan viziton Bazën Ajrore Kuçovë



Atashetë ushtarakë amerikanë në Forcën Detare dhe Forcën Ajrore

Me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë, atashë ushtarak amerikan, kapiten i Rangut të I-rë James Hilton i shoqëruar nga atashë i ri ushtarak i SHBA-së, kapiten i Rangut të II-të David H. Millner, kanë zhvilluar vizita në Komandën e Forcave Ajrore, Komandën e Mbështetjes, Forcës Tokësore por edhe në Komandën e Forcës Detare.

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, paraditen e datës 12 maj, ka pritur në një vizitë atashë ushtarak, kapiten i Rangut të I-rë James Hilton të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë.

Gjatë takimit u prezantua atashë i ri ushtarak i SHBA-së, kapiten i Rangut të II-të David H. Millner. Komandanti i Forcës Detare i uroi mirëseardhjen atashëut të ri, dhe e siguroi për mbështetjen e vazhdueshme, duke konsideruar marrëdhëniet shumë të mira mes Forcave të dy vendeve dhe shprehu falënderim për bashkëpunimin ushtarak e ndihmën e dhënë nga pala amerikane për Forcën Detare. Gjeneral brigade Xhebexhia shprehu falënderim dhe për bashkëpunimin e zhvilluar së fundmi me stërvitjen "Defender Europe 21". Ushtarakët amerikanë gjithashtu vlerësuan frymën e bashkëpunimit me Forcën Detare duke u shprehur se do të vazhdojë i tillë edhe gjatë mandatit të atashëut Hilton.

Ndërsa në Komandën e Forcës Ajrore, ushtarakët amerikanë janë pritur nga Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj. Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore pasi i uroi mirëseardhjen në komandën e Forcës Ajrore, theksoi mbështetjen dhe bash-



këpunimin e shkëlqyer me atashë ushtarak amerikan dhe Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, bashkëpunim ky, i cili do jetësohet me projektet madhore të modernizimit të Forcës Ajrore me marrjen e helikopterëve Black Hawk dhe mirëmbajtjes së tyre por edhe të trajnimit e kualifikimit të ekuipazheve fluturuese.

Atashetë ushtarakë shprehën falënderimet për mikpritjen duke siguruar për vazhdimësinë e këtij

bashkëpunimi të shkëlqyer me projektet që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve ajrore operacionale dhe modernizimin e Forcës Ajrore.

Në takim u diskutua gjithashtu roli, kontributi i Forcës Ajrore dhe mbarëvajtja e Stërvitjes "Defender Europe-21" si dhe rritja e pjesëmarrjes në stërvitje të tilla të përbashkëta por edhe gamës së bashkëpunimeve e projekteve që lidhen me zhvillimin e Forcës Ajrore dhe strukturave të saj.



FA trajnohen me partnerët e Mbretërisë së Bashkuar

“Forcat e Armatosura Shqiptare po zhvillojnë trajnime të përbashkëta me partnerët e Mbretërisë së Bashkuar, -bëri të ditur Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, e cila publikoi edhe disa foto nga ky trajnim. Sipas Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, trupat nga të dyja vendet janë përfshirë në trajnime të përbashkëta për ndihmë mjekësore, lexim hartash dhe patrullim. Trajnimet mbështetin Forcat e Armatosura të Shqipërisë në ndjekjen dhe arritjen e kapaciteteve të synuara në kuadrin e NATO-s, -thekson më tej Ambasada.

“Forcat e Armatosura Shqiptare trajnohen së bashku me partnerët e Mbretërisë së Bashkuar. Trupat nga të dyja vendet janë përfshirë në trajnime të përbashkëta për ndihmë mjekësore, lexim hartash dhe patrullim. Trajnimet



mbështetin Forcat e Armatosura Shqiptare në ndjekjen dhe arritjen e kapaciteteve të synuara

në kuadrin e NATO-s”, -bën të ditur Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë.

Stërvitja “Defender Europë 21”

Në kuadër të paketës së stërvitjeve “Defender-21”, në periudhën 16-29 maj në Kroaci u zhvillua stërvitja ndërkombëtare e zbulimit “Laufer-21”. Në këtë stërvitje Shqipëria u prezantua me një personel prej 11 ushtarakësh, efektivë të Kompanisë së Zbulimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Qëllimi i kësaj stërvitje ishte ndërveprueshmëria midis trupave të vendeve aleate, grumbullimi i informacionit duke përdorur disiplinat kryesore të zbulimit dhe zbatimi i ciklit të zbulimit. Trupat e Kompanisë së Zbulimit janë vlerësuar nga drejtuesit për performancën e lartë të treguar gjatë stërvitjes “Laufer-21”. “Defender Europe 21” është stërvitja më e madhe ushtarake e zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria ishte vendi kryesor pritës.

Trupat tona në Kroaci: Përfundon stërvitja e zbulimit “Laufer-21”



Në takimin me drejtuesit ushtarakë e Forcave Ajrore, ministri Peleshi nuk ka lënë pa përmendur edhe investimet e NATO-s për ngritjen e Baze Ajrore të Kuçovës. "Sot, tha ministri Peleshi, flasim për një bazë taktike të NATO-s në vendin tonë që do të fillojë nga ndërtimi brenda këtij viti e cila është në proces prokurimi dhe po bëhemi gati të fillojmë implementimin. Për pak kohë do të kemi një bazë taktike operacionale të NATO-s: Bazën e Kuçovës e cila i përket Forcave Ajrore. Pra flasim për arritje, flasim për sfida. Kemi sfiden e kualifikimit të pilotëve të rinj. Para pak javësh kemi filluar kursin, në një ceremoni të thjeshtë, kursin për kualifikimin dhe trajnimin e pilotëve. Mbështetemi tek një aleancë shumë e madhe, tek partneret tanë strategjike: Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë pranë nesh si në modernizimin dhe kualifikimin e forcës sonë ajrore". Ministri Peleshi ka nënvizuar faktin që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj baze jo vetëm për vendin tonë por edhe më gjërë si pjesë e aleancave ushtarake ndërkombëtare në kuadër të NATO-s. Peleshi tha se "Kjo ka lidhje me konsolidimin e Forcës Ajrore Shqiptare edhe

Baza Ajrore e Kuçovës do të fillojë të ndërtohet brenda këtij viti

Flasim për një bazë taktike të NATO-s në vendin tonë që do të fillojë nga ndërtimi brenda këtij viti e cila është në proces prokurimi dhe po bëhemi gati të fillojmë implementimin



në rajon edhe më gjërë, ka lidhje me pozicionimin e lloj lloj erërave që fryjnë në botë, jemi në anën e perëndimit dhe kemi për mision që

të përhapim përkrahjen e perëndimit të aleancave euroatlantike aty ku ne kemi rol për të luajtur në Ballkanin Perëndimor".

Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) niveli i III-të. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Përparim Gega, pjesëtarë nga shtabi i Komandës Mbështetëse si dhe komandantët e strukturave të saj.

Në fjalën përshëndetëse zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gega, falënderoi shtatë kursantët për rezultatet e arritura dhe instruktorët e tyre ndër të cilët ishin eksperte të Gardës së New Jersey. "Me ndihmën e këtyre kurseve kapaciteti EOD do

7 kursantë përfundojnë Kursin EOD, niveli i III-të

të zhvillohet dhe rritet më shumë në të ardhmen për të kontribuar deri në nivel rajonal." - u shpreh kolonel Gega.

Ky kurs shërben njëkohësisht edhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit si në operacione luftarake ashtu edhe në ato joluftarake. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët. Në kurs morën pjesë 7 vetë, kryesisht nga Batalioni i Xhenios.



Akademia e Forcave të Armatosura, tribuna e mendimit të ri doktrinar ushtarak

Urim për pedagogët, instruktorët, drejtuesit dhe punonjësit civilë që kanë shërbyer dhe shërbejnë në Akademinë e Forcave të Armatosura

Mesazhi si më poshtë: "Ky 10 maj shënon 63-Vjetorin e Krijimit dhe Funksionimit të Akademisë së Forcave të Armatosura. Kjo është një kohë e gjatë me punë, përpjekje dhe kontribute të çmuara dhe të vlerësuara në shërbim të përgatitjes dhe arsimit të oficerëve të Forcave të Armatosura, personelit të institucioneve të sigurisë së vendit dhe zhvillimit shkencor për çështjet e sistemit të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ndaj sot, është ditë e veçantë të falënderoj dhe t'iu shpreh mirënjohjen e merituar të gjithë pedagogëve, instruktorëve, drejtuesve dhe punonjësve civilë, që kanë punuar e shërbyer me përkushtim ndër vite në këtë institucion.

Institucioni i Akademisë është reformuar, transformuar e zhvilluar ndër vite, gjithmonë me objektivin e qartë për të qenë tribuna e mendimit të ri doktrinar ushtarak dhe praktikave bashkëkohore të edukimit, arsimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura. Unë jam besimplotë se Akademia e Forcave të Armatosura do të vazhdojë rrugën e suksesit duke konsoliduar vizionin e saj të ri që shpreh synimet, elementët dhe treguesit më cilësorë të filozofisë së re të arsimit ushtarak të integruar me arsimin e lartë kombëtar dhe me atë të vendeve të Aleancës.

Akademia e Forcave të Armatosura meriton dhe do të ketë gjithë vëmendjen dhe mbështetjen e veçantë për rritjen, përmirësimin dhe konsolidimin pedagogjik, akademik dhe programor për realizimin me sukses të misionit të saj edukativ, arsimor dhe shkencor. Gëzuar 63-Vjetorin e krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe suksese



në misionin tuaj të rëndësishëm!"

Akademia e Forcave të Armatosura u krijua më 10 maj 1958, në

Tiranë, në rajonin e Rrapit të Treshit, fillimisht me emërtimin Shkolla e Lartë Ushtarake.

KURSI THEMELOR I OFICERIT TË SHTABIT

Zhvillohet stërvitja planëzuese "Marqineti 21-01"

Në kuadër të programit akademik për vitin 2020-2021, gjatë katër ditëve nga data 26 prill deri më 30 prill 2021, në ambjentet e AFA-së, me kursantët e Kursit të Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH) u zhvillua stërvitja planëzuese "Marqineti 21-01". Objektivat kryesore të kësaj stërvitje ishin: Organizimi, funksionimi dhe koordinimi (BrMN-bk) sipas funksioneve për planëzimin e operacioneve luftarake, me synim rritjen e aftësive të tyre profesionale, bazuar në doktrinat Kombëtare dhe ato të Nato-s. Aplikimi i dijeve dhe njohurive teorike të marra në lidhje me zbatimin e Procesit të Vendimmarjes Ushtarake (MDMP), gjatë planëzimit të operacioneve luftarake në nivel batalioni. Stërvitja "Marqineti 21-01" u zhvillua duke shfrytëzuar doktrinat, manualët dhe formatet standarte si kombëtare po ashtu edhe ato të Nato-s, me qëllim aftësimin dhe përmirësimin e të gjithë elementëve të kryerjes së një operacioni luftarak. Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të kësaj stërvitjeje u respektuan me rigorozitet të gjithë masat anti-COVID për mbrojtjen e personelit ndaj COVID-19. Në kuadër të programit akademik për vitin 2020-2021 me KTHOSH-in vazhdon stërvitja planëzuese "Marqineti 21-01".

Krenari, emocion dhe fantazi

“Defender Europë 21”:

Dita e Hapur “zbret” në sheshe

Qendra Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura pjesë “Ditëve të Hapura”

MIMOZA GOLIKJA

Dita e Hapur-Open Day”, organizimet e ditëve të hapura të Forcave të Armatosura kishin për qëllim të tregojnë se si FA punojnë për paqen dhe sigurinë, ato shënojnë për të pranishmit krenari, emocion dhe fantazi. Në këto ditë të gjithë janë të mirëpritur të kenë një vështrim dhe të marrin një informacion të veçantë pranë stendave dhe prezantimit të forcës ushtarake. Dita e hapur ka të bëjë me lidhjen e shërbimeve publike me komunitetin dhe gjithashtu për të treguar ekspertizën e ushtarëve para publikut dhe vlerësimin e tij për FA. Paraqitja para publikut të gjerë është një platformë e gjetur për të mësuar më shumë rreth FA. Njerëzit e të gjitha moshave dhe të të gjitha profesioneve e shtresave të popullsisë kuptojnë nëpërmjet “Open day”, betejat dhe sakrificat e personelit ushtarak në mbrojtjen e vendit, në mbrojtje të jetës dhe të paqes.

Pjesë e “Ditëve të Hapura” për publikun e gjërë, ka qënë edhe prezantimi i Qendrës Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura ku kanë paraqitur interes pikturat e fëmijëve të ushtarakëve, grupi i këngës apo ekspozoja dokumentave historike dhe objekteve muzeale historike, etj. Prezentë pranë këtij “pavioni” në natyrë kanë qënë në Tiranë, ambasadorja

amerikane Yuri Kim, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, qytetarë të shumtë të pranishëm të cilët janë entuziazmuar nga grupi i këngëtarëve, por sidomos nga pikturat e piktoreve të vegjël Arber Zerani, Juena Tahiri, Krisjana Myzyri, Ester Spaho, Ema Kenuti, Suada Suti, Sabjan Mehmetaj, Eluisa Sadiku, Ajsel Karaj, Diona dhe Adea Hitoaliaj, Prisea Lleshi, Arli dhe Noel Hazizi, Ledia dhe Tea Cako etj.

Skenari i ditëve të hapura të stërvitjes “Defender Europë 21”, hartuar me shumë kujdes, ishte një aktivitetit tepër i madh dhe i hapur për publikun (si vetë emri) që mbledhi mijëra pjesëmarrës në sheshet e qyteteve, Durrës, Vlorë, Tiranë dhe Kuçovë. Aktivitete dhe prezantime ushtarake të ndryshme të forcës të tokës, detit dhe të ajrit, stenda që shfaqën aftësitë e Forcave të Armatosura para vizitorëve të shumtë, emocion, kuriozitet dhe solidaritet. Ditët e hapura të “Defender Europë 21”, zgjedhur si një “mjet” për të shkuar pranë komunitetit, gjithashtu shërbeu si një “program arsimor për civilët”, një program, ku ne gazetarët vërejtëm një ndërgjegjësim të shtuar për FA. Dita e hapur zgjeron kuptimin e publikut për punën që kryhet në FA dhe rolin e ushtrisë në jetën civile, i tregon “pajisjet e fundit”, popullsisë civile që po mbron, nderon dhe vlerëson pjesëmarrësit e FA dhe pse jo fton të rinjtë për t’u bërë edhe pjesë e tyre. Është një ditë gjithashtu e mundësisë, e kujtesës dhe dhënies të homazheve të veçanta burrave dhe grave që shërbejnë në FA, të gjithë individëve që janë në shërbim të vendit të tyre, na kujton nevojën e vazhdueshme për unitet në FA, si dhe midis të gjithë qytetarëve tanë në interes të sigurisë dhe paqes. Publiku mëson më shumë rreth asaj që FA bën në vend dhe në të gjithë botën dhe tregon mbështetjen e tij për Forcat e Armatosura shqiptare që mbrojnë vendin dhe interesat e tij dhe që janë pjesëmarrës në misionet e NATO-s, duke promovuar paqen, duke dhënë ndihmë dhe trajnim, duke siguruar mbrojtjen dhe luftuar ter-





rorizmin. Dita e Hapur e 'DE 21' një festë e hapur për komunitetin, një stacion i periudhës stërvitore 1 maj -14 qershor 2021.

Durrësi hap siparin e Ditës së Hapur "Defender Europë 21"

Qyteti i lashtë bregdetar i Durrësit, ishte ai që hapi siparin e "Ditëve të Hapura" të stërvitjes "Defender Europë 21", ashtu si një muaj më parë, (4 maj 2021), kur nën një ceremoni madhështore priti "Ditën e Vizitorëve të Shquar" në portin e tij, që ishte Porta-hyrëse e stërvitjes "Defender 21". Porti i Durrësit, promovoi rëndësinë gjeo-strategjike të vendi tonë si dhe rëndësinë strategjike të tij, me infrastrukturën e nevojshme për zbarkim të trupave ushtarake. Durrësi priti aktivitetin e parë të open day-it të parë të stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe 21", në sheshin "Iliria". Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, mori pjesë në këtë aktivitet të zhvilluar në Durrës dhe përshëndeti nga afër nën një organizim të shkëlqyer qytetarët durrsakë dhe jo vetëm. Kryetarja e Bashkisë së Durrësit, znj. Ani Sako, prefekti i Qarkut Durrës, z. Roland Nasto, ushtarakë të lartë dhe qytetarë e nxënës shkollash të qytetit, gjithashtu ishin pjesëmarrës të "Ditës të Hapur", të stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe 21". Gjeneralmajor Begaj tha se "publiku ynë është njohur nga media me atë çka po ndodh në fushën ushtarake në Shqipëri" dhe duke folur mbi "demonstrimin dhe vullnetin e aftësisë të aleatit tonë strategjik dhe Aleancës për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive.", ai iu drejtua të rinjve dhe

rejavë të shumtë të pranishëm në këtë event, "të cilët përjetojnë më shumë se kushdo, emocione dhe ndjesi të veçanta kur shikojnë një bashkëpunim dhe ndërveprim kaq të ngushtë të forcave tona me ato amerikane". Gjenerali vuri theksin te vlerat e veçanta që ka shërbimi në FA sidomos sot, kur jemi pjesë e NATO-s dhe kemi në krah aleatë të mëdhenj.

Stërvitja "Defender '21" ekspozon aftësitë në Vlorë

Vlora e bregdetit por edhe Vlora e Flamurit, qyteti shqiptar "i pa-varësisë" kishte një zgjim ndryshe mëngjesin e datës 21 maj 2021. Trupat amerikane dhe shqiptare, pjesë e stërvitjes "Defender Europe 2021", "pushtuan" sheshin qendror të "Lungomares" vlonjate ndërsa rezet e diellit derdheshin pa kursim në det atë mëngjes. Pajisjet dhe forca ushtarake aleate ekspozoheshin para qytetarëve të Vlorës në "Lungomare". Qindra e qindra qytetarë të moshave të ndryshme, gjyshër e nipër dhe prindër, apo ish pjesëmarrës të FA u bënë pjesëmarrës të Ditës të Hapur në qytet. Buqëqeshje dhe emocione pa fund krah forcave të armatora shqiptare dhe aleate u fiksuan në mijëra shkrepje fotografish, nga të rinjtë dhe jo vetëm, nën një recital të vazhdueshëm të marsheve ushtarake të vendeve aleate dhënë nga Orkestara Frymore e FA. Aktiviteti u ndoq edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera aleate të NATO. "Kjo ditë e hapur kishte për mision jo vetëm të sillte pranë publikut Stërvitjen

"Defender '21", por edhe të sillte pranë jetës civile, jetën ushtarake, sepse në fund të fundit misioni i FA është të sigurojë paqe, stabilitet për qytetarët, të sigurojë gjithashtu mbrojtjen civile", tha ministri i Mbrojtjes Peleshi. "Sot i kemi parë pajisjet, kemi parë forcat e ndryshme, kontingjentin tonë, efektivet tanë që po punojnë përkrah forcave amerikane, po shkëmbejnë eksperiencë po marrin eksperiencë dhe për këtë jemi shumë të lumtur dhe shumë krenarë", tha ai. "Nuk është një ditë për ambasadorët apo personatitetet, por është një ditë për qytetarët, të cilët kanë

mundësi të shohin nga afër se kush është ushtria shqiptare, se çfarë synon stërvitja "Defender 21", cilat janë kapacitetet tona dhe në fund fare të marrë një shije të mirë dhe të jetë krenar që është shqiptar", tha ministri Peleshi.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se prioritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbeten demokracia, mbrojtja dhe biznesi. "Tani jemi duke hyrë në një periudhë domethënëse të gjithë këtyre zhvillimeve. "Defender 21" është në fakt stërvitja më e madhe ushtarake, që është zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria është vendndodhja kryesore", tha ajo duke shtuar se bashkëpunimi i bën aleatët e NATO-s "dominues qoftë në ajër, në tokë apo në det".

"Defender Europe 21" zbret në sheshin "Nënë Terëza"

Tirana, metropoli, frymëmarrja dhe kryeqyteti shqiptar, do t'u dhuronte qytetarëve të vet një të dielë ndryshe, një prezantim madhështor dhe një festim të pazakontë ushtarak, si ai i datës 23 maj 2021. Pas udhëtimit në disa qytete, stërvitja "Defender Europe 21" zbreti në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë. Helikopterët "Black Hawk", mjetet e blinduara dhe demonstrime të ndryshme të efektivëve amerikanë e shqiptarë do të ngjallnin kuriozitet dhe interes të madh për të pranishmit. Pas ekzekutimit të dy himneve, atij shqiptar dhe amerikan, autoritet pjesëmarrës nënvizuan mirënjohje për aleatin strategjik, SHBA. "Ushtarakët shqiptarë do të jenë të gatshëm për çdo angazhim dhe çdo mision sa herë të kërkohet nga aleatët dhe Aleanca dhe të au-



dhe për jetën e tyre pas shkollimit", tha kryeministri Rama.

Performancë e "Defender 21" në Kuçovë

Kuçova, qyteti tjetër i rradhës i përzgjedhur nga stërvitja "Defender 21" për zhvillimin e Ditës të Hapur, të datës 25 maj 2021. Qyteti "i avionit" dhe "i naftëtarëve", qyteti i njerëzve punëtorë dhe më zemër të bardhë do të ofronte zonën pedonale të tij për të zhvilluar "Open Day-n". Trupat amerikane dhe shqiptare pjesë e stërvitjes shumëkombëshe "Defender Europe 2021", do të "zbarkonin", për t'i dhënë një panoramë tjetër shëtitores së bukur të qytetit, duke u vendosur në të dy anët e saj nën sfondin e gjelbër të palmave dhe nën interesimin e jashtëzakonshëm qytetar. U ekspozuan pajisjet dhe forca para qytetarëve të Kuçovës, të cilët patën mundësi të shohin nga afër se "kush është ushtria shqiptare dhe se çfarë synon kjo stërvitje". Përballë këtij ekspozimi të Forcave të Armatosura shqiptare dhe të forcave aleate të NATO-s, pjesëmarrëse në stërvitjen "Defender 21", qytetarët e shumë shfaqën interes dhe u njohë nga afër me se çfarë ofrojnë FA. Truproja e Nderit e FA performoi për të pranishmit dhe

torizohet nga autoritetet e vendit. Ne do të jemi garantë me besën dhe besnikërinë e shqiptarit, me vullnetin dhe profesionalizmin ushtarak për të qëndruar krah për krah me kolegët tanë amerikanë dhe të Aleancës dhe në situata më të vështira", premtoi në fjalën e tij të hapjes gjeneralmajor Bajram Begaj. FA një "mundësi e artë" për karrierë, nënvizoi ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi kur u bëri thirrje të rinjve që të shohin FA si një mundësi punësimi. "U kemi dhënë sot mundësi qytetarëve që ta prekin me dorë se çfarë do të thotë të jesh krenar që je shqiptar. Pas 12 vitesh anëtarësi në NATO, sot ka qenë mundësia më e madhe e historisë tonë për të testuar veten dhe kapacitetin tonë", tha z. Peleshi.

"Në krah të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë", ambasadorja amerikane Yuri Kim tha se "marrëdhënia e Shqipërisë me SHBA është mbi çdo gjë", ajo tha se ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë, "si miq dhe aleatë" dhe "Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria". "Defender 21" hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik. "Ushhtarët amerikanë do kthehen në Shqipëri për të stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se suksesi i "Defender 21" pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.", tha Yuri Kim. Rritja e kapaciteteve njerëzore të FA, do të jenë misioni i rradhës për shqipërinë dhe SHBA, tha kryeministri Edi Rama kur deklaroi se "ne do të mund të hedhim hapa të tjerë kuptimplotë në rritjen e cilësisë së burimeve njerëzore të Forcave tona të Armatosura, duke krijuar kështu një hapësirë shumë më tërheqëse edhe për ta materializuar atë

thirrje që bëri ministri i Mbrojtjes për të rinjtë, të cilët gjithnjë e më shumë do ta shohin adresën e FA si një mundësi të artë për formimin



Orkestra Frymore e FA ekzekutoi himnet kombëtare të të dy vendeve dhe ekzekutime të tjera ushtarake. As këtu nuk munguan shkrepjet e fotove para autobлиндave ushtarake apo stendave të paraqitura nga forca tokësore, ajrore dhe detare e FA. Qyteti ofroi pjesëmarrjen dhe FA prezantimin dhe emocionin e ndërsjelltë. Aktiviteti u ndoq edhe nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralbrigade Manushaqe Shehu, ish shefi i Shtabit të Forcave të Amatosura/deputet i zonës, Bardhyl Kollçaku, kryetari i Bashkisë së Kuçovës z. Kreshnik Hajdari, prefekti i qarkut, znj. Valbona Zylyftari, drejtorë drejtorish në SHP, përfaqësues nga Policia e Shtetit, si dhe qytetarë e nxënës shkollash të qytetit, etj.

Aktiviteti u përmbyll me një koncert të grupit artistik të fëmijëve, të cilët kishin udhëtuar nga Tirana drejt Kuçovës, ku kënga "Globi rrotullohet" u vazhdua me këngë të tjera, të shoqëruar me alternime të oganizuara me kujdes, nga këngëtarë të njohur të QKMBM-MFA Kozma Dushi, Redon Makashi, Saimir Braho dhe Elton Deda.

Emocioni që mbart Grupi Artistik i QKMBMM të FA

Ditët e Hapura të "Defender 21" shënuan një demonstrim të kombinuar nga FA të progresit të saj. Ditët e Hapura kishin një numër të stendave dhe ngjarjeve, por ato kishin gjithashtu zonën e pamunguar në evente të tilla, atë të fëmijëve të Qendrës Kulturore të QKMBMMFA. Përfshirja e tyre në këto evente ofron kënaqësinë e vazhdimësisë të jetës që askush më mirë se sa fëmijët mëshirojnë. Ata janë të gjithë fëmijë të ushtarakëve dhe civilëve të MM dhe FA, pjesë e grupit artistik që trajnohen me një kujdes të posaçëm në QKMBMMFA nga trajnierë dhe instruktorë të veçantë siç janë këngëtarët dhe muzikantët e njohur të muzikës shqiptare, specialistë në sektorin e Aktiviteteve të Kulturës dhe Sporteve. Ky grup fëmijësh performon dhe dhuron me zërat e tyre nota të gëzueshme që sjellin emocion të veçantë njerëzor në aktivitete të tillë si Dita e Hapur, midis uniformave të ushtarakëve, pajisjeve, teknikës, armatimit, helikopterëve, paqes dhe jetës, qëllimit të mbrojtjes dhe sigurisë. Notat muzikore dhe ngjyrat që hedhin me penelat e



tyre këta fëmijë në pikturat plot talent që u ekspozuan si në Tiranë dhe qytetet e tjera ku u zhvillua ky aktivitet i dhanë gjallëri të pamatë 'open day-it' dhe shtuan motivin që të jep liria dhe pagja. Punimet e fëmijëve dhe ekspozitat e tyre tregojnë dhe flasin shumë përveç kënaqësisë që të jep soditja e tyre. Ka shumë mënyra për ta treguar këtë mbështetje dhe QKMBMMFA përveç të tjerash ka këtë grup fëmijësh të talentuar dhe të trajnuar nga instruktorët e tyre që me prezantimet e punimeve në pikturë apo me koncertin e grupit artistik të fëmijëve, të shoqëruar dhe nga këngëtarë të njohur të QKMBMM të FA, i shtojnë vlera organizimeve kaq dinjitoze.

BCU në stërvitjen “Defender Europe 21”

Ne ishim pjesë integrale e Civil Affairs të ushtrisë amerikane dhe Qendrës Shumëkombëshe të CIMIC (MNCC)

Kolonel RAZIJE MEHMETI

Drejtor i Bashkëpunimit Civil-Ushtarak të SHPFA

ARBEN MOLLAJ

Specialist në Drejtorinë e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak të SHPFA

S tërvitja “Defender Europe 21”, është pa dyshim stërvitja shumëkombëshe më e madhe, e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rajonin tonë, në tre dekadat e fundit, si për forcat pjesëmarrëse dhe mjetet e dislokuara, ashtu dhe për forcat dhe mjetet që do të kryenin kalimin transit në vendin tonë. Në vendin tonë pati disa zona stërvitjeje si Zall Herr, Rajoni i Bizës, Porti Detar Durrësit e ambientet e Forcës Detare, Rinas, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë dhe Pashaliman Vlorë. Përmirësimi i ndërveprueshmërisë dhe rritja e besueshmërisë së aleatëve tek kapacitetet, përgatitja dhe procedurat e Republikës së Shqipërisë, për të operuar së bashku me forcat e vendeve të tjera të NATO-s apo edhe midis forcave të ndryshme ishin objektivat tonë operacionalë. Përfshirja e elementëve BCU/CIMIC gjatë stërvitjes për koordinimin me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, njësitë administrative, institucioneve qendrore e lokale dhe OJQ) që veprojnë në zonat e stërvitjes, përfshirja e të gjithë elementëve dhe projekteve të CIMIC/CA, ishin fokusi kryesor, në kuadër të mirë-koordinimit e planëz-

imit të detyrimeve të ndërsjella. Më konkretisht përmendim: Parapërgatitja e mjedisit civil si Gjeografia; Topografia; Klima; Popullsia; Resurset natyrore; Përbërja etnike; Përbërja fetare; Punësimi; Kultura; Arsimi; Infrastruktura; Transporti; Shërbimet publike; Shëndeti publik; Kushtet dhe mënyra e jetesës; etj.; Realizimi i fushatave të marketingut dhe botimet në shtypin ushtarak në funksion të impaktit dhe prezencës ushtarake për zhvillimin e stërvitjes. Realizimi i demonstrimit të strukturave ushtarake amerikano-shqiptare, nëpërmjet prezantimit të stendave, pajisjeve e armatimit të forcës ushtarake, të vendosura në disa bashki si Durrës, Vlorë, Tiranë e Kuçovë; Realizimi i projekteve të CIMIC në interes të realizimit të projekteve të planifikuara të palës amerikane, si elementë i çështjeve

humanitare, në zona të ndryshme të vendit; Koordinime dhe takime me autoritetet civile që ndodhen në zonat stërvitore: Mundësia e realizimit të takimeve koordinuese me disa nga organizmat ndërkombëtare në Tiranë (UNICEF, WFP, KKSH). Gjithashtu u planifikuan e realizuan takime koordinuese në Tiranë, Durrës, Kuçovë, Vlorë (kryetarët e bashkive, administratorët e njësitë administrative të zonave ku do të jenë të dislokuara forcat ushtarake, si dhe përgjegjësit e agjencive turistike përkatëse (kjo për realizimin e ditëve kulturore). Agjenda e takimeve ishte në funksion të realizimit të projekteve të përbashkëta të CIMIC/IP, të realizimit të programeve kulturore me palën amerikane, përgjatë zhvillimit të stërvitjes. Gjithashtu, edhe për mundësitë e mbështetjes dhe vënien në dispozicion të dislokimit





të kapaciteteve mbështetëse civile; Procedurat dhe politikat e Informimit Publik (Informimi Publik): Në kontekstin e koordinimit për çështjet e IP, u fokusua mbi qasjen e IP, mënyrat e realizimit të tij, duke pasur në konsideratë sigurimin e një mbështetjeje efektive të IP brenda zonës stërvitore, në mënyrë që të informohet audienca dhe publiku i jashtëm dhe i brendshëm për stërvitjen; Procedurat e JVB: Për sa i përket realizimit të Ditës së Vizitorëve të Shquar (DVIDay), Ditëve të hapura (Open Day) dhe Ditës së Vëzhguesve (Observation Day), BCU/CIMIC bashkëpunoi ngushtë dhe koordinoi për organizimin dhe mbështetjen me strukturat e FARSH, ODC (Zyra e Bashkëpunimit Amerikan), degët e KKSJ (Kryqi i Kuq Shqiptar) dhe bashkitë respektive.

Bazuar në doktrinën e BCU-së, manualin e Bashkëpunimit Civil-Usharak, manualin e doktrinat e CIMIC të NATO-s, ngritja dhe funksionimi i strukturave të Bashkëpunimit Civil -Usharak (BCU/CIMIC) në FA ka qenë prioritet i fushave të veprimt. Harmonizimi i proceseve strategjike, të planifikimit dhe objektivave në interes të stërvitjes ishin fokus i veprimtarisë së BCU, si një element i rëndësishëm për ndërveprimin civil-ushtarak. Kjo tregoi ndër të tjera, faktorët relevantë për një ndërveprim civil-ushtarak efektiv dhe efikas të angazhimeve tona, në kuadër të kësaj stërvitjeje, në qasjen gjithëpërfshirëse. Zhvillimi i aktiviteteve të BCU/CIMIC, duke prezantuar të gjitha parimet e nevojshme, që në fazat e planëzimit dhe kërkesat e trajnimit të personelit të CIMIC në bashkëpunim me Ekipet Civil Affairs të ushtrisë amerikane. Procesi i planifikimit që në takimet paraprake dhe konferencat planëzuese u fokusua në përfshirjen

e BCU-së e në veçanti Detashmentit CIMIC të FA-së si një ndër strukturat kryesore të nivelit taktik. Në mënyrë të veçantë, faktorë të planëzimit dhe kërkesa të trajnimit të personelit të CIMIC, zhvillimin e aktiviteteve të CIMIC, mundësim i ndërveprimit të përbashkët civil-ushtarak. Në interes të kësaj stërvitjeje në nëntor 2020, startoi takimi i përbashkët koordinues midis ekipit të CIMIC shqiptar dhe ekipit amerikan, me qëllim koordinimin e të gjithë veprimtarive civil- ushtarake gjatë periudhës së stërvitjes në interes të mbështetjes së stërvitjes me elementë të CIMIC/ CA dhe Public Affairs (PA). Ekipi amerikan përbëhej nga kapiten Collen Cooper, PA Team Leader nga US Army, SFS Ethan Verzola, SSG Michael Lee, znj. Sabina Mitrovassili, ODC. Ekipi shqiptar i CIMIC përbëhej nga kolonel Razije Mehmeti, drejtor i J9, n/kolonel Alda Sula, oficer shtabi J9, major Orges Baholli, specialist CIMIC J9, n/kolonel Ylli Bajo, shefi Detashmentit CIMIC, z. Arben Mollaj, koordinator nga J9. Fokus i kryesor në këtë takim ishte njohja me strukturën aktuale të BCU-së në FA, si dhe mundësinë e përfshirjes së elementëve dhe projekteve të BCU-së gjatë stërvitjes, si dhe koordinimi me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, komunave, OJQ, ON) që veprojnë në zonat e stërvitjes, politikat e Informimit Publik, në kuadër të mirë-koordinimit e planëzimit të detyrimeve të ndërsjella, sipas fushave, Parapërgatitja e mjedisit civil; Koordinim dhe takime me autoritetet civile; Realizimi i aktiviteteve; Ngritja e Qendrës Shumëkombëshe të BCU-(MNCC); Ngritja e Zyrës së Informimit Publik; Ngritja e CIMIC/ CA në mbështetje të ekipeve të përbashkëta shqiptaro-amerikane, në Tiranë, Durrës, Vlorë e Kuçovë;

Aktivizimi i BCU-së shqiptare në të gjitha rajonet ku ka prezencë të strukturave ushtarake, në varësi të detyrave të CIMIC/Public Affairs.

Ky grup pune i përbashkët, kishte për qëllim koordinimin për realizimin e fushatave marketing në funksion të impaktit dhe prezencës ushtarake për zhvillimin e stërvitjes Durrës-Vlorë-Kuçovë-Tiranë. Zhvillimi i Ditës së Vizitorëve të Shquar të kësaj stërvitjeje ishte dita e hapjes së kësaj stërvitjeje me pjesëmarrjen e personave VIP e të ftuar nga vendi ynë, përfaqësitë ushtarake dhe autoritete civile të ndryshme. Për zhvillimin e fushatave marketing ku ka prezencën e strukturave ushtarake të përbashkëta, me angazhimin e përfshirjen e strukturave operacionale të FA-së, SHBA-së, bashkive dhe KKSJ, duke qenë pjesë ekspozimi i një pjese të pajisjeve dhe armatimit të forcës ushtarake. Në zbatim të kësaj ekipi i përbashkët realizoi takime me përfaqësues të pushtetit vendor, OJQ, në interes të stërvitjes "Defender Europe 21", me qëllim koordinimin e të gjithë veprimtarive civil-ushtarake gjatë periudhës së stërvitjes, në interes të mbështetjes së saj me elementë të CIMIC, Public Affairs dhe aktiviteteve kulturore.

CIMIC/CA pjesë e trajnimeve, për mbështetjen e vendit pritës (HNS)

CIMIC/CA ishte pjesë e trajnimeve, kryesisht për mbështetjen e vendit pritës (HNS), për të cilën u arrit bashkëpunimi e koordinimi i pjesëmarrjes nga strukturat shtetërore nën kuadër të Vëndit Pritës, si pushteti lokal, policia e rendit, policia kufitare, doganat, portet e aeroportet, shëndetësia, autoritete mjedisore, etj. CIMIC paraqiti informacion mbi infrastrukturën civile dhe shërbimet

publike. Kjo përfshinte kapacitetet dhe kufizimet dhe mund të ndryshonte me kalimin e kohës si rezultat i lëvizjes së trupave apo mjeteve nga Porti Detar Durrës apo pikat hyrëse kufitare në rajonin e dislokimit. Ky aktivitet kishte për qëllim njohjen me mënyrën dhe organizimin e operacioneve logjistike (JLOTS), si dhe koordinimin nga strukturat e shtetit shqiptar, për përcaktimin dhe identifikimin e kërkesave për planëzimin, koordinimin dhe zhvillimin e procesit të hyrjes, shoqërimit, dislokimit, stërvitjes, si dhe kthimin nga pikat e hyrjes kufitare (tokësore, ajrore e detare). Në interes të stërvitjes e në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak dhe partneritetit me SHBA-në, në datat 15–25 shkurt 2021 u zhvillua një trajnim me personelin e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak në FA të përzgjedhur në interes të stërvitjes “Defender Europe 21”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i mëtijshëm i personelit që aktualisht punon në strukturat e BCU-së (veçanërisht Detashmentit të CIMIC), si dhe personelit të përzgjedhur nga strukturat e FA-së, si një element kyç në mbështetje të operacioneve civil-ushtarake në bashkëpunim me palën amerikane, për të gjithë diapazonin e operacioneve brenda dhe jashtë vendit. Ekipi amerikan i përbërë nga 3 kapitenë, kapiten Pavel Ruben, kapiten Jose Melendez, kapiten Douglas Brown. Ndërsa ekipi shqiptar mori pjesë në këtë trajnim me 25 vetë. Ushtarakët e Ushtrisë Amerikane të Brigada 361 e Çështjeve Civile, USAREUR, bashkëpunuan me profesionistë të Bashkëpunimit Civil Ushtarak të Shqipërisë (CIMIC) nga të gjitha strukturat e FARSH për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ushtarak të SHBA-së, me ushtarët shqiptarë në tokën shqiptare, me fokus rritjen e aftësive ndërvepruese mes strukturave ushtarake dhe autoriteteve civile në rajonet e dislokimit e veprimit të trupave ushtarake amerikane.

Në javën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet në marrjen e njohurive kryesore të punës në BCU, Familjarizimi me CIMIC në NATO; Planëzimi i CIMIC-ut; Puna e CIMIC-ut në nivel taktik; Ndërlidhja e CIMIC në NATO; Angazhimi i CIMIC-ut; Angazhimi kryesor i udhëheqësit (KLE)/Ndërlidhja dhe arkitektura e CIMIC-ut; Strategjia e angazhimeve; Zhvillimi i një kuptimi më të thelluar të mjedisit civil, si dhe studimi i



zonës. Krahas pjesës teorike për dhënien e njohurive bazë në këtë fushë çdo ditë prezantimet qartësoheshin duke kaluar në veprime konkrete praktike (punë në grup). Pjesëmarrësit u njohën dhe vepruan konkretisht me mënyrën e veprimit në raste të dhënies së informacionit ndaj gazetarëve e reporterëve (tek mënyrat dhe rrugët e dhënies së tij). Me rëndësi të veçantë u trajtua roli dhe vendi që BCU-ja luan në mjedisin e operacioneve shumëkombëshe të udhëhequra nga NATO.

Java e dytë e trajnimit filloi në Komandën e Forcës Detare, ku pjesëmarrësit u familjarizuan mbi rajonin e vendosjes së trupave amerikane, ambientet që do të përdorin, si dhe operacionin logjistik në bregdet. Më pas takimi vijoi me autoritetet portuale, ku pjesëmarrësit u ndanë me grupe pune, Grupi Strategjik, Grupi Operacional dhe Grupi taktik e vijuan në njohjen e familjarizimin me ambientet e Portit Detar Durrës (PPD). Autoriteti Portual Durrës (APD) na siguroi mbështetje në mbarëvajtjen e aktivitetit në kuadrin të stërvitjes “Defender Europe 21”, duke vendosur në dispozicion ambientet e nevojshme, për t’u përdorur për realizimin e takimeve koordinative. U realizuan praktikisht aktivitete mbi takimet me përfaqësues nga APD (siguria e logjistikës), Bashkia (institucioni dhe Emergjencat Civile), Policia (Policia Rendit dhe Policia Kufitare), Autoriteti Mjedisor (QNOD dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Durrës), Dogana (Dogana e Portit Durrës dhe Agjencitë private të çdoganimeve), Shëndetësia (Spitali Durrës dhe Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës), etj. Pjesëmarrësit u njohën gjerësisht me radhën e punës, aktivitetin dhe dokumentet e nevojshme që i nevojiten një oficeri të BCU-së për tu familjarizuar dhe vepruar aktivisht në role të ndryshme të funksioneve të BCU-së.

Duke përdorur konceptet “Defender Europe 21”, Angazhimet Kryesore të Udhëheqësit (KLE), kryerja e trajnimit të përbashkët të KLE (Key Leader Engagement) me ekipet shqiptare CIMIC, ishte ndihmesë në realizimin e kësaj stërvitjeje dhe zhvillimin e ndërveprimit më të madh gjatë përgatitjes për operacionet Defender Europe 21. Trajnimi, gjithashtu u ofroi ekipeve shqiptare CIMIC një mundësi për të mësuar në lidhje me Qendrën Shumëkombëshe CIMIC (MNCC) që do të veprojë në Shqipëri për Defender Europe 21. Individët nga ekipet shqiptare CIMIC do të marrin pjesë në MNCC së bashku me përfaqësuesit e Çështjeve Civile nga Brigada 361 dhe ekipe të tjera të CIMIC-ut NATO-s. Një mundësi e shkëlqyer e ushtarakëve amerikanë dhe shqiptarë iu ofrua për të zhvilluar marrëdhënie më të ngushta kulturore dhe mirëkuptim të përbashkët, pasi kjo është hera e parë pas shumë vitesh që forcat amerikane kanë punuar ngushtë me ushtrinë shqiptare dhe hera e parë për një bashkim kaq të madh një lloj operacioni të përbashkët si “Defender Europe 21”.

Plani i koordinimit me strukturat e qeverisjes vendore e lokale

Në muajin prill 2021, në interes të stërvitjes, një ekip Amerikan (Civil Affairs Team) së bashku me ekipin e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (BCU) i FA-së (AL CIMIC), realizuan një plan koordinimi me strukturat e qeverisjes vendore e lokale, me qëllim realizimin e takimeve dhe koordinimin me udhëheqësit kryesor në nivel bashkie, angazhimi i tyre, si dhe ndikimet e mundshme në jetën e përditshme gjatë periudhës stërvitore, në interes të mbështetjes së saj me elementë të bashkëpunimit, çështjeve civile dhe aktiviteteve promovuese. Këto takime

kishin si objekt: Rritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në interes të përmbushjes së misionit të forcave ushtarake shqiptaro-amerikane; Krijimin e lidhjeve dhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave të FA-së dhe autoriteteve civile në zonën e dislokimit dhe në rajonet e kryerjes së detyrave dhe stërvitjeve; Bashkëpunimin dhe mbështetjen e CIMIC-ut shqiptar e amerikan me strukturat e qeverisjes qendrore dhe lokale, për kryerjen e aktiviteteve CIMIC, sipas rajoneve të dislokimit; Përcaktimin e zonave të mbrojtura (bimët, zogjtë, ndërtesat historike, vendet kulturore, etj.), për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm, të shmangim etj.

Realizimi i këtij plani koordinimi u vlerësua si nga pala amerikane. Ekipi i përbashkët shqiptaro-amerikan, me përfaqësues nga BCU-të e komandave kryesore, përfaqësues së Komandës Amerikane në Europë (CA Team), si dhe përfaqësues të Detachmentit CIMIC, realizuan takime të cilat kishin në fokus impaktin e strukturave ushtarake në rajone të ndryshme, realizimin e koordinimit sa më efektiv me autoritetet civile dhe strukturat përgjegjëse gjatë stërvitjes, si dhe realizimin e ditëve të hapura (Open Day) në nivel bashkie.

Ekipi amerikan në këtë takim përbëhej nga: Major Grady Robinsson, ODC; Kapiten Warner, Paul, USARMY 21 TSC; K/kapter Brooks R Yundt, USA; shoqëruar nga znj. Sabina Mitrovasili ODC. Në Ekipin shqiptar morën pjesë, kolonel Razije Mehmeti, n/kolonel Hatixhe Kola, n/kolonel Ylli Bajo, n/kolonel Dritan Sopaj dhe z. Arben Mollaj. Pas organizimit për detyrë të BCU-së në FARSH, me përfshirjen e elementëve BCU gjatë stërvitjes, u vijua për bashkëpunimin e koordinimin me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, komunave, OJQ, ON) që veprojnë në zonat e stërvitjes, përfshirja e të gjithë elementëve dhe projekteve të BCU-së dhe politikat e Informimit Publik, në kuadër të mirë-koordinimit e planëzimit të detyrimeve të ndërsjella, sipas fushave të Parapërgatitjes së mjedisit civil; Koordinim dhe takime me autoritetet civile; Realizimi aktiviteteve të përbashkëta; Ngritja e Qendrës BCU-Multinational CIMIC Center; Ngritja e Zyrës së Informimit Publik; Aktivizimi i BCU-së shqiptare në varësi të detyrave të CIMIC/CA.

Në të gjitha bashkitë, pas pr-

ezantimit të aktiviteteve të ekipit shqiptaro-amerikan, drejtuesit e bashkive u informuan për detajet e operacioneve stërvitore që do të ndikonin ose mund të ndikonin në jetën e përditshme të civilëve. Kjo përgatiti më mirë popullsinë civile për fluksin e personelit ushtarak dhe lëvizjet në jetën e përditshme, përmirësoi marrëdhëniet civil-ushtarake. U vlerësua angazhimi dhe pjesëmarrja e bashkive, duke u dakordësuar në parim mbi aktivitetet e përbashkëta të forcës ushtarake (shqiptaro-amerikane) dhe Autoritetet Civile. Bazuar në procedurat dhe kërkesat për realizimin e aktiviteteve, duke vlerësuar propozimet e tyre, pas trajnimit 2-javor u dakordësua për Përcaktimi i ekipit CIMIC (prej 4 vetash), si pjesë e MNCC pjesëmarrës në stërvitje, në Pashaliman; Caktimin e ekipeve të CIMIC-ut në Tiranë, Durrës, Ekipi i Kuçovë dhe Vlorë, të cilët do të vepronin bashkë me ekipet amerikane, CA Team; Caktimi i elementëve të BCU-së, në Zall Herr, Bizë, Rinas, Farkë, Kuçovë, Porti Detar Durrës, Pashaliman; Pjesëmarrje dhe mbështetje të aktiviteteve tek mjedisi civil, nëpërmjet realizimit të fushatave marketingut në funksion të impaktit dhe prezencës tyre në zonat përreth rajoneve ushtarake për zhvillimin e stërvitjes; Vijimi i koordinimit sa më efikas në interes të stërvitjes me të gjithë institucionet e përfshira në stërvitje si dhe pushtetin vendor; Koordinim dhe dhënie të asistencës humanitare (HA) tek institucionet, bashkitë, shkollat për realizimin e projekteve të BCU-së.

MNCC-Qendra Shumëkombëshe e Koordinimit CIMIC

Për herë të parë u ngrit në Shqipëri MNCC me pjesëmarrës nga shtete të ndryshme, në stërvitjen Defender 21, ku ambasadorja amerikane znj. Yuri Kim, vlerësoi këtë aktivitet të Bashkëpunimit Civil-Ushtarak, për të ndarë gjetjet e duhura ndërsa kryen angazhime civile për stërvitje të përbashkëta, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit të suksesshëm të strukturave ushtarake me organet e pushtetit qendror në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë e Kuçovë. Një vlerësim të veçantë pati dhe nga gjeneral brigade Wanda N. Williams, Komandante e Misionit të 7-të Mbështetës për angazhimin dhe punën e bërë nga ekipet e CIMIC koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet civile në rajonet ku ishin të dislokuara trupat.

Ekipet e çështjeve civile dhe angazhimit civil zhvilluan një seri takimesh koordinative me drejtuesit e pushtetit lokal, policia e rendit, policia kufitare, doganat, emergjencat civile, zjarrfikësit, portet e aeroportet, shëndetësia, autoritete mjedisore, etj., për të komunikuar në lidhje me çështje të tilla si rrugët e lëvizjes, shmangien e problemeve për popullsinë civile dhe rritjen e pranisë ushtarake në zonë gjatë gjithë ushtrimit (impaktin në pjesën civile). Kol. Gorbea, vlerësoi punën krah për krah me aleatët tanë BCU (CIMIC) të vendit pritës, gjë që e bëri më të efektshëm të gjithë koordinimin me MNCC. Praktikën e punës që startuan me rikonicion në Pashaliman, për të parë vend-dislokimin, si dhe mundësitë e uljes së helikopterit për raste emergjente; video-telekonferenca me komandantin e Brigadës 361 për CA të USAREUR, ku u diskutua për nevojën e bashkëpunimit dhe pritjen e njësisë Multinacionale CIMIC (MNCC); përcaktimi i ambienteve që MNCC përdori në funksion të stërvitjes; sistemimi, pritja, akomodimi ishin pjesë e planeve, duke u vëzhguar nga n/kol Larson, shefi MNCC. Gjatë vizitës nga komandanti i Brigadës 361 Civil Affair, kolonel Carlos Gorbea dhe kolonel Razije Mehmeti në MNCC, u njohën me ambientet e Qendrës Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civil-Ushtarak/MNCC, procedurat në koordinimin me institucionet qendrore dhe vendore dhe realizimin e takimeve nëpërmjet grupeve CIMIC të ndërthurura ndërkombëtare, në kuadër të DE21. Kolonel R. Mehmeti vlerësoi e falënderoi pjesëmarrësit për koordinimin me autoritetet civile e ndërveprimin e shkëlqyer të ushtarakëve amerikanë dhe 12 vendeve partnere nga Bosnje & Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Rumania, Ukraina dhe Shqipëria si vendi pritës (në Pashaliman kanë qenë 42 efektivë të MNCC). Kolonele Mehmeti vlerësoi dhe falënderoi për koordinimin me autoritet civile e ndërveprimin e shkëlqyer midis kolegeve ushtarake amerikane dhe ato të 12 vendeve partnere nga të cilët ishin: Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina. Në fund të takimit kolonel Mehmeti dorëzoi në emër të Shëfit të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Bajram Begaj, certifikata mirënjohje

për Komandantin e MNCC n/ kolonel Larson dhe disa anëtarëve të stafit të tij, për kontributin e shquar në kuadër të "DE21".

MNCC zhvilloi aktivitetin 'Ditë e Hapur'

Në ditët e aktivitetit MNCC zhvilloi 'Ditën e Hapur', që filloi me qytetin e Durrësit dhe më pas me atë të Vlorës, Tiranës dhe Kuçovës ku ishin të ftuar përfaqësues nga Autoritetet vendore e qendrore, ambasadorë, Prefektura, Kryqi i Kuq, Policia etj. Këto aktivitete kishin pjesëmarrje madhështore dhe interesim maksimal qytetar. Bazuar në misionin e MNCC, u theksua rëndësia e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale e vendore. Referuar "Ditës së Hapur" në Vlorë, me iniciativën e Kryqit të Kuq Shqiptar, dhe me miratimin e Komandantit të MNCC LTC G. Larson, Qendra Ndërkombëtare e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak/MNCC (Multinational CIMIC Center) në Pashaliman, Vlorë zhvilloi një seance dhurimi gjaku për fëmijët talasemikë dhe komunitetin në nevojë. Nga vendet donatore u dal-luan Rumania, USA dhe ushtarakët e Flotiljes Detare Pashaliman. Pas përfundimit të operacioneve një gjë u vu re nga MNCC, të cilët kërkonin feedback me autoritetet e ndryshme. Kryetarët e bashkive Durrës, Vlorë, Kuçovë, N/kryetari i bashkisë Tiranë, Ministria e Shëndetësisë, Emergjencat Civile, Shërbimi Zjarrfikës, në takime me përfaqësues të ushtrisë së SHBA-së që ndodhen në Shqipëri në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21", shprehën mirënjohje në marrëdhëniet e shkëlqyera midis Shqipërisë dhe SHBA-së. Zhvillimi i kësaj stërvitjeje të trupave amerikane në Shqipëri ishte e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet e sigurisë që përcjell. Po kështu takimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Ardi Veliu, i cili falënderoi ushtarakët amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara që zgjodhën Shqipërinë si një ndër vendet që mirëpret këtë stërvitje dhe se kjo është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Shqipërinë.

Ajo që u arrit dhe eksperiencia e veçantë

Si përfundim mund të themi se bashkëpunimi i suksesshëm i strukturave ushtarake me organet

e pushtetit qendror në të gjitha rajonet stërvitore ku ka pasur dislokim apo lëvizje trupash tashmë është kthyer në një traditë me vlera, e cila duhet të merret shembull edhe për drejtime të tjera të punës sonë. Të gjithë jemi dëshmitarë të stërvitjeve të mëdha në det dhe në tokë, brenda e jashtë vendit, të cilat një pjesë të suksesit të tyre ia dedikojnë edhe bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet strukturave ushtarake dhe drejtuesve të pushtetit qendror e lokal. CIMIC i FARSH në përbushje të detyrave që rrjedhin nga misioni, në fokus të punës së saj ka trajtuar edhe bashkëpunimin e pandërprerë



me organet e pushtetit qendror dhe lokal. Nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta në terren është bërë e mundur identifikimi i pikave të kontaktit me përfaqësuesit e pushtetit qendror e lokal, organizatat jo qeveritare, mediat (elektronike dhe të shkruara) për rritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në interes të përbushjes së misionit të Forcave të Armatosura. Nëpërmjet këtyre takimeve bëhet i mundur vlerësimi i kërkesave dhe nevojave reale të autoriteteve civile, si dhe do të

mundësohet bashkëpunimi real dhe i frytshëm për t'i paraprirë në kohë dhe në cilësinë e duhur aktiviteteve të përbashkëta. U arrit integrimi dhe koordinimi për aktivitetin e përbashkët nga të gjithë pjesëmarrësit ndërkombëtarë, duke u familjarizuar e vepruar në mënyrë unike për realizimin e vetë misionit të MNCC. Kontribut tepër i veçantë e mbresëlënës i MNCC ishte humanizmi (dhurimi i gjakut në mënyrë vullnetare për fëmijët talasemikë e komunitetin në nevojë në Shqipëri). Qendra Ndërkombëtare e CIMIC në Shqipëri ku vendi ynë ishte HN, ishte një eksperiencë e veçantë e tepër e rëndësishme në mbështetje të stërvitjes "Defender Europe 21" nën moton "World Class Warriors" ku ekipet CIMIC të përbërë nga ushtarakë të kombësive të ndryshme të vendeve partnere, punuan e bashkëvepruan në mënyrë të suksesshme në një periudhë kohore relativisht të shkurtër.

Në përfundim të të gjithë këtyre takimeve intensive drejtuesit e organeve të pushtetit vendor vlerësohet kontributi i strukturave ushtarake në ndihmë të

komunitetit, si një ndër mundësitë më të mëdha dhe më të organizuar për këtë qëllim. Ata kërkuar dhe shprehën domosdoshmërinë e përfshirjes së strukturave ushtarake në projektet e ardhshme, duke veçuar sidomos ndihmesën që ato mund të japin në zgjidhjen e problematikave të tilla si, për rihapjen e rrugëve të bllokuara, rikonstruksionin e urave, shkollave apo çerdheve të dëmtuara nga moti i keq apo fatkeqësitë e tjera natyrore në këto zona etj. gjatë situatave të paparashikuara nga ana e tyre.

“Defender Europe 21”: Ambasada Amerikane publikon pamje:

Anija logjistike “James A. Loux” zhvillon stërvitje në Detin Adriatik

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri publikoi në rrjetet sociale video dhe foto nga stërvitja e përbashkët ushtarake “Defender Europe 21”, që ka nisur prej disa ditësh në Shqipëri. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

“Anija ushtarake e furnizimit logjistik “James A. Loux” zhvilloi fundjavën e kaluar disa manovra ushtarake dhe stërvitje në Detin Adriatik pranë Durrësit”, thekson Ambasada e SHBA-së. “Trajnimi i

ekuipezhit përfshinte një stërvitje për shuarjen e zjarrit dhe evakuimin e njerëzve. Një varkë shpëtimi u nis nga anija për të rimarrë një anëtar të ekuipezhit”, -shton Ambasada amerikane. “LSV James A Loux” është në Portin e Durrësit për të marrë pjesë në stërvitjen ushtarake Defender Europe 21, si pjesë e operacionit të përbashkët për të transportuar automjete dhe pajisje ushtarake nga USNS Bob Hope në Shqipëri”, -shkruhet në mesazhin e Ambasadës së SHBA-së.



“Defender Europe 21”

Stërvitje e përbashkët me grupin amerikan në Bazën e Pashalimanit

Në kuadër të zhvillimit në vendin tone, të stërvitjes së përbashkët me Komandën e Ushtrisë Amerikane në Europë të koduar “Defender Europe 21”, në Flotiljen Detare Pashaliman është zhvilluar nga dita e premte deri ditën e hënë një aktivitet i përbashkët ndërmjet grupit amerikan të zhytjes në bashkëpunim me zhytësit e Qendrës së Zhytjes Pashaliman. Aktiviteti është zhvilluar në anijen spitaliere të mbytur në gjirin e Radhimës dhe brenda Bazës Pashaliman pranë nëndetësës 105. Gjatë aktivitetit në vijimësi është zhvilluar dhe ngjitje në malin e Sevasterit. Në përfundim të aktiviteve grupi pjesëmarrës amerikan ka vlerësuar personelin e Bazës Pashaliman nënlejtënant Klaudio Lutaj, nënlejtënant Inert Filaj dhe komandantin e Flotiljes Pashaliman kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari me certifikata mirënjohje, në shenjë vlerësimi, falënderimi dhe mirënjohje për gjithë zhvillimin, pritjen dhe organizimin e aktivitetit.

STËRVITJA
“DEFENDER EUROPE 21”

**Polumbarët
amerikanë e
shqiptarë zhyten
në Gjirin e Dukatit**

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ka publikuar pamje dhe video në rrjetet sociale nga stërvitja e përbashkët mes marinës amerikane dhe asaj shqiptare në kuadër të “Defender Europe 21”. Nëpërmjet postimit në llogarinë e tij në ‘Facebook’, Peleshi shkruan se stërvitja u zhvillua në Gjirin e Dukatit, aty ku ndodhet anija spitalore “PO” e mbytur gjatë Luftës së Dytë Botërore, teksa në pamje shihen polumbarët amerikanë dhe shqiptarë, teksa zhyten në thellësinë e ujërave të këtij gjiri. “Në kuadër të stërvitjes “Defender Europe 21”, polumbarët amerikanë dhe shqiptarë u zhytën në thellësinë e tabanit detar në Gjirin e Dukatit, ku ndodhet anija spitalore “PO” e mbytur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Bashi (pjesa e përparme e anijes) ndodhet në 16 metra thellësi, ndërsa kiçi (pjesa e pasme) në 37 metra thellësi” shkruan Peleshi. Shqipëria ka një rol të rëndësishëm në stërvitjen e këtij viti “Defender Europe 21”, të trupave ushtarake amerikane dhe aleatëve të NATO-s.



Më 5 maj, në Ditën e Dëshmorëve, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj vendosën kurora me lule në Varrëzat e Dëshmorëve të Atdheut. Një kurorë të veçantë ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm vendosën për Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak Shqiptar.

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj dhe përfaqësues nga personeli i Forcës Ajrore dhe Baza Ajrore Farkë vendosën karafila të kuq mbi varrin e çdo dëshmori të Aviacionit Ushtarak. Në ceremoninë përkujtimore morën pjesë familjarët, të afërm të Dëshmorëve të Aviacionit Ushtarak si dhe përfaqësues të Shoqatës së Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët vendosën tufa me lule. Pas vendosjes së kurorave ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore takuan familjarët e dëshmorëve dhe ju shprehën atyre mirënjohjen dhe nderimin më të thellë që populli shqiptar dhe Forcat e Armatosura kanë për veprën dhe sakrificën e bërë nga Dëshmorët e Atdheut duke theksuar se ata janë kurdohërë në mendjen dhe zemrën e çdo shqiptari, janë nderi dhe krenaria jonë.

Me rastin e 5 majit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, me anë të një mesazhi përkujton jetën dhe veprën e Dëshmorëve të Atdheut që dhanë jetën për Shqipërinë. "Sot

Kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut

Forca e Armatosur, nderon me përlulësi dhe mirënjohjen më të thellë kombëtare të gjithë dëshmorët që bënë sakrificën sublime dhe dhanë jetën për Shqipërinë



është dita e kujtimit të përjetësisë, lavdisë dhe veprës së pavdekshme të Dëshmorëve të Atdheut. Në këtë ditë, Forca e Armatosur, nderon me përlulësi dhe mirënjohjen më të thellë kombëtare të gjithë dëshmorët që bënë sakrificën sublime dhe dhanë jetën për Shqipërinë. Në këtë ditë përkujtimi, ne të gjithë i detyrohemi një homazh mirënjohje të gjithë ushtarakëve dëshmorë, që me aktin dhe

vetëmohimin e tyre, i kanë dhënë dhe i japin nder, dinjitet dhe krenari Forcave të Armatosura dhe vendit. Gjithë nderimet për heronjtë tanë dhe respekt pafund për familjarët dhe pasardhësit e tyre. Lavdi jetës dhe veprës së tyre. I paharruar kujtimi i Dëshmorëve të Atdheut!", shkruan në mesazhin e tij Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj.

Major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj

Në Batalionin e Xhenios të Komandës Mbështetëse u zhvillua më 6 maj ceremonia përkujtimore e rënies në detyrë të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj. Në këtë ceremoni ishte e pranishme zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega dhe familjarët e dëshmorëve. Fjalën e mori fillimisht komandanti i Batalionit të Xhenios (bXh), kolonel Hajdar Gurra, i cili duke iu drejtuar të pranishmëve theksoi sakrificën sublime, atë të dhënies së jetës së dy dëshmorëve Tanushi dhe Hasanaj në krye të detyrës, si shembull i sakrificës, dinjitetit dhe përkushtimit, duke mos kursyer as veten, për një botë të pastër pa mina. Më pas fjalën e mori zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Ranë në krye të detyrës në Camp Adazi, Letoni

gjeneral brigade Manushaqe Shehu, e cila duke përcjellë edhe përshëndetjet e veçanta të ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu mirënjohjen për aktin sublim të dëshmorëve rënë në Letoni dy vite më parë. "Ata sot nuk gjenden më fizikisht midis nesh, por mbeten pjesë e jona, e historisë dhe lavdisë së Forcave të Armatosura; simbol i përgjegjësisë, gatishmërisë e përkushtimit për kryerjen e misionit dhe detyrës fisnike të ushtarakut në emër të atdheut dhe Shqipërisë. Emri i tyre nderohet në Aleancë, rënia e tyre përkujtohet sot nga

kolegët e NATO-s. Rënia e Klodianit dhe Zarifes në krye të detyrës, është dëshmi e gjallë e përkushtimit dhe sakrificës të Forcave tona të Armatosura në çdo angazhim dhe mision të NATO-s, në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit dhe asaj globale"-u shpreh ajo. Ky është përvjetori i dytë i rënies në detyrë të dëshmorëve më të rinj të atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, të cilët janë përkujtuar përmes një ceremonie edhe në Letoni. Emrat e tyre janë gdhendur tashmë me germa të arta në historinë e Forcave të Armatosura e njëkohësisht dhe vendit tonë e do të kujtohen përjetë.

Dy vite nga rënia në krye të detyrës e major Tanushit dhe nëntetare Hasanaj

Dëshmorëte
Atdheut major
Klodian Tanushi
dhe nëntetare
Zarife Hasanaj
ranë në krye të
detyrës gjatë mi-
sionit të NATO-s
në Letoni

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, më 6 maj 2021, me anë të një mesazhi, ka përkujtuar dy vjetorin e rënies në krye të detyrës në misionin e NATO-s në Letoni të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushit dhe nëntetare Zarife Hasanaj.

Mesazhi si më poshtë: "Sot është përvjetori i dytë i rënies në krye të detyrës gjatë misionit të NATO-s në Letoni, të Dëshmorëve të Atdheut major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj. U bën dy vjet që jemi ndarë. Forca e Armatosur humbi dy nga efektivet e saj më të mirë, që kishin përpara një karrierë, një jetë. Kjo është një ditë e ndjerë dhe e vështirë për shokët, kolegët dhe bashkëpunëtorët, për gjithë Forcat e Armatosura, por është veçanërisht e vështirë dhe e dhimbshme për

njerëzit e tyre të dashur, prindërit, fëmijët, familjet, motrat e vëllezërit dhe gjithë miqtë e të afërmit. Sot ne i bashkohemi dhimbjes së familjeve Tanushi e Hasanaj, për të kujtuar me nderim dhe respekt veprën dhe ndarjen nga jeta të këtyre bijve të pazëvendësueshëm, të ushtarëve dhe heronjve të Shqipërisë. Ju, familjarë të nderuar, asnjëherë nuk do jeni vetëm. Ne do të jemi gjithmonë me ju, gjithmonë bashkë. Në këtë ditë përkujtimi, ne të gjithë reflektojmë mbi sakrificat e këtyre dëshmorëve tanë, për aktet e guximshme dhe vetëmohimin, që i japin nder, dinjitet dhe krenari Forcave të Armatosura, vendit dhe Aleancës së madhe ku ne bëjmë pjesë. Ata na kujtojnë të gjithëve se profesioni i ushtarakut, kërkon të rinj dhe të reja, burra dhe gra me ndjenjën e përkushtimit, vetëmohimit dhe sakrificës. Rënia në krye të detyrës e Klodianit dhe Zarifes, është dëshmi e gjallë e përkushtimit dhe sakrificës të Forcave tona të Armatosura në çdo angazhim dhe mision të NATO-s, në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit. Ata na kujtojnë se ne të gjithë iu detyrohemi atyre një homazh mirënjohje, por iu detyrohemi edhe modernizimin e shërbimit të tyre dhe gjithë Forcave të Armatosura.

Sakrifika sublime e tyre nuk do të harrohet. Ajo është pjesë e motivimit të përditshëm të të gjithë vajzave, grave dhe burrave në uniformë, të cilët të heshtur dhe pa zhurmë, janë çdo ditë, brenda dhe jashtë vendit, të gatshëm dhe në shërbim të nevojave dhe detyrimeve kombëtare dhe euroatlantike. I pabaruruar qoftë kujtimi i Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj!"



LIBRI I NJË GJENERALI

Gjeneralmajor Spiro Shalësi dhe libri i tij “Për artin ushtarak shqiptar”

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Një nismë që duhet nxitur...

Pas një pune të kujdesshme, këto ditë doli nga shtypi libri “Për artin ushtarak shqiptar”, me autor gjeneralmajor Spiro Shalësi, i përgatitur nga Bernard Zotaj dhe Arben Zvalani. Libri përmban histori ushtarake, studime, analiza dhe artikuj të ndryshëm të publikuar nga autori në vitet 1951-1974.

Nga studimet në bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura, përgatitësit ndeshën në mjaft shkrime dhe artikuj studimorë dhe problemorë, të shkruar në vite nga ushtaraku i lartë, i cili kishte studiuar në akademitë perëndimore, ishte përfshirë në luftë si antifashist dhe dalë malit partizan. Kështu u lindi mendimi për të mbledhur të gjithë këto shkrime që përbëjnë një pasuri për historinë ushtarake, por dhe për të njohur përvojën e kuadrove ushtarak në vite. Me nismën e tyre përgatitën këtë botim të thjeshtë, por me vlera njohësi, për punën dhe përpjekjet e ushtarakut shqiptar në vite.

Në bibliotekat tona gjenden mjaft shkrime të karakterit studimor dhe ushtarak të cilat na japin përpjekjet dhe punën e madhe të bërë nga ushtarakët në vite. Kjo përvojë dhe tërë ato sakrifica dhe përpjekje për organizimin, modernizimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura shqiptare në vite është e mira të njihen, të studiohen dhe të publikohen nga institucionet ushtarake. Institucionet ushtarake në mjaft tema studimore që përgatisin studentët në lëndë të veçanta, e mira do të ishte të trajtonin dhe mendimin teorik dhe praktik të kuadrove madhorë të ushtrisë, sipas armëve dhe shërbimeve të ndryshme, me qëllim për t'i bërë njohës të mendimit ushtarak shqiptar. Përvoja e këtyre kuadrove, mendimet dhe sugjerimet e dhëna për ushtrinë në kohë të ndryshme, bëjnë të kuptojmë mendimin, praktikën dhe nivelin e ushtrisë në periudha të ndryshme të kalimit të saj.

Këto nisma duhen nxitur nga institucionet ushtarake, por edhe nga pedagogët e kuadrot e FA-së, për të krijuar dhe mësuar për veprimtarinë e gjithanshme të mjaft kuadrove ushtarakë në vite, për t'u dhënë atyre vendin që iu takon, por dhe për qenë studimor në përvojën e

tyre tepër të pasur dhe që është e shkruar në shtypin ushtarak të kohës.

Spiro Shalësi duhet të studiohet në fushën ushtarake

Dalëngadalë libri u konceptua dhe mori këtë përmbytje. Në parathënie përgatitësit e librit e paraqesin Spiro Shalësin si njohës të mirë të artit ushtarak. Viti 1974 shënon fillimin e luftës kundër grupit të ashtuquajtur “puçist” në Ushtrinë Shqiptare. Spiro Shalësi, si shumë ushtarakë të lartë, përjashtohet nga Ushtria. Ai shpallet armik, sepse kishte qenë pjesëtar në grupin e hartuesve të të ashtuquajturave “Teza të Zeza”. Për rrjedhojë, në dhjetor 1974 internohet.

Gjeneral Spiro Shalësi u largua nga ushtria në moshën e pjekurisë dhe të përvojës, por vetëm mund të themi fizikisht. Emri, lufta dhe sidomos puna e tij në vitet e shndërrimit të Ushtrisë shqiptare në një ushtri të rregullt, me një pamje bashkohore në organizim dhe në drejtim, e sidomos në përpunimin e mendimit teorik ushtarak shqiptar ka mbetur në kujtesën e ushtarakëve shqiptarë bashkëkohës, por dhe të brezave të tjerë pasardhës. Vepra e tij ngadalë po nxirret në dritë për t'u bërë e njohur me të gjithë tërësinë dhe veçorinë e saj.

Spiro Shalësi duhet të studiohet në fushën e karrierës ushtarake, në fushën organizative e drejtues të njësive të mëdha të Ushtrisë shqiptare, si dhe në punën e ndihmesën e dhënë prej tij në fushën studimore për të çuar më përpara mendimin ushtarak shqiptar.

Në kreun e parë me objekt “Shkrime për artin ushtarak shqiptar”, zënë vend shkrimet “Luftimi në afërsitë e katundit Arrëzë të Devollit”, “Manovrimi i shpejtë dhe goditja në befasi e armikut”, “Lufta e Leskovikut, një aksion i guximshëm”, “Luftimet u zhvilluan të kombinuar”, “Dalja nga rrethimi dhe hedhja në kundërsulm”, “Mësymje e rrufeshme, manovër e guximshme”, “Kalimi në mësymjen e përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në pranverën e vitit 1944”.

Në kreun e dytë me objekt “Studime në ndihmë të artit ushtarak” trajtohen problemet: “Planëzimi dhe organizimi në drejtimin e stërvitjes të reparteve xheniere”, “Përgatitja fushore, baza e gatishmërisë luftarake të

nënrepartëve dhe repartëve xheniere" dhe "Shokë e vëllezër të një pozicioni".

Në kreun e tretë me objekt "Shkrime të tjera" trajtohen problemet "Në roje të punës paqësore të popullit tonë" dhe "Për përgatitjen e mëtejshme speciale të oficerëve të xhenios". Ndërsa në mbyllje përgatitësit kanë shkruar: gjeneralmajor Spiro Shalësi, njohës i artit, shkencës ushtarake dhe doktrinë të ushtrive.

Studime dhe përgjithësime në fushën e mendimit ushtarak shqiptar

Spiro Shalësi edhe sot përfaqëson ushtarakun shqiptar të shkolluar, i cili e shihte karrierën të lidhur me studimin e paprerë që të shpinte në kryerjen e detyrave sa më mirë dhe në përputhje me interesat e Ushtrisë dhe të mbrojtjes të Atdheut. Ky përkushtim të shtyn përpara dhe në karrierë ushtarake. Këtë dukuri të tij e dëshmojnë mjaft mirë shkollat dhe akademitë e shumta ushtarake në të cilat u formua. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, përvoja organizative dhe drejtimi ushtarak i formacioneve luftarake në fushën e luftimit e më gjerë, e ngritën në rolin e drejtuesit ushtarak. Të tilla qenë batalionet që organizoi e drejtoi; shtabet e njësive të UNÇSH-së, në të cilat bëri pjesë si shtabi i Divizionit të Parë Sulmues. Bashkëpunimi në vijimësi me ushtarakë të njohur dhe të aftë në karrierë, si Dali Ndreu dhe disa ndihmës të tjerë të tij, i dhanë vlera figurës së tij ushtarake. Këto vite të vështira të luftës i shërbyen Spiro Shalësit si shkollë e vërtetë e praktikës ushtarake në kushte të luftës jo aq klasike, por me veçori krejt shqiptare, sidomos në fushën organizative dhe të taktikës. Tashmë me njohuritë e gjera të fituara në akademinë ushtarake italiane, ndihmoi në ndërtimin dhe zbatimin e taktikave të luftës të formacioneve partizane që drejtonte në kohën e luftës kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë.

Me mundësinë që iu çel menjëherë pas Çlirimit të vendit, Spiro u kualifikua më tej në akademi ushtarake me emër, tashmë lindore, gjë që e aftësoi dhe e bëri atë një nga njohësit e zotëruesit më të mirë e të thelluar të artit ushtarak të të gjitha niveleve, si dhe të rolit të të gjitha armëve e shërbimeve në veprime të ndryshme luftarake. Njëkohësisht njohja e artit ushtarak dhe e doktrinë të ushtrisë të disa vendeve të huaja, italiane, greke, ruse etj., si dhe kryerja e detyrave të nivelit të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes, në njësitë e mëdha si korpusi e deri në Institutin e Studimeve Shkencore të Ushtrisë, mundësuan që të bëhej një

nga studiuesit e zellshëm të Artit Ushtarak Shqiptar. Këtë përvojë dhe art e pasqyroj mjaft mirë në një varg me studime dhe përgjithësime në fushën e mendimit ushtarak shqiptar. Përvojën e luftës dhe të stërvitjeve të Ushtrisë Shqiptare ai e pasqyroj jo vetëm thjesht përmes përshkrimeve të qarta e të sakta, por dhe duke e përpunuar dhe ngritur në trajtën e përgjithësimeve. Mendimi i tij ishte i përpunuar e i thelluar, i shtruar dhe i shkruar me shumë kulturë.


Analizat dhe studimet e tij gjenden kudo, në çdo stërvitje, me komandat dhe shtabet, me trupat, duke parashikuar dhe përpunuar situata dhe ide të shumta që i vinin ushtarakët në rrethana të ngjashme apo të përafërta me ato të luftës. Me aftësitë profesionale, me njohuritë e thella ushtarake të çdo lloji, me fantazinë dhe shpirtin e pasur krijues, si dhe me kulturën e gjerë,

Gjeneral Shalësi ka dhënë një ndihmesë të pazëvendësueshme në përsosjen e vazhdueshme organizative, në përgatitjen luftarake të Ushtrisë shqiptare dhe në forcimin e mbrojtjes së Shqipërisë.

Në vitet e fundit të jetës e të punës së tij ushtarake, kohë kur gjenerali drejtonte dhe punonte në Institutin e Studimeve Ushtarake, ka hedhur në letër mendimin dhe përvojën e tij ushtarake, të pasur dhe të shquar. Gjenerali u përpoq që të krijonte një shkollë studimi dhe përpunimi të mendimit ushtarak shqiptar, për të përgatitur ushtarakë studioz, të apasionuar e të kulturuar. Nismë kjo që u ndërpre në mes. Kjo ka qenë dhe periudha më e vështirë e jetës së tij. Gjenerali përgatiti dhe shkroi disa punime, midis tyre dhe materialin studimor të emërtuar "Tëzat e Zeza". Ky ishte materiali i tij i fundit, sepse pas këtij ai u gjykua si "puçist". Bashkë me disa gjeneralë të tjerë të

shquar dhe oficerë madhorë u përjashtua nga Ushtria dhe u internuan. Në vitet '60-70-të të shek. XX, kur shkruhej në fushën e teorisë dhe të mendimit ushtarak, duhet të kontrollohej nga partia. Kjo punë kërkonte guxim dhe ky guxim Spiro Shalësit nuk i mungonte, që ishte cilësi e karakterit të tij. Fundi i gjeneral Shalësit ishte dënim politik.

Gjenerali ishte një ushtarak i shkolluar, njeri i kulturuar, komunikues dhe i dashur, i qeshur dhe i ndjeshëm, luftëtar i njohur i luftës për çlirim, drejtues i shquar i formacioneve të mëdha të Ushtrisë Shqiptare, studiues i talentuar dhe njohës i thellë i artit ushtarak. Punimet e tij po pasqyrohen në këtë përmbledhje të thjeshtë, por që kanë vlera. Kështu u punua dhe u përgatit ky libër për të njohur dhe vlerësuar kontributin e dhënë për ushtrinë nga gjeneral Spiro Shalësi.





MINISTRI MEHAJ NË KROACI, PRITET HOMOLOGU KROAT MARIO BANOŽIĆ

Memorandumi i Mirëkuptimit, projekt kompleks ushtarak shumëvjeçar



Në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Kroacisë, në selinë e Ministrisë së Mbrojtjes kroate, me nderime të larta ushtarake, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Armend Mehaj, u prit më 30 prill 2021, në takim nga homologu i tij, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kroacisë, Mario Banožić. Në takimin mes tyre u diskutua rreth bashkëpunimit dypalësh të mbrojtjes dhe mundësisë për avancimin e bashkëpunimit edhe në industrinë e mbrojtjes, pastaj rreth angazhimit dhe rolit të rëndësishëm të Kroacisë në NATO dhe misionin e KFOR-it si dhe për përkrahjen e vazhdueshme të Kroacisë për anëtarësim të Republikës së Kosovës në iniciativat rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes me theks të veçantë në Kartën e Adriatikut- SHBA (A5), e cila këtë vit kryesohet nga Republika e Kroacisë.

Gjatë këtij takimi, ministri Banožić, ndër të tjera, theksoi miqësinë ndërmjet Kroacisë dhe Kosovës në përgjithësi dhe partneritetin e fuqishëm ndërmjet dy ministrive në veçanti. Ai ndër të tjera theksoi se është koha që bashkëpunimin bilateral t'a ngremë në nivel edhe më të lartë në kontekstin e Memorandumit të ri të Mirëkuptimit midis dy ministrive, i cili është duke u përgatitur, dhe i cili do të përfshijë modalitete të reja të bashkëpunimit.

"Do të jetë një projekt kompleks shumëvjeçar, por besoj se ky bashkëpunim do të lidhë më tej vendet tona në aspektin politik, ushtarak dhe ekonomik" -tha ai. Ministri Banožić gjithashtu njoftoi dhe ftoi Ministrin Mehaj në Ekspozitën dhe Konferencën Ushtarake dhe Ajrore të Adriatikut - ASDA, e cila është planifikuar të mbahet

këtë vjeshtë në Split.

Nga ana e tij, Ministri Mehaj, falënderoi ministrin Banožić për mbështetjen e vazhdueshme shumëvjeçare, duke theksuar se kjo është vizita e tij e parë jashtë vendit që nga marrja e detyrës. Ai tha se ishte një nder i madh për të që është në Kroaci, të cilën Republika e Kosovës e sheh si një nga partnerët dhe mentorët më të fortë rajonale në procesin e tranzicionit dhe avancimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Stabiliteti dhe siguria rajonale mund të arrihen vetëm përmes përpjekjeve dhe bashkëpunimit të përbashkët," tha ministri, duke shprehur kënaqësinë me presidencën e Kroacisë të Kartës së Adriatikut-SHBA (A5) të këtij viti, duke theksuar se ai shpreson që Republika e Kosovës së shpejti do të bëhet anëtarë më i ri i Kartës.

"Ne i jemi mirënjohës Kroacisë për mbështetjen e saj gjatë gjithë këtyre viteve. Ne e shohim Kroacinë si një mentor dhe mësimet e nxjerra do të ndihmojnë Kosovën në rrugën e saj drejt NATO-s. Sot në Kosovë kemi pasur garën tradicionale për ushtarin më të mirë dhe unë sapo morra informacion se një ushtar i Ushtrisë Kroate fitoi garën. Urime për suksesin", -tha në fund Ministri i Kosovës dhe ftoi Ministrin Banožić në Prishtinë për të nënshkruar Memo-

randumin e ri të Mirëkuptimit. Gjatë vizitës katërditore, ministri Mehaj me delegacionin e tij, zhvilloi vizitat në kompanitë prodhuese për t'u njohur nga afër me cilësinë e pajisjeve të prodhuara nga kompanitë kroate të industrisë e mbrojtjes.

Në vazhden e aktivitetëve të shumta, ministri Mehaj, përveç takimit me stafin diplomatik të Kosovës në Zagreb, po ashtu vizitoi student-kadetët e Kosovës në Akademinë Ushtarake të Kroacisë ku është pritur nga komandanti i saj, gjenerallejtënant Mate Pađen dhe stafi i tij. Gjatë vizitës, ministri Mehaj, përveç tjerash rreth institucionit përkatës, u bë me dije edhe për arritjet e student-kadetëve të FSK-së që studiojnë aktualisht në këtë akademi. Nga ana e tij, ministri Mehaj, përgëzoi ushtarakët kroate për arritjet në akademinë ushtarake kroate duke shprehur falënderimin për përkushtimin e tyre për aftësim sa më cilësor akademik e profesional të studentë-kadetëve kosovarë. Në bashkëbisedim të afërt me studentë-kadetët kosovarë, ndër të tjera, ai i inkurajoi ata për angazhim maksimal në studime për aftësim sa më të lartë akademik dhe profesional në funksion të karrierës së tyre ushtarake si dhe përgjegjësi që i presin në të ardhmen.

Ballkani Perëndimor zonë e përgjegjësisë Euro-Atlantike

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Të e martën e kësaj jave, më 18 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, në Selinë e NATO-s në Bruksel.

Ata shkëmbyen mendime mbi situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe përgatitjet për Samitin e NATO-s muajin tjetër. "Mali i Zi është një aleat i vlerësuar, duke dhënë kontribute të rëndësishme në sigurinë Euro-Atlantike", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe theksoi se të gjitha këto kontribute e bëjnë Aleancën "më të fortë dhe më të sigurt". Jens Stoltenberg theksoi mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për Malin e Zi, siç është përgjigja ndaj pandemisë COVID-19, përmes sigurimit të furnizimeve thelbësore mjekësore nga rezervat e reja mjekësore të NATO-s, dhe në mbajtjen e hapësirës ajrore të vendit të sigurt përmes misionit të policimit ajror të NATO-s, "me avionë nga Italia dhe nga Greqia". Ndërsa një ditë më parë, të hënë më 17 maj 2021, Stoltenberg priti në Selinë e NATO-s Presidentin e Republikës të Serbisë Aleksandër Vuçiç. Diskutimet ishin mbi partneritetin midis NATO-s dhe Serbisë, rolin e NATO-s në mbajtjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe tendencat e sigurisë në të gjithë rajonin. "Serbia është një partner i vjetër për Aleancën tonë dhe unë ju falënderoj për angazhimin tuaj personal në partneritetin tonë", tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg. "NATO është e angazhuar për ndërtimin e një partneriteti të fortë me Serbinë", duke respektuar plotësisht neutralitetin e saj. "Si një komb sovran, Serbia ka të drejtë të zgjedhë rrugën e saj. Ne përballemi me sfida të përbashkëta të



sigurisë; dhe partneriteti me NATO-n mund të sjellë përfitime të vërteta për Serbinë dhe qytetarët e saj dhe rajonin e gjerë", shtoi ai.

NATO e angazhuar për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor

Pas takimit në Selinë e NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg dhe Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp. "Mali i Zi është një aleat i vlerësuar", sepse jep "kontribute të rëndësishme në sigurinë Euro-Atlantike, siguron mbështetje financiare për Forcat e Sigurisë Afgane" dhe "kontribuon në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor" si dhe po "rrit shpenzimet e tij për mbrojtjen". Të gjitha këto kontribute "e bëjnë Aleancën tonë më të fortë dhe më të sigurt", tha Stoltenberg dhe nënvizoi se ashtu

si NATO mund të mbështet në Malin e Zi edhe Mali i Zi mund të mbështet në NATO. "Ne vazhdojmë t'ju mbështesim në luftën kundër COVID-19. Sigurimi i furnizimeve thelbësore mjekësore, përfshirë ventilatorët nga rezervat e reja mjekësore të NATO-s. Ky është solidariteti i NATO-s në veprim. Në të njëjtën kohë, sfidat e sigurisë me të cilat u përballëm para pandemisë nuk janë zhdukur. Kështu që misioni i policisë ajrore të NATO-s vazhdon të mbrojë sigurinë e qiellit tuaj me avionë nga Italia dhe nga Greqia", tha Jens Stoltenberg në deklaratën për mediet dhe informoi se në takim ishte diskutuar mbi situatën në rajon. "Sot, ne adresuam situatën rajonale. Siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për NATO-n dhe për paqen dhe stabilitetin në Evropë. Ne gjithashtu adresuam veprimet destabilizuese të Rusisë në të gjithë zonën Euro-Atlantike. Nga aktivitetet hibride të operacionet e rrezikshme të inteligjencës në vendet tona deri në

vendosjen e konsiderueshme ushtarake në dhe rreth Ukrainës. Këto zhvillime ngrenë shqetësime serioze. Ne jemi dakord që duhet të vazhdojmë të mbështesim partnerët tonë, përfshirë Ballkanin Perëndimor dhe të vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s. Ne diskutuam gjithashtu iniciativën NATO 2030, e cila është në qendër të Samitit të NATO-s në qershor. Ne duhet të forcojmë mbrojtjen dhe parandalimin tonë, të zgjerojmë qasjen tonë ndaj sigurisë dhe të punojmë me partnerët për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla", njoftoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Kështu që unë e mirëpres mbështetjen e Malit të Zi në këtë proces".

"Mundësi e jashtëzakonshme" për tu takuar në 4 vjetorin e anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, ku "mund të flasim për çështjet më aktuale që lidhen me marrëdhëniet tona, çështjet aktuale të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin tonë dhe në zonën e përgjegjësisë Euro-Atlantike", tha në deklaratën e tij Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç. Ai vlerësoi se katër vjetët e anëtarësimit ishin shumë pozitive, "nga këndvështrimi ynë". "Përvoja me Malin e Zi konfirmoi Aleancën e NATO-s dhe shtetet anëtare se ishte e justifikuar të na besonin në 2017. Ne jemi të lumtur që NATO ka vazhduar të ndjekë me shumë vëmendje situatën në BP dhe që NATO po shpreh përmes politikës së saj të dyerve të hapura, gatishmërinë e saj për të zgjeruar zonën Euro-Atlantike në rajonin tonë", tha Dukanoviç. "Ne besojmë në një politikë të tillë, ku ju do të vazhdoni të konfirmoni ose mbështesni forcimin e stabilitetit në zonën Euro-Atlantike dhe stabilitetin rajonal". Ai gjithashtu konfirmoi se Mali i Zi "është absolutisht i gatshëm" të zbatojë të gjitha angazhimet që ka ndërmarrë në planin kombëtar të veprimit dhe në shpërndarjen e barabartë të barrës së financimit të NATO-s. "Unë dua të konfirmoj se jemi të gatshëm, deri në vitin 2024, siç kemi premtuar në planin tonë kombëtar, të alokojmë 2% të PBB-së për nevojat e ushtrisë dhe mbrojtjes. Dua t'ju them se në vitin 2020 ne tashmë kemi arritur 20% të alokimit të fondeve për modernizimin dhe sipas planit tonë, kjo do të konfirmohet edhe këtë vit" për modernizimin e sistemit të mbrojtjes. Duke konfirmuar deklaratën për shtyp të Sekretarit të Përgjithshëm, Gjukanoviç tha se "Pjesa më e rëndësishme e takimit tonë sot u përqendrua në vazhdimin e bashkëpunimit të NATO-s, me vendet e BP, me qëllim që të sigurojmë përforcimin e stabilitetit tonë dhe arritjen e qëllimeve evropiane dhe euro-atlantike. Jam i lumtur që ndajmë plotësisht mendimet në lidhje me rrezikimin e orientimit evropian dhe euro-atlantik

të BP përmes depërtimit të interesave të caktuara politike të vendeve, sistemi i vlerave të të cilave dhe qëllimet e të cilave janë të kundërta me Aleancën Evropiane Atlantike", tha ai dhe pohoi se "ky është një kërcënim serioz, jo vetëm për të ardhmen e BP, por edhe për stabilitetin sot. Kjo është diçka për të cilën unë doja të tërhiqja vëmendjen tuaj përveç kësaj, megjithëse kurrë nuk dyshoj që Ballkani Perëndimor është në monitorin e NATO-s dhe se ju po ndiqni nga afër gjithçka që po ndodh", tha presidenti malazez duke dashur "të ndajë përvojën aktuale" të Malit të Zi. "Është përshtypja jonë që një aktivitet i tillë shkatërrues po vazhdon, dhe për këtë arsye, mendova se përmes takimit tonë të sotëm dhe takimit me partnerët evropianë që do të kem sot, doja të mobilizoja, të gjithë më tej, në mënyrë që të gjithë të shihnin Ballkanin Perëndimor si fushë që është nën përpjekjen e disa vendeve të treta dhe që ata duan ta përdorin atë për aktivitete të mëtejshme kundër NATO-s. Kështu që unë mendoj se kjo është zona e përgjegjësisë së përbashkët dhe mendoj se duhet të forcojmë aktivitetet tona në mënyrë që të sigurojmë dhe forcojmë stabilitetin e rajonit tonë dhe të krijojmë kushte që vendet tona në BP të mund të shkojnë drejt qëllimeve strategjike, dhe ky është miratimi i sistemit evropian të vlerës dhe anëtarësimit të plotë në BE dhe NATO", tha ai. "Jam i bindur që kjo është zgjidhja më e mirë për të gjitha vendet e rajonit tonë dhe jam i bindur se përkundër sfidave me të cilat jemi ballafaquar aktualisht, përmes bashkëpunimit edhe më intensiv të rajonit tonë me NATO-n dhe BE, dhe përmes angazhimit edhe më intensiv të NATO-s dhe BE në Ballkanin Perëndimor, ne mund të të sigurojmë arritjen e këtij qëllimi dhe mund të forcojmë stabilitetin evropian dhe euro-atlantik në BP. Mali i Zi mbetet vendi që do të vazhdojë promovimin e vlerave Euro-Atlantike në rajonin tonë në një mënyrë të përkushtuar", tha Dukanoviç.

Dialogu Beograd-Prishtinë, platforma më e mirë për të gjetur një zgjidhje

"Serbia është një partner i vjetër për Aleancën tonë dhe unë ju falënderoj për angazhimin tuaj personal në partneritetin tonë", tha në deklaratën e tij për mediet Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në takimin e përbashkët me Presidentin e Republikës së Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 17 maj 2021. "Sapo kemi pasur një takim shumë konstruktiv. Sot kemi diskutuar shumë sfida të ndryshme të sigurisë me të cilat përballet Ballkani Perëndimor. NATO ka qenë e angazhuar për paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor për dekada dhe

ne do të vazhdojmë të qëndrojmë të përkushtuar. Misioni ynë i KFOR-it është demonstrimi më i prekshëm i këtij angazhimi. KFOR-i siguron një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur dhe garanton lirinë e lëvizjes për të mirën e të gjitha komuniteteve në Kosovë, bazuar në mandatin tonë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Aleatët e NATO-s janë të vendosur për KFOR-in dhe për misionin e tij të rëndësishëm. NATO gjithashtu mbështet plotësisht procesin e normalizimit midis Beogradit dhe Prishtinës. Dialogu Beograd-Prishtinë është platforma më e mirë për të gjetur një zgjidhje që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme. Kjo garanton një të ardhme më të mirë dhe më të begatë për të gjithë. Dialogu konstruktiv është thelbësor për stabilitetin në këtë rajon dhe unë vazhdoj t'u bëj thirrje të gjitha palëve që të përfshihen në dialog", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai theksoi se "NATO është e angazhuar për ndërtimin e një partneriteti të fortë me Serbinë. Ne e respektojmë plotësisht neutralitetin tuaj. Si një komb sovran, Serbia ka të drejtë të zgjedhë rrugën e saj. Ne përballemi me sfida të përbashkëta të sigurisë dhe partneriteti me NATO mund të sjellë përfitime të vërteta për Serbinë dhe qytetarët e saj dhe rajonin më të gjerë. Ne punojmë me Serbinë në reformën e forcave dhe institucioneve tuaja të sigurisë kombëtare. Ne trajnojmë oficerë serbë në mënyrë që ata të marrin pjesë më mirë dhe më sigurt në stërvitjet paqeruajtëse ndërkombëtare". Stoltenberg kujtoi se Serbia ka punuar me NATO-n për të trajnuar mjekë ushtarakë irakianë dhe se ka morë pjesë në stërvitjen më të madhe të emergjencës civile të NATO-s, e cila u organizua nga Serbia disa vjet më parë. "Ndihmojmë aleatët e NATO-s, si dhe Serbinë dhe partnerët tjerë, që të bëhen më të përgatitur për t'u marrë me katastrofat natyrore, të tilla si përmbytjet dhe zjarret në pyje. Kështu që bashkëpunimi ynë ka sjellë përfitime reale dhe unë pres partneritetin tonë të vazhdueshëm", tha Jens Stoltenberg. Duke informuar mediat presidenti Aleksandr Vuçiq nga ana e tij tha se kjo ishte një bisedë shumë e rëndësishme për palën serbe dhe sqaroi zërat e disa ditëve më parë që qarkulluan në media. "Siç mund ta shihni, njerëzit e mi përgatitën shumë letra, të bëra bukur, por unë do të thosha diçka të vërtetë për bisedën tonë. Mund të them se jam shumë i kënaqur me përmbajtjen e bisedave tona. Ne morëm shumë siguri nga Z. Stoltenberg, nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjitha çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Ne kishim disa pyetje në lidhje me disa thashetheme dhe gjithçka tjetër dhe

ajo që morëm nga Z. Stoltenberg ishte një përgjigje shumë e qartë për domosdoshmërinë e ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon dhe përqendrimit të KFOR-it, forcave të NATO-s në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, siç e thashë tashmë dhe kjo ishte diçka që ne e kërkuam. Mendoj se kjo do të sjellë më shumë qetësi në zemrat e njerëzve, jo vetëm në Kosovë, dhe për të cilën po flasim në një rajon të tërë. Kjo ishte diçka me një domethënie të madhe për të gjithë ne. Ne diskutuam të gjitha çështjet e ndryshme, të rëndësishme për një rajon të tërë. Mund të them se jam shumë i kënaqur me këtë deklaratë të Z. Stoltenberg që respekton neutralitetin e Serbisë dhe sovranitetin e Serbisë. Ne nuk jemi nxitur, për të mos përmendur, të detyruar nga NATO, nga Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, për të bërë diçka ndryshe dhe ne e konsiderojmë veten si partnerë. Në fund të tetorit, fillim të nëntorit, ne do të shënojmë 15 vjetorin e Partneritetit për Paqe. I bëra një ftesë Z. Stoltenberg dhe shpresoj se ai do të gjejë mjaft kohë dhe arsye të mjaftueshme për të vizituar Serbinë në atë pjesë të vitit, sepse mendoj se do të ishte një konfirmim i shkëlqyeshëm i marrëdhënies sonë të mirë", tha Vuçiq dhe nënvizoi se kjo gjithashtu "do të forcojë marrëdhëniet tona për të ardhmen, gjë që do të bëhet, mendoj, për hir të, natyrisht të Serbisë së vogël dhe popullit serb. Kjo është puna ime, por gjithashtu mendoj se do të ishte mirë dhe do të bëhej siç duhet për të mirën e NATO-s gjithashtu. Ne diskutuam, siç e kam thënë tashmë, shumë çështje nga rajoni dhe, veçanërisht, të gjitha çështjet në lidhje me Kosovën, në lidhje me marrëdhëniet Beograd-Prishtinë dhe kjo kishte të bënte me hapësirën e ulët ajrore, kishte të bënte me procesin e dialogut dhe unë doja dhe bëra çmos për të bindur Jens Stoltenberg se Serbia është plotësisht e përkushtuar, 100%, 100% e përkushtuar, në procesin e dialogut dhe që ne do të bëjmë më të mirën tonë në arritjen e një zgjidhje kompromisi. E dimë që është një proces nën kujdesin e BE-së dhe shpresojmë se do të kemi fuqinë e mjaftueshme për të përfunduar procesin në një mënyrë pozitive". Por "nëse jo", tha Vuçiq, "gjithsesi duhet të ruajmë paqen dhe stabilitetin, që është gjithmonë më mirë sesa të kemi dhunë, incidente, kryengritje, trazira dhe gjithçka tjetër. Edhe një herë, doja të falënderoja shumë personalisht Jens Stoltenberg. Sepse ai ka qenë gjithmonë i gatshëm për të diskutuar të gjitha çështjet e nevojshme dhe të pazgjidhura me Serbinë. Dhe sa herë që kishim ndonjë lloj problemi ai ishte i hapur për diskutim, për të diskutuar gjithçka me ne, për të shqyrtuar, ose rishikuar, çështje shumë të vështira

nga rajoni, gjithmonë në një mënyrë për t'u qetësuar, për të qetësuar situatën dhe kjo është arsyeja pse unë jam thellësisht mirënjohës ndaj tij personalisht, dhe natyrisht ndaj partnerëve tanë nga NATO. Serbia do të mbetet dhe Serbia do të ruajë neutralitetin e saj, por kjo nuk do të thotë që ne nuk do të rrisim nivelin e aktiviteteve tona të përbashkëta. Përkundrazi, jam absolutisht i sigurt që mund të bëjmë shumë më tepër në fusha të ndryshme, në sfera të ndryshme dhe se mund të bashkëpunojmë shumë më mirë në të ardhmen", duke i ripërsëritur ftesën "shpresoj t'ju shoh shumë shpejt në Beograd dhe Serbi", pasi dhe "ky është qyteti juaj i lindjes dhe ju jeni gjithmonë shumë i mirëpritur."

Presidenti Vuçiq dha shpjegime gjithashtu për mediat nëse kishte pasur ndonjë "temë të veçantë" gjatë takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s. "E vetmja gjë që mund të them është se - po kishte dy ose tre pyetje për të cilat unë insistova vërtet. Unë kërkoja mbështetje dhe u përpoqa të insistoja në të", tha ai "Unë insistova në pyetje për çështje, dhe mora shpjegime të shkëlqyera dhe përgjigje të shkëlqyera nga Jens. Për shkak se ai e kupton situatën në rajon, ai e kupton situatën në Serbi, ai i njeh të gjitha problemet tona, edhe pse ai përfaqëson 30 vende, ai e di se si duhet të trajtohen problemet dhe çështjet në rajon dhe edhe një herë unë jam shumë mirënjohës ndaj tij që ai e kuptoi pozicionin tonë. Unë nuk do të flas për këtë publikisht. Diçka për këtë e kam thënë tashmë. Por ka fusha, sfera dhe çështje që ne i trajtuam që unë nuk do të flas publikisht, por gjithsesi, unë mund t'ju them se jam shumë i kënaqur me rezultatet."

Misioni i KFOR-it nuk ka ndryshime në plane

"Misioni i KFOR-it është shprehja më e prekshme dhe konkrete e angazhimit të NATO-s në rajon. Ne jemi atje për të mbrojtur të gjitha komunitetet për të siguruar lirinë e lëvizjes, dhe aleatët mbeten të përkushtuar ndaj KFOR-it. Ky mision bazohet në një mandat të qartë të KB-së dhe më pas nuk ka ndryshime në plane, as ndryshime në angazhimin tonë për misionin e KFOR-it", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në konferencën për shtyp me presidentin serb Aleksandër Vuçiq më 17 maj në Selinë e NATO-s, në Bruksel. Të njëjtë gjë pohoi edhe një ditë më pas para medias në daljen e përbashkët me presidentin malazes Milo Gjukanoviç. "Misioni i KFOR-it në Kosovë është një mision i rëndësishëm. Bazohet në një mandat shumë të qartë të KB dhe është një nga shprehjet më të prekshme të

angazhimit të NATO-s për paqe dhe stabilitet në rajon. KFOR ndihmon për të siguruar siguri për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe për të siguruar lirinë e lëvizjes për të gjithë që jetojnë atje. Sigurisht që është një vendim kombëtar nëse do të dërgohen trupa në misionin e KFOR-it", sqaroi Jens Stoltenberg kur u pyet se çfarë komenti kish ai lidhur me vendimin e autoriteteve malazeze për të mos marrë pjesë në misionin e KFOR-it këtë vit dhe nëse ky vendim mund të kishte pasoja në marrëdhëniet midis Malit të Zi dhe NATO-s. "Është një vendim që duhet të merret nga secili aleat. Duke thënë këtë, unë natyrisht do të mirëpres kontributet nga Mali i Zi për KFOR-in, sepse kjo do të jetë një mbështetje për punën e rëndësishme të KFOR-it. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajonin e gjerë dhe për Malin e Zi do të jetë një mënyrë për të ndihmuar në stabilizimin e fqinjësisë së tij dhe gjithashtu të punojë së bashku me aleatët e tjerë të NATO-s dhe partnerët në misionin e KFOR-it", tha Sekretari i Përgjithshëm dhe përmendi se meqenëse NATO tani po përfundon Misionin e saj të Mbështetjes së Vendosur në Afganistan, "shumë aleatë, përfshirë Malin e Zi, do të kenë më pak angazhime në Afganistan dhe nuk do të kenë më asnjë prani ushtarake në Afganistan" dhe "mund të kontribuojnë në misionet e tjera të NATO-s, përfshirë misionin e NATO-s në KFOR". Por ai tha se gjithsesi është një vendim kombëtar dhe "në të njëjtën kohë unë mirëpres pjesëmarrjen e shtuar nga aleatët e NATO-s, përfshirë Malin e Zi në misionin e KFOR-it".

Kurse Presidenti i Republikës së Malit të Zi, Dukanoviç tha se bashkëpunimi me NATO-n ishte i kënaqshëm lidhur me pjesëmarrjen me cilësi të lartë të Malit të Zi në misionet e NATO-s në Afganistan, Letoni dhe Kosovë, por lidhur me dërgimin e trupave në misionin e KFOR-it ai tha se vendimet sipas sistemit kushtetues të Malit të Zi, meren në parlament, "vendimi për këtë duhet të merret në parlamentin e Malit të Zi". Por lidhur me rritjen e pjesëmarrjes, ai mendonte se Mali i Zi "është një anëtar i NATO-s nga rajoni ku duhet të tregohet kjo pjesëmarrje dhe është dy herë më tepër përgjegjës për stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor sesa vendet e tjera anëtare të NATO-s" tha ai duke qënë më të interesuar "për stabilitet sesa të tjerët", por tha ai "duhet t'i qasemi me shumë kujdes kësaj çështje". Dukanoviç tha se trupat e tyre ushtarake kishin përfunduar rotacionin në Afganistan dhe se kishin një numër ushtarësh të stërvitur që "janë të interesuar të marrin pjesë në misionet e NATO-s", por që ky ishte një qëndrim i qeverisë të Malit të Zi.

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Bashkëpunimi NATO-BE, përparësi e presidencës të vendit

Mediat raportuan se gazetari 26-vjeçar Raman Pratasevich u arrestua të dielën, më 23 maj 2021, pasi avioni i pasagjerëve Ryanair me të cilin po udhëtonte u detyrua me forcë të ulëj në Bjellorusi ndërsa fluturonte mbi hapësirën ajrore bjelloruse. Aeroplani i nisur nga Greqia kishte destinacion Lituaninë. Autoritetet bjelloruse pretenduan "pa ofruar prova" se ekzistonte "një kërcënim për bombë dhe dërguan një avion luftarak për t'i zënë rrugën avionit të pasagjerëve". Pratasevich dhe partnerja e tij ruse Sofia Sapega u arrestuan pas uljes së avionit. Tre pasagjerë të tjerë gjithashtu në Minsk. "Besohet se ata ishin agjentët bjelloruse që po gjurmonin gazetarin Pratasevich", thanë mediet.

Ndërsa zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian shprehën zemërim pas një takimi në Bruksel të hënën më 24 maj. "Ky është një sulm ndaj lirisë së shprehjes dhe sovranitetit evropian. Kjo sjellje e egër kërkon një përgjigje të fortë, prandaj Këshilli Evropian vendosi që do të ketë sanksione shtesë për individët e përfshirë në rrëmbim, por kësaj here, gjithashtu edhe për bizneset dhe subjektet ekonomike që po financojnë atë regjim", tha Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen. Presidenti Joe Biden gjithashtu ka kërkuar mbajtjen përgjegjëse të individëve të përfshirë në incident dhe Kombet e Bashkuara po ashtu kanë bërë thirrje për një hetim të plotë, transparent dhe të pavarur. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, mbajti qëndrimin e tij dhe dënoi veprimin. "Ky është një rrëmbim shtetëror dhe demonstron se si regjimi në Minsk sulmon të drejtat themelore demokratike", tha Stoltenberg.

NATO i bën thirrje Bjellorusisë t'i përmbahet rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla

Ndërkohë Këshilli i Atlantikut të Veriut, lëshoi një deklaratë ditën e mërkurë më 26 maj 2021 lidhur me situatën e marrjes me forcë dhe arrestimin e gazetarit dhe shoqërueses të tij, në ulëjin e detyruar të avionit tekta fluturonte mbi Bjellorusi. "Këshilli i Atlantikut të Veriut dënon me forcë devijimin e detyruar në Minsk, Bjellorusi të një fluturimi të Ryanair midis Athinës dhe Vilnius më 23 maj, si dhe lagimin me forcë nga avioni dhe arrestimin e Raman Pratasevich, një gazetari i shquar Bjellorus që udhëtonte në bord si dhe të Sofia Sapega. Ky veprim i papranueshëm shkel seriozisht normat që rregullojnë aviacionin civil dhe rrezikoi jetën e pasagjerëve dhe ekuipazhit. Ne mbështesim thirrjet për një hetim urgjent të pavarur, përfshirë nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO). Ne mbështesim masat e marra nga aleatët individualisht dhe kolektivisht



në përgjigje të këtij incidenti.", thotë deklarata.

Më tej ajo vazhdon se "Ndalimi i z. Pratasevich është një shkelje e parimeve të mospajtit politik dhe lirisë së shtypit. Bjellorusia duhet të lirojë menjëherë dhe pa kushte z. Pratasevich dhe znj. Sapega. Aleatët e NATO-s i bëjnë thirrje Bjellorusisë të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe t'i përmbahet rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Aleatët qëndrojnë në solidaritet me Letoninë pas dëbimit të pajustificuar të diplomatëve Letonezë", përfundon deklarata e publikuar e NATO-s.

Raman Pratasevich mërgoi në Poloni në vitin 2019 dhe kërkoi azil politik. Ai drejtoi kanalet e njohura Nexta dhe Nexta Live në faqen e mediave sociale Telegram. Që nga fillimi i protestave në gusht, "pas zgjedhje të diskutueshme", autoritetet bjelloruse kanë arrestuar rreth 35,000 njerëz.

Në Portugali në prag të Samitit të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg vizitoi Lisbonën më 26 maj 2021 për takime për përgatitjen e Samitit të NATO-s, si dhe për të përfunduar akademinë e re kibernetike portugeze. Në takim me Kryeministrin António Costa, Z. Stoltenberg vlerësoi Portugalinë për kontributet e saj të shumta në NATO, përfshirë vendosjet në praninë shumëkombëshe të Aleancës në Rumani, punën për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar përmes misionëve të NATO-s në Afganistan dhe Irak, si dhe praninë e Portugalisë në Afrikë. Ai përgëzoi Portugalinë për pritjen e mjediseve të NATO-s dhe për bërjen e bashkëpunimit NATO-BE një përparësi

të presidencës së vendit të Bashkimit Evropian. Të dy udhëheqësit diskutuan përgatitjet për Samitin e NATO-s në Bruksel që do të mbahet në 14 qershor. Z. Stoltenberg nënvizoi se iniciativa e NATO-s 2030 do të jetë në zemër të Samitit, dhe tha se "ne duhet të marrim vendime ambicioze dhe të demonstrojmë përkushtimin tonë për lidhjen transatlantike si me fjalë ashtu edhe me vepra". Ata diskutuan gjithashtu situatën në Bjellorusi. Z. Stoltenberg tha se "Unë dënoj me forcë uljen e detyruar të një avionit pasagjerësh gjatë rrugës nga një kryeqytet i NATO-s në tjetrin. Kjo përbën rrëmbim shtetëror; vë në rrezik një numër të madh të qytetarëve të vendeve aleate dhe është një sulm i qartë nga regjimi i Minskut ndaj të drejtave themelore demokratike dhe mediave të pavarura.", ai shtoi se "i mirëpres sanksionet e rena dakord nga Bashkimi Evropian dhe kërkoj lirinë e menjëhershme të gazetarit Raman Pratasevich dhe shoqërueses së tij Sofia Sapega, si dhe të gjithë të burgosurve të tjerë politikë, përfshirë anëtarët e Unionit të Polakëve. Duhet të ketë një hetim urgjent ndërkombëtar për këtë incident të egër", tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg dhe Kryeministri Costa adresuan gjithashtu tërheqjen e trupave nga Afganistani dhe planet për mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s, duke përfshirë trajnimin dhe mbështetjen financiare për forcat afgane. Ata diskutuan më tej se çfarë mund të bënte më shumë NATO për të ndihmuar në luftën kundër terrorizmit në Sahel. "Unë përgëzoj angazhimin e Portugalisë në këtë fushë, e cila ka një rëndësi strategjike për NATO-n. Ne po studiojmë mënyra për të rritur mbështetjen tonë, duke përfshirë përmes G5 dhe partnerit

tonë të NATO- Mauritania", tha Sekretari i Përgjithshëm. Z. Stoltenberg përroi gjithashtu Akademinë e Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s në Oeiras, së bashku me Kryeministrin Costa. Akademia do të luajë një rol kryesor duke trajnuar brezin e ardhshëm të mbrojtësve kibernetikë aleatë, duke ndihmuar në mbajtjen e avantazhit teknologjik të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në një takim të Këshillit të Shtetit, të kryesuar nga Presidenti portugez Marcelo Rebelo de Sousa, ndërsa në datën 27 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm vizitoi transportuesin e avionëve 'HMS Queen Elizabeth' të Marinës Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar, duke marrë pjesë në stërvitjen e NATO-s "Steadfast Defender 2021". Ai gjithashtu mori pjesë në një takim të ministrave të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian.

Portugalia aleatë e palëkundur në zemër të Aleancës

Konferenca e përbashkët për shtyp e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg dhe kryemistrit portugez António Costa, theksoi edhe njëherë para medias vlerësimin për Portugalinë. "Që nga themelimi i NATO-s, Portugalia ka qenë një aleatë e palëkundur dhe shumë e vlerësuar, një komb Atlantik në zemër të Aleancës tonë transatlantike. Forcat tuaja të Armatosura marrin pjesë në praninë tonë shumëkombëshe në Rumani. Ju ndihmuat për të luftuar terrorizmin dhe paqëndrueshmërinë ndërkombëtare, përmes misionëve tona në Afganistan dhe Irak, dhe përmes pranisë tuaj në Afrikë. Portugalia pret struktura të ndryshme të NATO-s, përfshirë akademinë tonë të re kompjuterike. Për të cilën jam krenar që unë dhe ju do të përurojmë së bashku në vonë sot", tha në krye të fjalës së tij Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg. "Nesër do të marr pjesë në Steadfast Defender 2021. Një stërvitje e rëndësishme, që përfshin mbi 9,000 trupa nga më shumë se 20 vende aleatë të NATO-s dhe partnerë. Kjo demonstroi gatishmërinë e NATO-s. Ajo tregon aftësinë tonë për të projektuar fuqinë detare në një epokë të konkurrencës gjeopolitike. Dhe më lejoni gjithashtu të përgëzoj Portugalinë për presidencën tuaj në Bashkimin Evropian dhe për ta bërë bashkëpunimin NATO-BE një nga përparësitë tuaja kryesore", nënvizoi edhe njëherë Jens Stoltenberg marrëdhënien NATO-BE. "Gjatë takimit tonë sot, ne diskutuam përgatitjet për Samitin tonë muajin tjetër.

Në zemër të Samitit të NATO-s në Bruksel është iniciativa NATO 2030 për të përgatitur Aleancën tonë për të ardhmen. Ne përballemi me shumë sfida të ndryshme të cilat asnjë vend ose kontinent nuk mund t'i trajtojë i vetëm. Pra, ne duhet të marrim vendime ambicioze dhe demonstrojmë përkushtimin tonë për lidhjen transatlantike. Edhe me fjalë edhe me vepra. Ne gjithashtu diskutuam një sërë temash të ndryshme të ngutshme, duke përfshirë siç e përmendët ju, situatën në Bjellorusi" informoi ai, duke përcaktuar në të njëjtën kohë edhe qëndrimin e tij lidhur me situatën. "Unë dënoj me forcë uljen e detyruar të një avioni pasagjerësh gjatë rrugës nga

një kryeqytet i NATO-s në tjetrin. Kjo barazohet me rrëmbim shtetëror, vë në rrezik një numër të madh të qytetarëve të vendeve aleatë. Dhe është një sulm i qartë nga regjimi i Minskut ndaj të drejtave themelore demokratike dhe mediave të pavarura. Unë i mirëpres sanksionet e dakorduara nga Bashkimi Evropian, që kërkojnë lirinë e menjëhershme të gazetarit Raman Pratasevich dhe shoqërueses së tij Sofia Sapëga. Si dhe të gjithë të burgosurit e tjerë politikë, përfshirë anëtarët e Unionit të Polakëve. Duhet të ketë një hetim urgjent ndërkombëtar për këtë incident të egër.", tha ai për rrëmbimin e gazetarit dhe shoqërueses të tij.

"Ne gjithashtu iu drejtua Afganistanit, ku tërheqja e trupave tanë vazhdon në një mënyrë të koordinuar. Në të njëjtën kohë, NATO mbetet e përkushtuar në partneritetin tonë të qëndrueshëm me Afganistanin. Kjo përfshin trajnimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen financiare të forcave afgane, dhe duke mbështetur të gjitha përpjekjet drejt një paqe të qëndrueshme. Ne gjithashtu diskutuam se çfarë mund të bëjë më shumë NATO për të ndihmuar në luftën kundër terrorizmit në Sahel. Unë përgëzoj angazhimin e Portugalisë për këtë rajon, i cili është i një rëndësie strategjike për NATO-n. Ne po shikojmë mënyra për të rritur mbështetjen tonë, duke përfshirë përmes G5 Sahel dhe partnerin tonë të NATO-s, Mauritania", deklaroi sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

NATO mbështet sanksionet e BE-së ndaj Bjellorusisë

Lidhur me pozicionin e NATO-s, mbi uljen e detyruar të fluturimit të pasagjerëve, për të cilin NATO ka bërë thirrje për një hetim ndërkombëtar dhe lirinë e të arrestuarëve, shefi i NATO-s iu përgjigj interesit të medias që kërkojë të dinte nëse mund të zgjerohet më tej qëndrimi dhe se cila do të ishte konkretisht përgjigjja e NATO-s ndaj këtij incidenti. Jens Stoltenberg ritheksosi edhe njëherë qëndrimin e Aleancës, por tha se ky veprim tregon se sa larg mund të shkojë Minsku gjithashtu, për të goditur forcat demokratike dhe medien e pavarur. "Ne dënojmë me forcë zbarkimin e detyruar të një avioni civil që largohet në të vërtetë nga një kryeqytet i NATO-s, Athina dhe më pas, në rrugën e tij për në një kryeqytet tjetër të NATO-s, në Vilnius, në Lituani. Dhe kjo është absolutisht e papranueshme dhe mendoj gjithashtu, se zbulon se sa larg është i gatshëm të shkojë regjimi në Minsk për të goditur forcat demokratike në vendin e vet dhe që nuk është vetëm një sulm ndaj të drejtave themelore demokratike, por edhe ndaj rolit të rëndësishëm të mediave të pavarura. Ne mbështesim sanksionet e BE-së. Aleatët e tjerë të NATO-s po vendosin sanksione të ngjashme. Ne bëjmë thirrje për lirinë e menjëhershme të të burgosurve politikë në Bjellorusi dhe do të vazhdojmë të bëjmë presion për një hetim të pavarur ndërkombëtar për këtë incident të egër. Pra, ne duhet të qëndrojmë së bashku, komuniteti ndërkombëtar dhe, mendoj se gjithashtu thekson rëndësinë

e bashkëpunimit të ngushtë të NATO-s dhe BE-së."

"Bjellorusia ka kaluar të gjitha vijat e kuqe të mundshme"

Ka disa vija të kuqe që janë kapërcyer në ngjarjen e ndodhur së fundmi në Bjellorusi, por a janë këto vija të kuqe të kapërcyera nga ana e disa vendeve apo nga ana e Bjellorusisë. "A jeni dakord me pozicionin e Lukashenkos? A është e mundur që ky veprim nga Bjellorusia të jetë udhëhequr pa dijeninë e Lukashenkos dhe a ekziston gjithashtu çështja e masave për të luftuar pandeminë?", ishin këto disa pyetje që iu drejtuan Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg në Lizbonë nga gazetarët. Ai në përgjigjen e tij për medien në këtë grup pyetjesh rreshtoi "para së gjithash pandemia", siç bëri të qartë ai. "Mendoj se ajo që kemi parë është se na ka kujtuar se duhet të jemi të përgatitur për një krizë dhe për ato të paparashikuara". Sigurisht, në të gjithë NATO-n, ne kemi parë sesi shërbimet shëndetësore civile kanë qenë në vijën e frontit, por gjithashtu se si forcat tona të armatosura i kanë mbështetur ato përpjekje civile. Usharakët tanë në të gjithë NATO-n, dhe gjithashtu të organizuar dhe lehtësuar nga NATO, kanë ndihmuar në transportimin e pajisjeve kritike mjekësore, në transportimin e pacientëve, në ngritjen e spitaleve në terren, për të ndihmuar në përhapjen e vaksinave. Prandaj për mua, është mirë të shoh që NATO si Aleancë, dhe gjithashtu forcat e armatosura në të gjithë Aleancën janë në gjendje të rriten dhe të sigurojnë mbështetje për qeveritë dhe përpjekjet civile për të përballuar pandeminë", tha ai dhe theksoi gatishmërinë e shtuar të Aleancës, sidomos në kohë krizash. "Mendoj se gjithashtu ilustron rëndësinë e gatishmërisë dhe gatishmërisë së shtuar për lloje të ndryshme krizash. Dhe pastaj unë do të doja të përgëzoja gjithashtu udhëheqjen e qeverisë në Portugali dhe Kryeministrin, në ngritjen dhe mobilizimin e aq shumë force në luftën kundër kësaj pandemie". Kurse për Kryeministrin e Portugalisë António Costa është Bjellorusia ajo që ka kaluar të gjitha vijat e kuqe të mundshme, "Bjellorusia dhe Lukashenko", tha ai. "Sigurisht, pse ata filluan një akt të paimagjinueshëm, për të organizuar rrëmbimin e një aeroplani civil, i cili po fluturonte midis dy kryeqyteteve të NATO-s, me synimin për të arrestuar, e duke mbajtur një gazetar. Është e papranueshme nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare. Nga këndvështrimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut", tha kryeministri i Portugalisë António Costa. "Kjo është arsyeja pse Bashkimi Evropian ka një pozicion shumë të qartë duke ndaluar hapësirën ajrore Evropiane për çdo aeroplan nga Bjellorusia dhe duke ndaluar që të gjitha kompanitë Evropiane të afrohen me aeroplanin e Bjellorusisë. Dhe gjithashtu duke kërkuar lirinë e menjëhershme të të dyve, të çiftit, dhe të gjithë të burgosurve politikë në Bjellorusi. Sigurisht që ishte Bjellorusia që kaloi vijat e kuqe", tha ai.



“DEFENDER EUROPE 21”

“Immediate Response 21” në Poligonin kombëtar të Bizës

